



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës

Nr. Regjistrimit themeltar(70111-00283) 584/5

Data e regjistrimit 29.01.2026

Nr. Vendimi(11-2026-478) 584/5

Data e vendimit 03.02.2026

V E N D I M
“PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e përbërë nga:

GJYQATAR: ORGENT NAZAJ

Në Durrës sot më datë 03.02.2026, në Dhomë Këshillimi, i dha fund shqyrtimit gjyqësor me dyer të mbyllura të kërkesës që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, përfaqësuar nga Prokurore Suela Beluli dhe Mediana Meta.

KUNDËR:

Erdal Demir, biri i Huseyin dhe i Baran, lindur me 01.12.1980 ne Karlova Turqi, banues ne adresen Gebze- Koceli Turqi, shtetësia turke, arsimi i larte, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprave penale “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara në katër raste, “Transporti i mbetjeve”, “Menaxhimi i mbetjeve”, “Falsifikimi i dokumenteve” në dy raste, “Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga nenet 171-25, 201/b-25, 201/a- 25, 186 dhe 287/2 të Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Yusuf Sezai Kurum, i biri i Muzaffer Nadi dhe i Nirgul, lindur me 10.08.1980 ne Turqi, banues ne kompleksi Mandarine vila nr C9, Tirane, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, arsimi i larte, gjendja familjare martuar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", "*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*" të parashikuar nga nenet 201/a-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Gjovana Sokolaj.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprave penale "*Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara*" në katër raste, "*Falsifikimi i dokumenteve*", "*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*" të parashikuar nga nenet 171-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Doni Sokolaj, i datelindjes 16.11.1969, mbajtes i pasaportes kroate me nr.173320332.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprave penale "*Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara*", "*Falsifikimi i dokumenteve*" dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", parashikuar nga neni 171-25, 186-2 dhe 287/2 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Olizana Pemati.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprave penale "*Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara*" dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 171-25 dhe 287/2 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Mujo Ilazaj, i biri i Mustafa dhe i Ervehe, lindur me 05.03.1983 ne Kote, banues ne adresen rruga Merdar shtylla, qendra Kristal kati 3 apartamenti nr.13, Tirane, arsimi i larte, gjendja civile beqar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Transporti i mbetjeve*", parashikuar nga neni 201/b-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Rami Bunga**, i biri i Zenel dhe i Hasime, lindur me 11.10.1985 ne Burrel, banues ne adresen rruga Riza Cuka, pallati 54/1 Laprakë Tiranë, arsimi i larte, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale “*Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara*” dhe “*Menaxhimi i mbetjeve*”, parashikuar nga neni 171-25 dhe 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Harun Sarica**, mbajtes i dokumentit turk U11460420.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale “*Menaxhimi i mbetjeve*”, parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Arif Shkalla**.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprave penale “*Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara*”, “*Menaxhimi i mbetjeve*”, “*Falsifikimi i dokumentave*” dhe “*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*” të parashikuar nga nenet 171-25, 201/b-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Shaban Hyseni**, i biri i Myfi dhe i Mine, lindur me 07.09.1987 ne Cerrik, Elbasan, banues ne adresen lagja 5 maj, rruga Mustafa Demiri, pallati 726, kati 3 , arsimi i larte, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprave penale “*Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara*”, “*Falsifikimi i dokumenteve*” parashikuar nga neni 171-25 dhe 186/2 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Mirjeta Zotaj**, e bija e Fadil dhe e Gurijs, lindur me 02.05.1976, në Elbasan, banuesë në adresën Elbasan, rruga "Rinia", nd.41/1, h.1, gjendja civile e martuar.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprave penale "*Falsifikimi i dokumentave*" dhe "*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*" të parashikuar nga nenet 186-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në shtëpi*", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Mikail Hila**.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore*", parashikuar nga neni 175 i K.Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Mbarime Koroci**, e bija e Biliman dhe e Dylbere, lindur me 09.04.1958, në Përmet, banuese në adresën "BLV Gjergj Fishta", nd.144, h.11, ap.29, Njësia Administrative nr.7, Tiranë, gjendja civile e martuar.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*" dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga nenet 201/a-2 dhe 287 të Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Nazif Bajrami**, i biri i Pasho dhe Jemine, lindur me 01.11.1968, në Elbasan, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare i martuar, banues në rruga "Nos Josifi", nd.14, h.1, Elbasan, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: **Andon Prifti**, i biri i Pali dhe Fatmire, lindur me 13.10.1991, në Elbasan, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare i

martuar, banues në rruga "Rinia", nd.142, h.1, Elbasan, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Petrit Qosja, i biri i Thoma dhe Bukuri, lindur me 14.06.1971, në Elbasan, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare i martuar, banues në rruga "25 Nëntori", nd.28, h.1, Elbasan, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Julian Kapedani, i biri i Esat dhe Lirije, lindur me 04.07.1977, në Shijak, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, arsimi i lartë, jurist, përgjegjës turni në Sektorin e Kontenierëve në Degën e Doganës Durrës, gjendja familjare i martuar, banues në Durrës, lagjia nr.1, rruga "Epikadeve", pallat 5 katësh prapa hotel "Arvi", hyrja nr.1, kati i 4-t, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore*", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Indrit Likaj, i biri i Toli dhe i Nurijs, lindur me 06.09.1971 ne Durrës, banues në Durrës, Rajoni nr.2, rruga "Feta Bllaca", gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare i martuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore*", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Edmond Voda, i biri i Idaet dhe i Lirije, lindur me 29.06.1967 ne Berat, banues në Tiranë, rruga "S.Delvina", pallati i firmës "M.N



Tirana", k.5, shk.1 gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare i divorcuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore*", parashikuar nga neni 175, i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Helidon Lila, i biri i Skender dhe Violeta, lindur me 08.04.1971, në Durrës, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare i martuar, banues në Durrës, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore*", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Shkelqim Jakupi, i biri i Hasan dhe i Thelleze, lindur me 24.03.1971 ne Kelcyre, banues ne adresen rruga Muhamet Deliu, pallatai Trebeshina, hyrja 17, Tirane, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, arsimi i larte, gjendja familjare martuar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore*", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Florian Çimo, i biri i Safet dhe i Bukurie, lindur me 14.04.1979 ne Durres, banues ne adresen Lagja nr.1, rruga Anastas Durrsaku, pallati Dekon, kati 3 banim Durres, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, arsimi i larte, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar, me nr personal.H90414181H i dyshuar për veprën penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Gazmend Sina, i biri i Rapush dhe i Nexhmije, lindur me 21.10.1971 ne Shijak, banues ne adresen lagja nr.1 rruga Taulantia pallati nr.1044

kati 3, Durrës, arsimi i lartë, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Ingo Hesse, i biri i Manfred Gernot Egingard dhe Lisa, lindur me 30.07.1965, në Gjermani, shtetas gjerman.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Arta Dollani, e bija e Kostandin dhe e Aneta, lindur me 13.04.1980 ne Tirane, banuese ne adresen rruga Sulejman Pasha, pallati Bora, apartamenti nr.14, Tirane, gjinia Femer, shtetësia shqiptare, arsimi i larte, gjendja familjare beqare, gjendja gjyqësore e padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*" në tre raste, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në shtëpi*", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Marjeta Përlala, e bija e Pal dhe e Liza, lindur me 02.05.1989 ne Rreshen, banuese ne adresen rruga Dhimiter Kamarda, pallati nr.6 apartamenti 26, Tirane, gjinia Femer, shtetësia shqiptare, arsimi i larte, gjendja civile beqare, gjendja gjyqësore e padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*" në tre raste, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit "*Arrest në shtëpi*", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Dritan Seferaj, i biri i Ndue dhe i Liza, lindur me 10.11.1983 ne Kecire, Puke, banues ne adresen rruga Njazi Meka Allias banese private, Tirane, gjinia Mashkull, shtetësia shqiptare, arsimi i lartë, gjendja familjare i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në tre raste parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Kledina Skëndo, e bija e Fatmir dhe e Majlinda, lindur me 26.02.1992 ne Tiranë, banuese ne adresen rruga ‘E Durrësit’, nd.81, h.4, ap.25, Njësia Administrative nr.7, Tirane, shtetësia shqiptare, gjendja civile beqare, gjendja gjyqësore e padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Bujana Tonçiça, e bija e Bujar dhe e Lirije, lindur me 28.08.1986 ne Tiranë, banuese ne adresen rruga “Xhanfize Keko”, nd.31, h.1, Njësia Administrative nr.3, gjinia Femer, shtetësia shqiptare, gjendja civile beqare, gjendja gjyqësore e padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Evis Mellonashi, e bija e Gjënçi dhe e Lefteri, lindur me 08.05.1978 ne Tiranë, banuese ne adresen rruga “Agllaia Tako”, nd.16, h.1, Njësia Administrative nr.4, gjinia Femer, shtetësia shqiptare, gjendja civile e martuar, gjendja gjyqësore e padënuar.

DYSHUAR:


Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Kejdi Ahmetaj, i biri i Xhelal dhe i Xhumaje, lindur me 10.04.1993 ne Tiranë, banues ne adresen rruga “Spiro Xega”, nd.10, h.1, Njësia Administrative nr.4, Tirane, gjinia Mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare i martuar, gjendja gjyqësore e padënuar.



DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Iva Musa, e bija e Musa dhe e Vera, lindur me 17.05.1979 ne Kavajë, banuese ne adresen lagja nr.4 rruga Egnatia pallati i bashkimit,Durres, gjinia femer, shtetësia shqiptare, arsimi i larte, gjendja familjare e martuar, gjendja gjyqësore e padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

Xhulio Golgota, i biri i Alfred dhe Milka, lindur me 25.05.1989, në Durrës, gjinia mashkull, shtetësia shqiptare, gjendja familjare, banues në rruga “Rinia”, nd.142, h.1, Durrës, gjendja gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

BAZA LIGJORE:

Nenet 228, 229, 230, 232, 237, 238, dhe 244 të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën dhe aktet bashkëlidhur saj,

VËREN:

I. Rrethanat e faktit dhe Procedura.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesën për: “Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “Arrest në burg”, ndaj personit nën hetim, **Erdal Demir**, i dyshuar për veprën penale “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara” në katër raste, “Transporti i mbetjeve”, “Menaxhimi i mbetjeve”, “Falsifikimi i dokumenteve” në dy raste, “Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga nenet 171-25, 201/b-25, 201/a-25, 186 dhe 287/2 të Kodit Penal, Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest me burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Yusuf Sezai Kurum**, i dyshuar për veprat penale “Menaxhimi i mbetjeve”, “Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga

nenet 201/a-25 dhe 287/2 të Kodit Penal, Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Gjovana Sokolaj** e dyshuar për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara" në katër raste, "Falsifikimi i dokumenteve", "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nenet 171-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Doni Sokolaj** i dyshuar për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara", "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 171-25, 186-2 dhe 287/2 i Kodit Penal, Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Olizana Pemati** e dyshuar për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 171-25 dhe 287/2 i Kodit Penal, Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Mujo Ilazaj**, i dyshuar për veprën penale "Transporti i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/b-25 i Kodit Penal, Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Rami Bunga**, i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara" dhe "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga neni 171-25 dhe 201/a-25 i Kodit Penal, Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Harun Sarica**, i dyshuar për veprën penale "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Arif Shkalla**, i dyshuar për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara", "Menaxhimi i mbetjeve", falsifikimi i dokumentave" dhe "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nenet 171-25, 201/b-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Shaban Hyseni**, i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara", "Falsifikimi i dokumenteve" parashikuar nga neni 171-25 dhe 186/2 i Kodit Penal, Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest në shtëpi"**, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj **Mirjeta Zotaj**, e dyshuar për veprat penale "Falsifikimi i dokumentave" dhe "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nenet 186-25 dhe 287/2 të Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Mikail Hila** i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", parashikuar nga neni 175 i K.Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Mbarime Koroci**, e dyshuar për veprat penale "Menaxhimi i mbetjeve" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga nenet 201/a-2 dhe 287 të Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Nazif Bajrami**, i dyshuar për veprën penale "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues **"Arrest me burg"**, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale,

ndaj **Andon Prifti**, i dyshuar për veprën penale "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Petrir Qosja**, i dyshuar për veprën penale "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Julian Kapedani**, i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Indrit Likaj**, i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Edmond Voda**, i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", parashikuar nga neni 175, i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Helidon Lila**, i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Shkelqim Jakupi**, i dyshuar për veprën penale "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Florian Çimo**, i dyshuar për veprën penale "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Gazmend Sina**, i dyshuar për veprën penale "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Ingo Hesse**, i dyshuar për veprën penale "Menaxhimi i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj **Arta Dollani**, e dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" në tre raste, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj **Marjeta Përlala**, e dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", në tre raste, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Dritan Seferaj**, i dyshuar nën hetim për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", në tre raste parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj **Kledina Skëndo**, e dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj **Bujana Tonçiça**, e dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj **Evis Mellonashi**, e dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni



248 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Kejdi Ahmetaj**, i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale. ndaj **Iva Musa**, e dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj **Xhulio Golgota**, i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

Gjykata përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe prova të kërkesës penale, analizoi kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 3/2, 69, 74 dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P), gjykata çmon se çështja objekt gjykimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të saj.

Nga studimi i akteve të procedimit penal rezulton se: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mbi bazën e materialeve hetimore të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës dhe Drejtoria e Hetimit Doganor Tiranë, ka regjistruar procedimet penale Nr.1596 datë 14.08.2024, Nr.1611 datë 19.08.2024 dhe Nr.1612 datë 19.08.2024, procedime të cilat janë bashkuar në një procedim të vetëm atë me Nr.1596 datë 14.08.2024, për veprat “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara”, parashikuar nga neni 171 i Kodit Penal, “Transportimi i mbetjeve”, parashikuar nga neni 201/b i Kodit Penal, si dhe “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Me shkresën Nr.17267 prot. datë 13.08.2024 të Drejtorisë së Hetimit Doganor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është referuar materiali hetimor, për veprën penale “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara”, parashikuar nga neni 171 i Kodit Penal. në ngarkim të shtetases Gjovana Sokolaj, administratore e subjektit Sokolaj sh.p.k. me NIPT K64312403D.

Nga aktet e këtij materiali referues rezulton se, me e-mail të dërguar nga Drejtoria Antitrafik datë 13.08.2024, është përcjellë një memo e shkurtër dhe dokumenta në lidhje me eksportin e dyshimtë të oksidit të hekurit. Ndërsa, në datë 25.07.2024, janë njoftuar nga OLAF (European Anti-Fraud Office-European Commission), për një ngarkesë se dyshohej që mund të transportonte mbetje nga Shqipëria në Tailandë. Njoftimi i OLAF përmbante një listë kontenierësh dhe fotografi të mallrave të dyshuara gjatë procesit të ngarkimit në portin e Durrësit.

Që nga ky moment, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe OLAF kanë bashkëpunuar në mënyrë aktive për identifikimin dhe verifikimin e ngarkesës. Edhe pse numrat e kontenierëve nuk përputheshin, është arritur të identifikohej deklarata doganore bashkëngjitur ngarkesës së dyshimtë, bazuar në llojin e mallrave dhe destinacionin.

Të dhënat e transportuesit janë shkëmbyer me partnerët, për të asistuar në lokalizimin e ngarkesës, e cila ishte ndarë në dy mjete transporti. Itinerarët ishin Durrës-Triste-Singapor-Tailandë dhe Durrës-Pire-Singapor-Tailandë.

Subjekti Sokolaj sh.p.k., në datë 04.07.2024, ka eksportuar 2,816,300 kg Oksid Hekuri (Zn) drejt Tailandës, me vlerë 140.815 USD me tvsh.

Sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti, mallrat ishin blerë pranë Kurum International sh.a., me vlerë 40.800USD.

Nga verifikimi në sistemin Asycuda Word, rezulton se ky subjekt ka kryer edhe dy eksporte të tjera me këtë natyrë malli "Oksid Hekuri (Zn), përkatësisht me deklaratat doganore EX.1 R11842 datë 27.03.2024 dhe EX.1 R15663 datë 22.04.2024.

Bashkëlidhur referimit janë dërguar edhe praktikat e këtyre eksporteve. **Materiali i mësipërm është regjistruar si procedimi Nr.1596 datë 14.08.2024, për veprën penale "Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara", parashikuar nga neni 171 i Kodit Penal.**

Me shkresën Nr.5268 prot. datë 16.08.2024, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ka referuar materialin hetimor, për veprat penale të parashikuara nga nenet 174, 180 dhe 202 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve Gjon Sokolaj, Gjovana Sokolaj dhe Doni Sokolaj.

Nga aktet e këtij materiali referues rezulton se, më datë 13.08.2024, në faqen online të internetit www.shqiptarja.com, është publikuar linku <https://shqiptarja.com/lajm/mbetie-te-rezikshme-nga-shqiperia-drejt-tajlandes-reagon-dreitoriae-doganave-po-bashkepunime-me-olaf-per-te-lokalizuar-ngarkesen>. Nga përmbajtja e këtij shkrimi jepet informacion se, nga Porti Durrës është nisur një anije e ngarkuar me kontenierë, e cila dyshohet se transporton rreth 800 ton mbetje toksike.

Nga ana e Seksionit të Hetimit të Krimit Ekonomik pranë DVP Durrës, janë kryer verifikime për të identifikuar konkretisht se cila anije ishte nisur, datën kur është nisur, ngarkesën që ka pasur, cilat subjekte kanë dërguar produkte me destinacion Tailandën.

Nga verifikimet paraprake rezultoi se, anija është nisur më datë 04.07.2024 nga Porti i Durrësit, dhe mbetjet të cilat dyshohen se janë toksike, janë nisur nga subjekti Sokolaj sh.p.k., me NIPT K64312403D, me administratore shtetasen Gjovana Kol Sokolaj.

E pyetur nga policia gjyqësore, **shtetasja Gjovana Sokolaj**, ka deklaruar se, është e vetëpunësuar në biznesin e saj tek subjekti Sokolaj sh.p.k., me NIPT 1643124031. Më datë 04.07.2024, ky subjekt ka nisur rreth 102 kontenierë të ngarkuar me Oksid Hekuri, me destinacion Tailandën. Produktin e ka blerë nga shoqëria Kurum International sh.a. (në vijim Kurum), më datë 03.10.2023, ka blerë 2000 ton kundrejt pagesës prej 34.000 USD dhe më datë 16.11.2023, ka blerë rreth 800 ton kundrejt pagesës prej rreth 7.000 USD. Për secilën pagesë është paisur me faturat përkatëse. Interes për blerjen e Oksidit të Hekurit ka shfaqur subjekti GS Minerals d.o.o., me seli në Kroaci dhe për këtë arsye sasinë prej 2.800 ton Oksid Hekuri ia ka shitur këtij subjekti me çmimin prej rreth 141.000 USD. Pas ngarkimit të 102 konternierëve në anijen tregtare, është bërë nisja nga Porti i Durrësit më datë 04.07.2024. Më pas, në datë 09.08.2024, i është dërguar një email nga MSC (Kompani Kontenierësh dhe Transporti Detar Ndërkombëtare), e cila e ka informuar se 102 konternierët do ktheheshin në Portin e Durrësit (origjinë), sepse Porti i Singaporit nuk prante të bënte shkarkimin, për shkak të dyshimit se kontenierët ishin të mbushur me lëndë toksike. Gjovana ka deklaruar se, i ka kthyer përgjigje nëpërmjet e-mailit MSC-së duke i thënë se për mallin e ngarkuar në konternierët që është Oksid Hekuri, janë bërë analizat nga ana Sokolaj sh.p.k. dhe Kurum, dhe nuk rezulton që aty të ketë mbetje toksike. Gjithashtu, u ka propozuar që mund të bëjnë mostrimin e produktit në Portin e Singaporit, por ata i kanë thënë që duhet të kryente pagesën për kryerjen e analizave. Shtetasja Gjovana Sokolaj ka deklaruar gjithashtu se, gjatë vitit 2024 ka kryer 2 ose 3 eksporte me destinacion Tailandën me Oksid Hekuri dhe nuk ka pasur asnjë lloj problematike

për këto eksporte. Për kryerjen e analizave ka nisur një mostër/kampion që analizat të bëheshin në Kroaci, më datë 07.04.2024 dhe përgjigja i ka ardhur më datë 21.04.2024. Nga përgjigjet e analizave, produkti Oksid Hekuri nuk është toksik. Analiza gjithashtu ka bërë dhe subjekti Kurum.

E pyetur në lidhje me subjektin GS Minerals d.o.o., me NIPT HE61130788157, me adresë, Kroaci, shtetasja Gjovana Sokolaj, ka deklaruar se është administratore e këtij subjekti, të cilin e ka hapur prej rreth 3 vitesh. Ky është subjekt "brooker" pasi bëjnë lidhjen e marrëveshjeve, kontratave me subjekte ndërkombëtare.

Shtetasja Gjovana Sokolaj, me procesverbalin e datës 14.08.2024 ka dorëzuar kopje të:

- Deklaratës doganore R 27224 datë 04.07.2024;
- Faturës elektronike tatimore 88/2023 Korrigjuese datë 03.10.2023, me shitës shoqërinë Kurum International sh.a. dhe blerës shoqërinë Sokolaj sh.p.k., për shitjen e 2.000 t Oksid Hekuri;
- Faturës nr.58/2024 datë 03.07.2024, me shitës Sokolaj dhe blerës GS Minerals d.o.o., Kroaci, të sasisë prej 2,816.30 ton Oksid Hekuri (ZN), me vlerë 140.815 USD;
- Faturës Nr.13/2024 date 27.03.2024, me shitës Sokolaj sh.p.k. dhe blerës GS Minerals d.o.o., Kroaci, të sasisë prej 637.74 ton Oksid Hekuri (Zn), me vlerë 31.887.00 USD;
- Faturës Nr.28/2024 datë 22.04.2024, me shitës Sokolaj sh.p.k. dhe blerës GS Minerals d.o.o., Kroaci, të sasisë prej 81.36 ton oksid Hekuri (Zn), me vlerë 4,068.00 USD;
- Fletës së analizës në gjuhën kroate, datë 07.04.2024, në emër të CEMTRA d.o.o., për llogari të GS Minerals d.o.o., lëshuar në datë 21.04.2024, sipas së cilës vlerat më të larta i përkasin Total Fe2 O3 në vlerën 84.78 dhe Fe në vlerën 59.30, e përbërë nga dy fletë;
- Fletës së analizës datë 11.10.2023 e Kurum International sh.a., sipas së cilës vlerat më të larta i përkasin Total Fe në vlerën 77.84 dhe FeO në vlerën 72.08, e përbërë nga një fletë.

Nga këqyrja e linkut <https://sa.kompass.com/c/gs-minerals-d-o-o/hr723390/#> rezulton se subjekti GS Minerals d.o.o., ndodhet në Obitelji Duiz 4, Rijeka Kroaci, me numër identifikimi 61130788157, themeluar në vitin 2021, me numër regjistrimi 040426434, administrator është shtetasja Gjovana Sokolaj.

Materiali i mësipërm është regjistruar si procedimi penal Nr.1611 datë 19.08.2024, për veprat penale të parashikuara nga nenet 171 dhe 248 dhe 201/b të Kodit Penal.

Me shkresën Nr.2413 prot. datë 15.08.2024 të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës, është referuar materiali hetimor, për veprën penale "Transportimi i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/b i Kodit Penal.

Nga aktet e këtij materiali referues rezulton se, më datë 13.08.2024, është marrë informacion se në median e shkruar dhe atë vizive, si "Shqiptarja.com/lajm" dhe "Balkan Web.com", ndër të tjera është shkruajtur: "Mbetje të rrezikshme nga Shqipëria, nga Durrësi drejt Tajlandës", "Një ngarkesë e madhe toksike doli nga Porti i Durrësit, 2 anijet me 100 kontenierë kanë fikur GPS", ku sipas këtyre mediave, anijet me emrat "MSC CALEDONIA II" dhe "CONTSHIP VOW", janë nisur nga porti detar Durrës të ngarkuara me 100 kontenierë, me një ngarkesë prej 800 ton pluhur të rrezikshëm dhe mbetje toksike."

Duke marrë shkas nga ky informacion, nga shërbimet e policisë së DVKM Durrës, është shkruar në degën e Doganës Durrës, ku është mbajtur procesverbal këqyrje dhe marrje i provës materiale mbi praktikën doganore të nisjes nga porti detar i Durrësit i 2 (dy) anijeve të përshkruara më lart, ku sipas deklaratës doganore me numër R 27224, 2 (dy) anijet janë nisur nga porti detar

Durrës më datë 04.07.2024, me 102 (njëqind e dy) kontenierë, me eksportues Sokolaj sh.p.k., me Nipt K64312403D, lloji i eksportit "Okside dhe hidrokside hekuri Jo Dual Use OKSID HEKURI (ZN)=2.816.300 kg."

Nga policia gjyqësore është administruar praktika doganore nga Agjencia Doganore Joti Spedition, agjenci e cila ka kryer praktikën doganore për anijen M/V CONTSHIP VOW, nr.R27224 datë 04.07.2024.

Nga kjo praktikë dokumentare rezulton se, është gjeneruar faturë elektronike tatimore 88/2023 Korrigjuese datë 03.10.2023, me kod operatori cc924cg033, me shitës shoqërinë Kurum International sh.a. dhe blerës shoqërinë Sokolaj sh.p.k., ku janë shitur 2.000 t **Oksid Hekuri**.

Me faturën tatimore të shitjes nr.58/2024 datë 03.07.2024, shitësi Sokolaj, i ka shitur GS Minerals d.o.o., me adresë Rijeka, Kroaci, sasinë prej 2,816.30 ton **Oksid Hekuri (ZN)**, me vlerë 140.815 USD, e konvertuar në 13.095.795 lekë.

Më datë 04.07.2024, është hartuar deklarata doganore R27224, nga agjencia doganore Joti Spedition, me të dhënat:

- Eksportues: Sokolaj sh.p.k.
- Marrësi: GS Minerals d.o.o
- Vend origjine: Albania
- Vendi i destinacionit: Tailandë
- Mjeti i transportit: M/V CONTSHIP VOW, It
- Numri i kontenierëve: 102
- Përshkrim mallit: "Okside dhe hidrokside hekuri Jo Dual Use OKSID HEKURI (ZN) = 2.816.300 KG
- Shuma totale në faturë: 140,815.00 USD,
- Kodi tarifar: 28211000
- Mjeti i transportit M/V CONTSHIP VOW, It

Rezulton se në këtë praktikë është dhe autorizimi datë 14.11.2023, ku administratorja e shoqërisë Sokolaj sh.p.k. autorizon agjencinë doganore Joti Spedition si përfaqësues të tërthortë për deklarimin e mallrave të ardhura në emrin e saj.

Me procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale datë 13.08.2024, është administruar nga dega e Doganës Durrës, dokumentacion i transportit për anijet: MSC CALEDONIA II dhe CONTSHIP VOW, me destinacion Cooper Mteal co. LTD NO.66, Moo.8Wungpreng, Sup-District, Khoksamrong District, Lopburi Province, Thailand.

Materiali i mësipërm është regjistruar si procedimi penal Nr.1612 datë 19.08.2024, për veprat penale të parashikuara nga nenet 171 dhe 248 dhe 201/b.

Procedimet penale të sipërcituara me nr.1596, nr.1611 dhe nr.1612, u bashkuan me vendimin datë 19.08.2024, në një procedim të vetëm, atë me nr.1596 viti 2024, pasi i referoheshin të njëjtit fakt penal, dyshimit të eksportimit të sasisë prej 2.816.300 kg mbetje të rrezikshme nga subjekti Sokolaj sh.p.k., sipas deklaratës doganore nr. R 27224 datë 04.07.2024.

Në funksion të këtij procedimi penal, me shkresën nr.3023 prot. datë 20.08.2024, i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, informacion në lidhje me deklaratën doganore R27224 datë 04.07.2024, kodin tarifar për artikullin Oksid Hekuri, nëse është marrë kampion mostre, nëse janë kryer verifikime apo janë shkëmbyer informacione me organizata botërore

të doganave, SELEC, OLAF, autoritetet doganore të Kroacisë dhe nëse ka pasur raste të mëparshme të eksportimit të artikullit Oksid Hekuri (Zn) me kod tarifor 28211000.

Në përgjigje të kësaj shkrese, oficeri i policisë gjyqësore në Drejtorinë e Hetimit Doganor, pjesë e grupit hetimor të këtij procedimi penal, ka përpiluar informacionin datë 20.09.2024. bashkëlidhur të cilit ndër të tjera është administruar edhe korespondenca e autoriteteve doganore shqiptare me Ministrinë e Mjedisit, OLAF, autoritetet doganore kroate etj.

Nga korespondenca me e-mail m autoritetet doganore të Kroacisë rezulton si vijon: Shoqëria GS Minerals d.o.o. nga Rijeka, Obitelji Duiz 4, është regjistruar në Regjistrin Gjyqësor të Gjykatave Tregtare në Rijeke me nr (MBS): 040426434, OIB (Numri i Identifikimit Personal): 61130788157. Kapitali aksionar i shoqërisë është 20.000,00 kn/2.654,46 euro, dhe aktivitet mbizotërues është “ndërmjetësimi në tregtimin e produkteve të ndryshme”. Personat e autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë janë: Gjovana Sokolaj, Anëtar i Bordit Drejtues dhe Gjoni Sokolaj, Administrator. Kompania GS Minerals d.o.o., është 100% pronësi private dhe është themeluar në vitin 2021. Themelues i Sokolaj nga Shqipëria, Shënavlash Vath - Turja, ZK 8517, Durrës, (Numri i regjistrimit të Shqipërisë OIB:13024649926). Sipas Gjoni Sokolaj, edhe shoqëria Sokolaj nga Shqipëria është 100% në pronësi të familjes së tyre dhe vetëm Gjovana Sokolaj është e punësuar në të njëjtën shoqëri.

Nga kontrolli u konstatua se, shoqëria nuk ka mjedise tregtare të vetat, por është e regjistruar në adresën e banesës së saj në qendrën e gjerë të Rijekës (Banderovo) dhe ka një të punësuar, drejtorin Gjovana Sokolaj, e cila aktualisht nuk ndodhet në Kroaci, por i ka kontaktuar me telefon oficerët doganorë dhe i ka informuar se i gjithë informacioni i nevojshëm, dokumentet e punës do t'i vihen në dispozicion nga bashkëshorti i saj Gjoni Sokolaj, i cili nuk është i punësuar nga shoqëria, por renditet si një administrator.

Kontrolli nisi në mjediset e shërbimit të kontabilitetit duke dorëzuar “Njoftimin e Kontrollit Tatimor”. Në ditën e kontrollit, **Gjoni Sokolaj deklaroi se**, shoqëria GS Minerals d.o.o. merret ekskluzivisht me ndërmjetësimin e tregtisë ndërmjet Shqipërisë dhe Azisë dhe se mallrat për të cilat ata kryejnë ndërmjetësimin, nuk vijnë fizikisht në Kroaci, por dorëzimi bëhet në një mënyrë të tillë që mallrat ngarkohen në konteinerë në portin e Durrësit, Shqipëri, dhe anija nga Shqipëria shkon në portet e destinacionit në Azi, përkatësisht: Leam Chabang-Tajlandë dhe Ningbo-Kinë. **Sokolaj i blen mallrat-okside (hekur, zink dhe bakr...) dhe koncentre nga Kurum International sh.a., Kombinati Metalurgjik Bradashesh Elbasan, Shqipëri dhe paraqiti specifikimin e mallrave datë 11.10.2023 bashkëlidhur këtij raporti (që nga aktet rezulton të jetë fletë analizë e Kurum International sh.a.).**

Më tej, Gjoni Sokolaj deklaroi se, kodi tarifor (28211000) ishte deklaruar në mënyrë të saktë në deklaratat shqiptare, **megjithatë përshkrimi i mallit ishte i pasaktë**. I pyetur se përse, pasi konstatoi se në deklarata ishin plotësuar gabimisht të dhënat, nuk u kërkuar korrigjimi i të dhënave në doganën shqiptare, ai u shpreh se nuk ishte i informuar se mund të kërkohej një gjë e tillë. Kurum International sh.a. fabrika nga Shqipëria ia ka dorëzuar mallrat Sokolaj sh.p.k. nga Shqipëria sipas faturave nr.88/2023 dhe nr.19107/2023 dhe në përshkrimin e mallit thuhet: **OKSID HEKURI**. Të njëjtat mallra (të cilat përshkruhen në këtë kontratë: **hekur, zink dhe bakr... dhe koncentre**), i janë rishitur GS Minerals d.o.o. Kushtet e shitjes përcaktohen nga kontrata Nr.01.10.2023 datë 1 Tetor 2023, lidhur midis Sokolaj sh.p.k. nga Shqipëria dhe GS Minerals d.o.o. nga Kroacia. Sokolaj sh.p.k. lëshoi faturat për GS Minerals d.o.o.:

- Nr.13/2024 datë 27.03.2024, për 637.74 ton Oksid Hekuri (Zn), me vlerë 31.887.00 USD, paguar në datë 27.03.2024;
- Nr.28/2024 datë 22.04.2024, për 81.36 ton oksid Hekuri (Zn), me vlerë USD 4,068.00;
- Nr.58/2024 datë 03/07/2024, për 2,816.30 ton Oksid Hekuri (Zn), me vlerë USD 140,815.00.

Faturat janë regjistruar në librat e shoqërisë të personit të kontrolluar në llogarinë 221.

GS Minerals d.o.o. ia rishet mallrave shoqërive:

1. Terry Thriving Trade Limited nga Hong Kong, Workshop 60, 30/F, Block A, East Sun industrial center, No. 16, Shing Yip street, KL, e-mail: pooh.jenny@evergresource.com , tel. +86 755 23903678, llogaria bankare: 157200840 - DBS Bank (Hong Kong).

Kontrata është lidhur në datë 24 Tetor 2023, për blerjen dhe shitjen e oksideve dhe koncentrateve të ndryshme (FEO dhe ZNO). Për më tepër, në kontratë thuhet se porti i ngarkesës është Porti i Durrësit, Shqipëri dhe porti i shkarkimit është LAEM CHABANG TAJLAND.

2. North Creek Resource PTE. LIMITED nga Singapori, 5 Temasek Boulevard, #08-03A, Suntec Tower Five, email: nora@nckresorce.com, tel. +8617620362340.

Kontrata është lidhur në datë 16.04.2024, për blerjen dhe shitjen e oksid hekuri dhe si port i ngarkesës listohet Porti i Durrësit Shqipëri, dhe porti i shkarkimit Porti NINGBO/ ZHOUSHAN, KINË.

Mallrat në fjalë janë dorëzuar sipas deklaratave:

1. 24AL142000011842R8 dt. 27.03.2024, 637,740 kg bruto OKSID HEKURI (GNI), me një vlerë totale prej USD 31,887.00, kreu 28211000 (nën-kapitulli IV-baza inorganike; okside, hidrokside dhe perokside të metaleve/ Okside hekuri dhe hidrokside hekuri, dhera të ngjyrosura që përmbajnë ndaj peshës 70% apo më shumë hekur të kombinuar të vlerësuar si $\text{Fe}_{2}\text{O}_{3}$, okside hekuri dhe hidrokside).

Për këtë dërgesë GS Minerals d.o.o. lëshoi faturën numër 5-1-1 dt. 02.04.2024 në vlerën 78,818,00 USD për shoqërinë Terry Thriving Trade Limited nga Hong Kongu. Në faturë thuhet emri i mallit: **HQ IRON OXIDE**. Vlera është regjistruar në llogaritë e personit të kontrolluar në llogarinë 121 për një shumë prej 66 458,33 euro.

2. 24AL142000015663R6 dt. 22.04.2024- 81,360 kg bruto OKSID HEKURI (GNI), me një vlerë totale prej USD 4,068.00, kreu 28211000 (nën-kapitulli IV -baza inorganike; okside, hidrokside dhe perokside të metaleve/Okside hekuri dhe hidrokside hekuri, dhera të ngjyrosura që përmbajnë ndaj peshës 70% apo më shumë hekur të kombinuar të vlerësuar si $\text{Fe}_{2}\text{O}_{3}$, okside hekuri dhe hidrokside).

Për këtë dërgesë GS Minerals d.o.o. lëshoi faturën numër 12-1-1 dt. 24.08.2024, në shumën 24,000.00 USD për shoqërinë North Creek Resource PTE. LIMITED nga Singapori, me adresë NINGBO CHINA parity. Në faturë thuhet emri i mallit: **HQ IRON OXIDE**. Vlera është regjistruar në llogaritë e personit të kontrolluar në llogarinë 121 për një shumë prej EUR 21,580.79.

3. 24AL142000027224R7 dt. 04/07/2024 - 2.816.300 kg bruto, me një vlerë totale prej USD 140.815.00, kreu 28211000 (nën-kapitulli IV -baza inorganike; okside, hidrokside dhe perokside të metaleve/Okside hekuri dhe hidrokside hekuri, dhera të ngjyrosura që përmbajnë ndaj peshës 70 % apo më shumë hekur të kombinuar të vlerësuar si $\text{Fe}_{2}\text{O}_{3}$, okside hekuri dhe hidrokside).

Për dërgesën e lartpërmendur, GS Minerals d.o.o. lëshoi faturat për pagesat paradhënie të marra për Terry Thriving Trade Limited nga Hong Kongu:

-Nr 10/1/1 dt 31.07.2024 në shumën 58,989.06 USD,

-Nr 9/1/1 dt. 31.07.2024 në shumën 60,439.50 USD

-Nr 8/1/1 dt. 31.07.2024 në shumën 63,387.90 USD.

Faturat tregojnë emrin e mallrave: **HQ IRON OXIDE**.

Vlera në llogaritë e personit të kontrolluar u regjistrua në llogarinë 121 për shumat EUR 54 498.39, EUR 55 838.41 dhe EUR 58 562.36 (një total prej EUR 114 455.26).

Në bazë të kërkesës së autoriteteve doganore kroate, Gjoni Sokolaj deklaroi se, nuk i njeh klientët e shoqërive Terry Thriving Trade Limited nga Hong Kongu dhe North Creek Resource PTE. Limited nga Singapori, të cilëve u shitën mallrat në fjalë, dhe se dërgesa sipas deklaratës 24AL142000027224R7 dt. 04.07.2024 nuk ka mbërritur ende në destinacion dhe se ka dijeni se nuk do të merret përsipër për shkak të dyshimit nga ana e blerësit për saktësinë e deklarimit të mallrave.

Nga kontrolli në sistemit IT, u kontaktua se shoqëria GS Minerals d.o.o. nuk ka pasur importe dhe eksporte në vitin 2023 dhe 2024, në territorin e Republikës së Kroacisë.

Përsa i takon pyetjes lidhur me shoqërinë CEMTRA d.o.o., autoritetet doganore kroate përgjigjen se, nga konsultimi në aplikacionin Info.BIZ, kanë konstatuar se ajo është e regjistruar në Republikën e Kroacisë në Vlaska 67, Zagreb, PIN-OIB: 11423745914 dhe merret me kontrollin e cilësisë së produktit dhe ekologjisë dhe i kryen këto analiza në një laborator kimik dhe një laborator fiziko-mekanik. Në Regjistrin e Gjykatës Tregtare në Zagreb është i regjistruar me nr. MBS: 080384671.

Gjoni Sokolaj deklaroi se, ka paguar organin kontrollues të lartpërmendur për të kryer analizën e mostrave të mallrave dhe se e ka dërguar mostrën në adresën e tyre me postë në sasi të vogla (nën 1 kg) dhe i ka çuar mostrat nga Shqipëria në Kroaci me makinë.

Për mostrën shoqëria e kontrollit CEMTRA d.o.o. ka lëshuar faturat e mëposhtme për kompaninë GS Minerals d.o.o., të cilat i janë dorëzuar autoriteteve doganore kroate nga GS Minerals d.o.o. gjatë kontrollit:

- fatura Nr 101-PP1/1 dt. 15 August 2023 për analizën e mineralit të hekurit
- fatura Nr. 122-PP1/1 dt.30.04.2024 për analizën e piritit të skuqur
- fatura nr. 120-PP1/1 dt. 29.04.2024 për analizën e koncentratit të bakrit.

Bashkëngjitur informacionit edhe kopje të akteve që përmenden në këtë informacion.

Në kushtet kur ekzistonte dyshimi se, materiali i eksportuar nga subjekti Sokolaj sipas deklaratës së eksportit datë 04.07.2024, mund të përbënte mbetje të rrezikshme dhe në kushtet kur i njejtin subjekt rezultonte të kishte kryer për periudhën nëntor 2023-korrik 2024, katër eksporte për të njejtin lloj malli "Oksid Hekuri (Zn)", për të cilat kishte paraqitur të njejtat fatura blerjeje nga Kurum (si origjinë malli), me të njejtin destinacion Tailandë, në pritje të kthimit të kontenierëve në Portin Durrës, nga organi procedues u kryen veprimet hetimore si më poshtë:

Është kërkuar në gjykatë lejimi i kontrollit të ambienteve të subjekteve Sokolaj sh.p.k. dhe Kurum International sh.a., kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr.584/2 datë 27.08.2024

të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Në zbatim të këtij vendimi nga policia gjyqësore janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale në datë 28.08.2024:

-Në ambientet e shoqërisë Kurum u sekuestruan dy mostra, njëra me peshë 10 kg që sipas shoqërisë është e njejtë me atë që i është shitur shoqërisë Sokolaj sh.p.k. (oksid hekuri) dhe mostra e dytë me peshë 6 kg me mbetje të ngurtë e përfutur nga çlirimi i gazvrave të shoqërisë Kurum International.

-Në ambientet e shoqërisë Sokolaj sh.p.k. u sekuestruan dy mostra të gjetura në depozituara, për të cilat administratorja e kësaj shoqërie Gjovana Sokolaj ka deklaruar se materiali është pluhur zinku.

Në vijim, është administruar nga shoqëria Kurum dhe Agjensia Kombëtare e Mjedisit (në vijim AKM), dokumentacioni në lidhje me deklaratimet dhe vetmonitorimet e kryera nga subjekti Kurum si një gjenerues mbetjesh me detyrimin për deklaratim në zbatim të Ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Nga ky dokumentacion rezultoi se Kurum, i kishte shitur shoqërisë Alliance Resource sh.p.k., llojin e mbetjes me kod 10 02 07*, e cila kategorizohet si mbetje e rrezikshme. Për këtë arsye, në datë 30.10.2024 është proceduar me këqyrje dhe marrje nga shoqëria Alliance Resource sh.p.k. e katër mostrave me përmbajtje të ndryshme sipas përshkrimit në procesverbal.

Në vijim, me shkresën e datës 28.10.2024, të Drejtorisë së Hetimit Doganor, na është dërguar informacioni dhe dokumentacioni i dërguar me e-mail nga Dega e Doganës Durrës, në lidhje me mbërritjen e anijes Moliva XA443A në datë 28.10.2024, ngarkuar me 199 kontenierë sipas Manifestit.

Gjithashtu, me shkresën e sipërcituar na është dërguar edhe informacioni dhe dokumentacioni i mbajtur në Turqi në lidhje me kontenierët objekt hetimi, i dërguar me e-mailin e datës 18.10.2024 nga përfaqësuesi i OLAF Z. Luigi Garruto.


Me shkresën Nr.4005 prot datë 13.11.2024, i është kërkuar kompanisë së transportit Mediterranean Shipping Company s.a. (në vijim MSC), të dhëna në lidhje me itinerarin e përshkruar nga kontenierët objekt sekuestrimi, që nga nisja nga Porti i Durrësit në datë 04.07.2024 deri në mbërritjen e tyre në këtë port në datë 28.10.2024, vendet e ndalimit, ditët e qëndrimit, nëse nga ndonjë autoritetet kompetent të ndonjë prej porteve ku anijet që transportonin kontenierët kanë ndaluar dhe qëndruar është ushtruar kontroll, verifikim apo ndonjë veprim tjetër dhe dërgimin e kopjes së dokumentacionit të mbajtur për këtë qëllim. Gjithashtu, i është kërkuar të na vihet në dispozicion çdo komunikim me ndonjë subjekt dërgues, pritës apo palë të interesuar në lidhje me transportimin e këtyre kontenierëve.

Me shkresën Nr.989 prot. datë 19.11.2024 të MSC, na është bërë me dije se,

-Korespodencat i janë vënë në dispozicion më parë o.p.gj. (nga aktet rezulton se janë dorëzuar sipas procesverbalit datë 30.08.2024)

-Itinerari i përshkruar nga anijet që kanë kryer transportin e kontenierëve nga data 04.07.2024 deri në datë 08.11.2024.

-MSC është informuar se është kryer një inspektim në portin Tekirdag Turqi dhe i janë vënë në dispozicion disa shkresa, kopje të të cilave i ka dërguar bashkëlidhur shkresës.



Vlen të theksohet se kopje të dokumentave që janë mbajtur në portin Tekirdag Turqi, janë të njejta me ato që janë dërguar edhe me shkresën e datës 28.10.2024, të Drejtorisë së Hetimit Doganor të dërguara nga përfaqësuesi i OLAF Z. Luigi Garruto.

Nga këto dokumenta rezulton se janë hapur dhe mbyllur kontenierët duke vendosur plumce të tjera si vijon:

- Sipas raportit nr.25015 datë 10.10.2024 kontenierët: MEDU6037524 dhe SEGU3665924;
- Sipas raportit nr.25023 datë 14.10.2024 kontenierët: CRXU3222340, DFSU2909804, FCIU2950907, FCIU6275880, FCIU6433498, FCIU6444980, GESU3666675, GLDU2960193, GLDU9452240, IRNU2024514, MEDU1962700, MEDU2604023, MEDU2957870, MEDU3578593 dhe MEDU3834503;
- Sipas raportit nr.25024 datë 11.10.2024 kontenierët: MEDU5814403, MEDU6073964, MSCU3490588, MSDU2122728, MSMU1569390, MSNU3180966, MSNU3312276, TCLU2975734, TEMU2062270, TGBU2666434, TGBU2703728, TGHU1577777, TRHU2817391, TRLU9100013, TTNU1206400 dhe TTNU2198803;
- Sipas raportit nr.25058 datë 16.10.2024 kontenierët: GLDU5205489, HPCU2528950 dhe TRHU1554264;
- Sipas raportit nr.25068 datë 17.10.2024 kontenierët: MSMU2055565 dhe GESU1434829.

Në funksion të këtij procedimi penal u procedua me **vendimin për sekuestrimin në cilësinë e provës materiale të 102 kontenierëve** sipas deklaratës doganore R 27224 datë 04.07.2024. Për shkak të numrit të lartë të kontenierëve dhe depozitimit të tyre në një vend të sigurt, si përsa i përket sigurisë mjedisore dhe asaj fizike (nëpërmjet monitorimit me kamera 24 orë), procedura e ekzekutimit të vendimit të sekuestrimit, u bë në koordinim me Autoritetin Portual Durrës, Kapitenerinë Detare Durrës, Degën e Doganës Durrës, Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës, Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës dhe Drejtorinë e Hetimit Doganor.

Sekuestrimi u krye në datë 08.11.2024 dhe nga policia gjyqësore u mbajt procesverbali i sekuestrimit i shoqëruar me listën e kontenierëve, duke përshkruar: numrat e kontenierëve, kodet e sigurisë përfshirë edhe ato të vendosura në portin Tekirdag Turqi, gjendjen fizike, fletët e peshimit.

Gjatë procesit të sekuestrimit, kontenierët ju nënështroan edhe testit për radioaktivitet, i cili u zhvillua në bazë të një plani masash të hartuar nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, datë 08.11.2024. Mjeti MDS me targë AA 810 YZ, me paisjen skanuese për Dedektimin e Lëndëve Radioaktive, u dislokua në portin e Durrësit, në sheshin e kontenierëve, rreth orës 06.30 min të datës 08.11.2024 në pritje të shkarkimit të 102 kontenierëve nga anija MOLIVA XA 443 A. Skanimi i kontenierëve filloi rreth orës 08.00 min të datës 08.11.2024 dhe përfundoi në orën 01.00 min të datës 09.11.2024. Nga skanimi i 102 kontenierëve paisja skanuese që ndodhet në mjetin e lëvizshëm MDS nuk kostatoi prani të lëndës radioaktive GAMA apo NEUTRON.

Gjatë sekuestrimit u verifikuan numrat e kontenierëve të cilët ishin të njejtë me ato të deklaruar në momentin e nisjes nga Porti i Durrësit si dhe u eviudentuan edhe kontenierët, të cilët kishin edhe plumçet e vendosura nga autoritetet turke në portin Tekirdag, Turqi, nga ku rezultoi se ishin vendosur plumçe të tjera për 40 kontenierë.

Sekuestrimi u shoqërua me fotografimin kriminalistik dhe regjistrime video.

Sipas Urdhërit për lënien në ruajtje të provës materiale datë 07.11.2024, në mbështetje të nenit 214 të K.Pr. Penale dhe nenit Ligjit Nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar, administrimi dhe ruajtja e tyre ju ngarkua Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Agjenci e cila ka konfirmuar marrjen në dorëzim sipas procesverbalit datë 09.11.2024.

Me qëllim marrjen e mostrave për ekspertim dhe kryerjen e analizave laboratorike, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit Durrës, i është drejtuar të gjitha ministrive dhe institucioneve brenda territorit shqiptar. Nga përgjigjet e administruara nuk rezultoi asnjë institucion, laborator apo ent që të kishte infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e procesit të marrjes së mostrave dhe analizimit të tyre.

Në vijim, në bashkëpunim edhe me autoritetet italiane, u identifikuan tre shoqëri (një italiane dhe dy shqiptare dhe eksperti kimist), të cilat plotësonin kriteret e përgjithshme dhe specifike që duhet të plotësohen sipas protokolleve ndërkombëtare, për rastet kur duhet të testohen mostra potencialisht të rrezikshme.

Kryerja e këtij ekspertimi është bërë në koordinim të laboratorëve dhe ekspertëve, të cilët janë ngarkuar që nëpërmjet një bashkëpunimi të strukturuar midis tyre të plotësojnë detyrat si më poshtë:

- Shoqëritë Brema Ambiente sh.p.k. dhe AAS Advanced Analytical Solution sh.p.k. në prani dhe koordinim të ekspertit Arjan Korpa:

A. Marrjen e mostrave për 11 nga 102 kontenierët e sekuestruar sipas një përzgjedhje rastësore.

B. Ruajtjen dhe transportin e 11 mostrave të marra nga 11 kontenierët, mostrave të marra nga

shoqëritë Kurum, Sokolaj dhe Alliance.

Ruajtja dhe transportimi i tyre të kryhet duke:

- zbatuar protokolle rigoroze për ruajtjen e një zinxhiri të pandërprerë të mbrojtjes së mostrave;
- siguruar regjistrimin e detajuar të çdo faze, nga mbledhja e mostrës deri te analiza;

-Laboratori Advanced Analytical Services me asistencën dhe koordinimin e Advanced Analytical Solution sh.p.k.:

C. Kryerjen e testimeve kimiko-fizike të 15 mostrave duke:

- Siguruar një sistem testimi dhe analize të brendshme dhe të jashtme për validimin e procedurave dhe rezultateve;
- kryerjen e kalibrimeve të rregullta dhe të plota të instrumenteve në përputhje me kërkesat e akreditimit ISO 17025;

- Shoqëritë Brema Ambiente sh.p.k., Advanced Analytical Solution sh.p.k., Laboratori Advanced Analytical Services dhe eksperti Arjan Korpa:

D. Verifikimin dhe raportimin e rezultateve përfundimtare bazuar në legjislacionin dhe standartet shqiptare dhe europiane (ndërkombëtare), duke angazhuar një ekspert të certifikuar mjedisor me jo më pak se 5 vite përvojë.

Laboratori Advanced Analytical Solution sh.p.k., Brema Ambiente Sh.p.k. dhe Z.Arjan Korpa u caktuan si ekspertë që pas administrimit të analizave laboratorike ti përgjigjen pyetjeve si më poshtë:

1. Cila është përbërja kimike, karakteristikat fizike, çfarë përfaqëson materiali (si klasifikohet nga



pikëpmaja teknologjike) për:

- a. 11 mostra të marra nga 11 prej 102 kontenierët e sekuestruar.
 - b. një mostër e marrë nga shoqëria Kurum International në datë 28.08.2024.
 - c. një mostër e marrë nga shoqëria Sokolaj sh.p.k. në datë 28.08.2024.
 - d. një mostër e marrë nga shoqëria Alliance sh.p.k. në datë 30.10.2024
2. A ka në përbërjen e mostrave objekt ekspertimi (pika 1/a/b/c) substanca/elementë, të cilët përbëjnë rrezik për shëndetin dhe mjedisin? Nëse po, të specifikohen substanca/t/ element/ët, përmbajtja sasiore, format e ndikimit në shëndet dhe mjedis si dhe trajtimi i tyre.
3. Duke ju referuar përbërjes kimike të 11 mostrave të marra nga 11 prej 102 kontenierët e sekuestruar, a është i njejtë material?
4. A përputhen rezultatet e testimit (përbërja kimike) të 11 mostrave të materialit të marrë në 11 nga 102 kontenierët e sekuestruar, me ndonjë prej katër mostrave të marra nga subjektet Kurum International, Sokolaj sh.p.k. dhe Alliance sh.p.k., (mostra e mbyllur në qesen me nr.unik C3003222), objekt ekspertimi. Nëse po, me cilinë/at prej tyre?
5. A përputhen rezultatet e testimit të 11 mostrave të materialit të marrë në 11 nga 102 kontenierët e sekuestruar me rezultatet e testimit të dorëzuara nga Gjovana Sokolaj e konkretisht Fletë analize datë 11.10.2023 e Kurum International sh.a. (një fletë) dhe Fletë analize datë 07.04.2024 në emër të CEMTRA d.o.o. për llogari të GS MINERALS d.o.o. (dy fletë).

Procesi i marrjes së mostrave ka filluar në datë 09.10.2024 dhe në këtë proces kanë qenë të pranishëm në ditë të ndryshme: oficerët e policisë gjyqësore Elisa Xhetani, Besnik Tarja dhe Ardit Maksuti, specialisti i policisë shkencore në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës Franci Tase, doganieri i kontrollit fizik në Degën e Doganës Durrës, Saimir Çurumi, përfaqësuesi i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Gjergji Dudi dhe shoqëritë **Advanced Analytical Solution sh.p.k.**, **Brema Ambiente sh.p.k.** përfaqësuar nga Sokol Abazi, Selim Bregu dhe punonjësv etë këtyre shoqërive: Klajdi Mema, Altin Rrushi, Haki Reka dhe Ardjan Milaqi si dhe ekspertit **Z. Arjan Korpa**

Kontenierët nga të cilët u morën mostrat janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme e konkretisht:

1. Kontenieri me numër: **MEDU2957870**;
2. Kontenieri me numër: **FCIU2950907**;
3. Kontenieri me numër: **HPCU2538011**;
4. Kontenieri me numër: **MSDU2593815**;
5. Kontenieri me numër: **FSCU7784011**;
6. Kontenieri me numër: **SEGU2777771**;
7. Kontenieri me numër: **TRHU1554264**;
8. Kontenieri me numër: **MSMU3513451**;
9. Kontenieri me numër: **HPCU2541761**;
10. Kontenieri me numër: **GLDU9452240**;
11. Kontenieri me numër: **MEDU6450420**;

Në këtë përzgjedhje në raport me koeficientin e mostrimit (11 kontenierë nga 102) janë përfshirë edhe kontenierët të cilët janë hapur dhe mbyllur në portin Tekirdag Turqi e konkretisht:

MEDU2957870; FCIU2950907; TRHU1554264 dhe GLDU9452240. Të 11 mostrat e marra nga kontenierët e sipërcituar, janë tharë, bluar dhe ndarë dhe janë vendosur në qese me numra unikë, si më poshtë:

- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **MEDU2957870** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **X6006698, X6006697, X6006696 dhe X6006699.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **FCIU2950907** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **X6006710, X6006711, X6006712 dhe X6006709.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **HPCU2538011** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **C6005177, C6005171, C6005170 dhe C6005172.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **MSDU2593815** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **C6005174, C6005176, C6005173 dhe C6005175.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **FSCU7784011** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **C6005185, C6005183, C6005182 dhe C6005184.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **SEGU2777771** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **X6006702, X6006701, X6006700 dhe X6006703.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **TRHU1554264** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **C6005189, C6005188, C6005186 dhe C6005187.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **MSMU3513451** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **C6005192, C6005193, C6005190 dhe C6005191.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **HPCU2541761** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **X6006708, X6006707, X6006705 dhe X6006706.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **GLDU9452240** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **C6005179, C6005178, C6005180 dhe C6005181.**
- Mostra e marrë nga kontenieri me numër: **MEDU6450420** është vendosur në qeset e provave me numra unikë: **C6005141, C6005140, C6005139 dhe C6005138.**

Gjithashtu mostra u morën edhe nga materiali i sekuestruar në ambientete e shoqërisë Kurum, Sokolaj dhe Alliance (gjithsej kater të tilla).

I gjithë procesi i marrjes së mostrave iu cili ka vijuar për disa ditë është shoqëruar me procesverbalet përkatëse ku janë pasqyruar të gjitha veprimet e kryera dhe personat e pranishëm. Ky proces është shoqëruar me fotografi dhe filmime.

Dërgimi në laboratorin **Advanced Analytical Services** në Itali i mostrave të marra për ekspertim është shoqëruar nga oficerë të policisë gjyqësore të Prokurorisë Durrës dhe ekspertët Sokol Abazi dhe Selim Bregu. Mostrat u në dorëzim nga laborator **Advanced Analytical Services**, sipas procesverbalit datë 31.10.2025.

Më datë 24.12.2025, është administruar akti i ekspertimit të ekspertëve Selim Bregu, Sokol Abazi dhe Arjan Korpa, nga i cili rezulton në mënyrë të përmbledhur si konkluzion si më poshtë:

11 mostra të marra nga 11 prej 102 kontenierëve të sekuestruar

- Bazuar në analizat e përmbajtjes totale të elementeve (dhe përbërjeve të tyre) të kryera me ICP-OES/ICP-MS, në rezultatet e analizës së liqivimit, si dhe në analizën oksidike XRF të mostrës kompozite të përbërë nga 11 nën-mostrat (1A–11A), konstatohet se **materiali karakterizohet nga përmbajtje shumë e lartë e zinkut (Zn) dhe hekurit (Fe), të shoqëruara me plumb (Pb), bakër**

(Cu), mangan (Mn), kalcium (Ca), kalium (K), klor (Cl) dhe sqfur (S). Përbërja oksidike rezulton e dominuar nga oksidi i zinkut (ZnO, rreth 43 %) dhe oksidi i hekurit (Fe_2O_3 , rreth 34 %), me prani të oksideve shoqëruese tipike për proceset metalurgjike të prodhimit të çelikut.

- Nga pikëpamja fizike, materiali paraqitet si pluhur shumë i imët, me ngjyrë gri të errët deri në të zezë, me shkëlqim metalik lokal. Në aspektin teknologjik, profili kimik dhe karakteristikat fizike të konstatuara janë në përputhje me ato të pluhurit të furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace dust – EAF dust), të tipit të pasur me zink (Zn-rich).

- **Kodimi i materialit (Mbetjes) sipas Loë/EWC (fq.60 e katit të ekspertimit)**
Nënkaptulli 10 02 i Listës Evropiane të Mbetjeve (European Waste Catalogue - EWC), i përcaktuar në Decision 2000/532/EC dhe aktet e tij pasuese amenduese, përfshin mbetjet që gjenerohen nga prodhimi i hekurit dhe çelikut në procese termike, përfshirë mbetjet nga trajtimi i gazrave, pluhurat, slaget dhe materiale të tjera të lidhura drejtpërdrejt me proceset metalurgjike. Kjo strukturë klasifikimi bazohet parimisht në origjinën teknologjike të mbetjes, përpara se të merren në konsideratë vetitë e saj të rrezikut.

Në rastin e materialit të analizuar, bëhet fjalë për pluhur të grumbulluar nga sistemet e filtrimit të gazrave të furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace - EAF), proces i cili përfshihet qartësisht në fushëveprimin e nënkaptullit 10 02 të EWC. Bazuar në përbërjen kimike të materialit dhe në aktivizimin e vetive të rrezikut HP10 dhe HP14, në përputhje me Annex III të Direktives 2008/98/EC (Waste Framework Directive) dhe rregulloret përkatëse zbatuese, kodi përkatës brenda këtij nënkaptulli duhet të jetë ai i shënuar si mbetje e rrezikshme. Brenda nënkaptullit 10 02, kategoria që përshkruan në mënyrë specifike mbetjet nga trajtimi i gazrave dhe njëkohësisht parashikon praninë e substancave të rrezikshme është 10 02 07*. Për rrjedhojë, mbi bazën e origjinës teknologjike të mbetjes dhe identifikimit të vetive të rrezikut sipas Annex III të Direktivës 2008/98/EC, me shumë gjasa kodi 10 02 07* përfaqëson klasifikimin e saktë teknikisht dhe ligjrisht të materialit të analizuar.

Një mostër e marrë nga shoqëria Kurum International në datë 28.08.2024 (PROK-3)

- **Mostra PROK-3, e sekuestruar në ambientet e shoqërisë Kurum International, sipas rezultateve të analizave të përmbajtjes totale të elementeve të kryera me ICP në kuadër të këtij ekspertimi, paraqet përqendrimet shumë të larta të zinkut (Zn, rreth 262 000 mg/kg) dhe hekurit (Fe, rreth 140 000 mg/kg), të shoqëruara me prani të plumbit (Pb), bakrit (Cu) dhe elementëve të tjerë shoqërues karakteristikë për pluhurat e furrës elektrike të çelikut.**
- Bazuar në profilin kimik të konstatuar dhe në karakteristikat fizike të materialit, mostra PROK-3 identifikohet si pjesë e së njëjtës rrjedhë metalurgjike industriale të pluhurit të furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace dust – EAF dust) të tipit të pasur me zink (Zn-rich), dhe rezulton e krahasueshme me materialin e përfaqësuar nga 11 mostrat e marra nga kontejnerët e sekuestruar.

Një mostër e marrë nga shoqëria Sokolaj sh.p.k. në datë 28.08.2024 (PROK-1 dhe PROK-2)

- **Mostrat PROK-1 dhe PROK-2, të sekuestruara në ambientet e shoqërisë Sokolaj sh.p.k.**

paraqesin një përbërje kimike thelbësisht të ndryshme nga ajo e pluhurit të furrës elektrike të çelikut (EAF dust). Rezultatet e analizave të përmbytjes totale të elementeve të kryera me ICP tregojnë përqendrime shumë të larta të bakrit (Cu, rreth 12–14 %), përmbytje të ulëta të zinkut (Zn) dhe plumbit (Pb), si dhe prani të rritur të selenit (Se) dhe taliumit (Tl).

- Sjellja e materialit në analizën e liçivimit karakterizohet nga çlirim shumë i lartë i bakrit (Cu) dhe hekurit (Fe), një tipar i papajtueshëm me matricën Zn-rich EAF dust dhe tregues i një matrice metalurgjike jo-EAF.
- Në aspektin teknologjik dhe material, mostrat PROK-1 dhe PROK-2 nuk përputhen me pluhurin e furrës elektrike të çelikut (EAF dust), por paraqesin një profil kimik dhe sjellje në liçivim të përputhshme me pluhura metalurgjikë jo-ferrozë të pasur me bakër (Cu-rich non-ferrous smelter dust), të lidhura me procese industriale shkrijeje dhe/ose rafinimi të bakrit, bazuar në raportet Cu/Se/Tl dhe në çlirimin e lartë të Cu dhe Fe gjatë liçivimit.

Një mostër e marrë nga shoqëria Alliance sh.p.k. në datë 30.10.2024 (PROK-5)

- **Mostra PROK-5, e sekuestruar në ambientet e shoqërisë Alliance sh.p.k., paraqet një përbërje kimike të karakterizuar nga përmbytje të larta të zinkut (Zn) dhe hekurit (Fe), me prani të plumbit (Pb) dhe bakrit (Cu) në nivele tipike për pluhurin e furrës elektrike të çelikut (EAF dust).** Gjithashtu, është konstatuar prani e përbërjeve organike të tipit PAH dhe PCB, në intervale të pritshme për pluhurat e filtrimit të gazeve të furrave elektrike.
- Në aspektin teknologjik dhe material, bazuar në profilin kimik dhe karakteristikat e konstatuara, **mostra PROK-5 identifikohet si i njëjti material industrial, përkatësisht pluhur i furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace dust – EAF dust) i tipit të pasur me zink (Zn-rich), i krahasueshëm me materialin e përfaqësuar nga 11 mostrat e marra nga kontejnerët e sekuestruar dhe me mostrën PROK-3.**

A ka në përbërjen e mostrave objekt ekspertimi (pika 1/a/b/c) substanca/elementë që përbëjnë rrezik për shëndetin dhe mjedisin?

- **Po. Në mostrat 1A–11A, PROK-3, PROK-1/PROK-2 dhe PROK-5 konstatohet prania e elementëve (dhe përbërjeve të tyre) që përbëjnë Rrezik për Shëndetin e njeriut dhe Mjedisin,** kryesisht zinku (Zn), plumbi (Pb), kadmiumi (Cd) dhe arseniku (As). Këta elementë (dhe përbërjet e tyre), sipas klasifikimit përkatës të substancave përbërëse në kuadër të rregullores CLP, lidhen me rrezikun e toksicitetit për riprodhimin dhe ekotoksicitet, veçanërisht ndaj ekosistemeve ujore. Për rrjedhojë, materialet kërkojnë menaxhim të kontrolluar dhe trajtim si mbetje të rrezikshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke iu referuar përbërjes kimike të 11 mostrave të marra nga 11 prej 102 kontenierëve të sekuestruar, a është i njëjti material?

- **Po. Nga krahasimi i përbërjes kimike të 11 mostrave, i bazuar në rezultatet analitike të përmbytjes totale dhe në vlerësimin e shpërndarjes sasiore të elementeve kryesore dhe shoqëruese, konstatohet se mostrat i përkasin të njëjtit material industrial.** Variacionet e vërejtura ndërmjet mostrave janë brenda kufijve normalë të heterogjenitetit të pritshëm për një material industrial. Në

aspektin teknologjik dhe material, ky material identifikohet si pluhur i furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace dust – EAF dust) i tipit Zn-rich.

A përputhen rezultatet e testimit të 11 mostrave me ndonjë prej mostrave PROK-3, PROK-1, PROK-2 dhe PROK-5?

- Nga krahasimi i rezultateve analitike të 11 mostrave të marra nga kontejnerët me rezultatet përkatëse të mostrave PROK-3, PROK-1, PROK-2 dhe PROK-5, konstatohet se 11 mostrat përputhen me mostrat PROK-3 (Kurum International) dhe PROK-5 (Alliance sh.p.k.). Këto materiale i përkasin të njëjtit material industrial, përkatësisht pluhurit të furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace dust – EAF dust) të tipit të pasur me zink (Zn-rich).
- Në të kundërt, mostrat PROK-1 dhe PROK-2 (Sokolaj sh.p.k.) nuk përputhen me 11 mostrat e kontejnerëve, pasi përfaqësojnë një material metalurgjik të ndryshëm, jo-ferroz, të karakterizuar nga përmbajtje e lartë e bakrit (Cu).

A përputhen rezultatet e testimit të 11 mostrave me fletët e analizës të vëna në dispozicion nga Gjovana Sokolaj (Kurum International 11.10.2023 dhe CEMTRA 07.04.2024)?

- Jo, nuk përputhen. Nga krahasimi i rezultateve analitike të 11 mostrave të marra nga 11 kontejnerët e sekuestruar (1A–11A) me të dhënat e paraqitura në fletët e analizës të datave 11.10.2023 (Kurum International) dhe 07.04.2024 (CEMTRA d.o.o. / GS MINERALS), konstatohet mungesë përputhshmërie materiale.
- Rezultatet e 11 mostrave (mostër kompozite, analizë XRF) tregojnë një profil kimik karakteristik për pluhurin e furrës elektrike të çelikut të tipit të pasur me zink (EAF dust Zn-rich), i dominuar nga oksidi i zinkut ($\text{ZnO} \approx 42.92\%$) dhe oksidi i hekurit ($\text{Fe}_2\text{O}_3 \approx 34.46\%$), si dhe nga prania e përbërësve shoqërues tipikë për këtë material, përfshirë klorin ($\text{Cl} \approx 4.03\%$), squfurin ($\text{S} \approx 3.28\%$), oksidin e kaliumit ($\text{K}_2\text{O} \approx 1.54\%$) dhe arsenikun ($\text{As} \approx 1.35\%$).
- Në të kundërt, fleta e analizës së Kurum International (11.10.2023) përshkruan një material të dominuar nga okside hekuri, me përmbajtje të lartë të $\text{FeO} (\approx 72.08\%)$ dhe hekurit total ($\approx 77.84\%$), ndërsa përmbajtja e zinkut ($\text{Zn} \approx 0.0274\%$) është shumë e ulët dhe jo e krahasueshme me atë të mostrave 1A–11A; plumbi (Pb) në këtë fletë nuk paraqitet me vlerë numerike.
- Po ashtu, fleta e analizës së CEMTRA d.o.o. / GS MINERALS (07.04.2024) raporton një material të dominuar nga $\text{Fe}_2\text{O}_3 (\approx 84.78\%)$, pas trajtimit termik (“roasting”) në $600\text{ }^\circ\text{C}$, me përbërës shoqërues si SiO_2 , Al_2O_3 dhe CaO , si dhe fraksion “të tjera” prej 0.32% , pa prani të profilin Zn-rich dhe pa përbërësit karakteristikë Cl/S të vërejtur në mostrat e kontejnerëve.
- Bazuar në këto diferenca themelore në përbërjen kimike, veçanërisht në përmbajtjen shumë të lartë të ZnO dhe në profilin karakteristik Cl/S të mostrave 1A–11A, kundrejt përmbajtjeve gjurmë të zinkut dhe mungesës së këtij profili në fletët e analizës së dorëzuara, konstatohet se rezultatet e 11 mostrave nga kontejnerët nuk përputhen me asnjërën nga fletët e analizës të paraqitura, as me Kurum International (11.10.2023), as me CEMTRA d.o.o. / GS MINERALS (07.04.2024).

Duke ju referuar konkluzioneve të aktit të ekspertimit kimik-mjedisor, në fakt materiali që Kurum ka shitur tek shoqëria Sokolaj nuk rezulton as oksid hekuri dhe as oksid zinku, ashtu sikurse subjektete janë përpjekur nëpërmjet fletëve të analizave që kanë paraqitur, por një përbërje kimike të

karakterizuar nga përmbajtje të larta të zinkut (Zn) dhe hekurit (Fe), me prani të plumbit (Pb) dhe bakrit (Cu) në nivele tipike për pluhurin e furrës elektrike të çelikut (EAF dust), e cila mbi bazën e origjinës teknologjike të mbetjes dhe identifikimit të vetive të rrezikut sipas Annex III të Direktivës 2008/98/EC, me shumë gjasa kodi 10 02 07* përfaqëson klasifikimin e saktë teknikisht dhe ligjërisht të materialit të analizuar.

Nga analizimi i akteve të administruara në funksion të këtij procedimi penal dhe rezultateve të ekspertimit, rezulton se subjektet Sokolaj sh.p.k. dhe Kurum International sh.a., në dijeni të plotë të rrezikshmërisë së mbetjeve të rrezikshme, të cilat kualifikohen sipas kodit 10 02 07*, kanë kryer një sërë veprimesh për fshehjen e llojit të vërtetë të mbetjes, me qëllim eksportimin jashtë Shqipërisë, duke ju shmangur të gjitha detyrimeve ligjore të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Shoqëria Kurum dhe Sokolaj kanë fshehur në mënyrë të vazhdueshme natyrën e vërtetë të llojit të mbetjes së rrezikshme, duke e përpjekur ta paraqesin herë si oksid hekuri dhe herë si oksid zinku.

Nga aktet e administruara në funksion të këtij procedimi penal rezulton se:

I. Midis shoqërisë Kurum International dhe Sokolaj sh.p.k. është lidhur kontrata e shitjeblerjes, datë 01.08.2023, ku objekti i kësaj kontrate është blerja nga ana e kompanisë Sokolaj, e mallit **Oksid Hekuri**, me një çmim të ndryshueshëm sipas bursës, pa përcaktuar sasi. Sipas parashikimit në këtë kontratë, malli shoqërohet me fatura dhe certifikatë analize. Kontrata është nënshkruar nga administratorët përkatësisht: Erdal Demir dhe Gjovana Sokolaj. Sipas kësaj kontrate, shitësi merr përsipër dorëzimin e sasisë së mallit në Portin e Durrësit, për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga data 01.08.2023.

Kontrata është dorëzuar nga Kurum pranë Agjensisë Kombëtare të Mjedisit (në vijim AKM) dhe në organin procedues me shkresën Nr.548 prot. datë 27.08.2024. Lidhja e kësaj kontratë është konfirmuar nga shoqëritë Sokolaj dhe Kurum sipas deklarimeve të administratorëve të saj dhe Gjoni Sokolaj, administrator i shoqërisë GS Minerals d.o.o. (njëkohësisht bashkëshorti i Gjovana Sokolaj oratake e vetme e shoqërive Sokolaj dhe GS Minerals d.o.o.)

Në bazë të kontratës datë 01.08.2023 të sipërcituar, Kurum ka lëshuar për Sokolaj faturat tatimore:

- Nr.19107/2023 datë 16.11.2023, me përshkrim artikulli "**Oksid Hekuri**", në sasinë 852.740 kg;
- Nr.88/2023 datë 03.10.2023, me përshkrim artikulli "**Oksid zinku (në thasë) 2000t**", me blerës "Sokolaj" sh.p.k.;
- Nr.88/2023 Korrigjuese me përshkrim artikulli "**Oksid Hekuri**".

Sic vihet re, pavarësisht se kontrata është lidhur për llojin e artikullit Oksid Hekuri, Kurum ka lëshuar për Sokolaj faturën tatimore Nr.88/2023 datë 03.10.2023, për artikullin "**Oksid zinku (në thasë) 2000t**".

Shoqëritë Kurum dhe Sokolaj, janë përpjekur të fshehin ekzistencën e faturës Nr.88/2023 datë 03.10.2023, me artikullin "**Oksid zinku (në thasë) 2000t**", jo vetëm me deklarime, por edhe me veprime konkrete, duke paraqitur në vend të saj faturën nr.88/2023 KORIGJUESE, në të cilën artikulli është "**Oksid Hekuri**".

Fatura nr.88/2023 KORIGJUESE është dorëzuar nga:



1. Subjekti Sokolaj dhe GS Minerals d.o.o:

- në agjensinë doganore Joti Sopedition, për eksportet sipas deklaratave doganore: R 11842 datë 27.03.2024; R 15663 datë 22.04.2024 dhe R 27224 datë 04.07.2024, për eksportin e Oksid hekuri (zn);
- në policinë gjyqësore nëpërmjet procesverbalit të këqyrjes dhe marrjes së provave materiale datë 14.08.2024 si pjesë e dokumentacionin në lidhje me eksportin e datës 04.07.2024;
- para autoriteteve doganore të Kroacisë nga Gjoni Sokolaj në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë GS Minerals d.o.o.

Duke ju referuar edhe deklarimeve të shtetasve Gjovana dhe Gjoni Sokal ata mohojnë të kenë blerë dhe eksportuar oksid zinku nga Kurum, por oksid hekuri.

2. Kurum International sh.a.

- me shkresën Nr.548 datë 27.08.2024 drejtuar Prokurorisë Durrës në të cilën shprehet se: *"I ka shitur për vitin 2023 subjektit Sokolaj Oksid Hekuri sasinë 2.852.74 ton. Për këtë sasi janë lëshuar faturat tatimore Nr.88/2023 datë 03.10.2023 për sasinë 2000 ton dhe fatura tatimore e shitjes nr.19107/2023 datë 16.11.2023 për sasinë 852,74 ton."*

Bashkëlidhur kësaj shkrese rezulton dhe një tabelë (kartela e artikullit 01.01.2023-31.12.2023 e nënshkruar nga punonjësja Mirjeta Zoto, (kontabiliste e shoqërisë e cila ka nënshkruar edhe pasqyrat financiare të Kurum për vitin 2023), ku pasqyrohen të dhëna në lidhje me shitjet e shoqërisë Kurum, ku specifikisht në të dhënat e vitit 2023, përshkrimi i produktit lidhur me shitjet shoqërisë Sokolaj sh.p.k. është Oksid Hekuri. E njëjta tabelë është dorëzuar edhe në AKM si detyrim i shoqërisë Kurum për raportimin e shitjes së mbetjeve teknologjike nga procesi i saj i prodhimit.

I pyetur në lidhje me faktin se përse ekzistojnë dy fatura të lëshuara nga Kurum, ku njëra për artikullin Oksid Zinku dhe tjetra për oksid hekuri, administratori i shoqërisë Kurum, **Erdal Demir**, është përgjigjur se duhet të jetë një lapsus për të cilin do ngarkojë financën që të japi shpjegime.

I pyetur nga organi procedues në lidhje me këtë fakt, shtetasi **Shaban Hyseni**, (me detyrë drejtor i departamentit të shitjeve në Kurum), i cili rezulton të jetë përdoruesi i userit nga i cili është gjeneruar fatura Nr.88/2023, ka deklaruar se, për faturën Nr.88/2023 është telefonuar në telefonin e zyrës nga administrator Erdal Demir, i cili i ka kërkuar prerjen e faturës së shitjes për subjektin Sokolaj duke i përcaktuar sasinë, çmimin dhe produktin. I pyetur në lidhje me mospërputhjen midis llojit të artikullit, shtetasi Shaban Hyseni ka deklaruar se ndoshta është një gabim pasi Sokolaj ka blerë më parë oksid zinku, por mesa kujton në këtë rast ka qenë oksid hekuri. Në lidhje me faturën korigjuese Nr.88/2023 ka deklaruar se është e lidhur me faturën 88/2023 të fiskalizuar dhe bërë në datë 03.10.2023 ora 10.18., e cila është e deklaruar në tatime nga agjenti doganor Mikail Hila, i cili me procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale datë 13.08.2024, duke fshehur ekzistencën e faturës **Nr.88/2023 datë 03.10.2023**, për artikullin **"Oksid zinku (në thasë) 2000f"**. Ai kishte dijeni për këtë faturë pasi ka regjistruar në sistemin ASYCUDA deklaratën doganore **R 41205 datë 14.11.2023, me eksportues Sokolaj sh.p.k., marrës GS Minerals Doo.**

Me shkresën Nr.52 prot datë 16.09.2024 të Kurum International sh.a. rezulton se nga verifikimi i faturave që korespondojnë me kontratën e lidhur me subjektin Sokolaj sh.p.k. e

konkretisht faturat datë 03.10.2023 dhe 16.11.2023, operatori i cili ka prerë faturën, si pjesë e departamentit të shitjes është Z.Shaban Hyseni me nr.identifikimi personal I70907071T.

Kopja e faturës tatimore Nr.88/2023 datë 03.10.2023, me kod operatori cc924cg033, me anë të së cilës Kurum i ka shitur Sokolaj artikullin **“Oksid zinku (në thasë) 2000t”**, është identifikuar nga sistemi ASYCUDA, i këqyrur nga oficeri i policisë gjyqësore të hetimit doganor, e përcjellë me informacionin e datës 23.09.2024, bashkëlidhur praktikës doganore për eksportin e datës 14.11.2023 sipas Deklaratës doganore R41205 dhe nga kopje e dokumentacionit të dorëzuar nga agjencia doganore Joti Spedition sipas procesverbaleve të sekuestrimit datë 29.08.2024 dhe 19.01.2026.

Me procesverbalin “Për këqyrjen dhe marrjen e provave materiale” datë 19.01.2026, është skanuar në kodin e saj Fatura Tatimore 88/2023 e datë 03.10.2023, me shitës “Kurum International” sh.a me NIPT K02727230T dhe blerës “Sokolaj” sh.p.k me NIPT K64312403D. Nga skanimi me telefon i “Kodi Qr Fiskalizimi” të faturës së sipërcituar, pasi është hapur fatura në “tatime.gov.al”, ka rezultuar se fatura Nr.88/2023 datë 03.10.2023 të “Kurum International” sh.a, me kod operatori cc924cg033, artikulli është **“Oksid zinku (në thasë) 2000t”** me blerës Sokolaj sh.p.k. NUK KA ASNJE KORIGJIM të artikullit, i cili vazhdon të jetë **Oksid Zinku në thasë**. Në fakt kjo faturë ka korrigjuar faturën 12098/2023 datë 04.08.2023 të “Kurum International” sh.a., me kod operatori cc924cg033, ku artikulli është **“Pagesë në avancë Ix”** me blerës “Sokolaj” sh.p.k.

Me shkresën Nr.7697/1prot datë 11.11.2024 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës është dërguar kopje e faturës Nr.88/2023 datë 03.10.2023 e deklaruar nga Sokolaj, në të cilën përshkrimi i mallit rezulton **“Oksid Zinku (në thasë) 2000 t**. Nga të dhënat e administruara nga ky institucion nuk rezulton që të jetë kryer ndonjë korigjim i kësaj fature.

Përsa më sipër rezulton se, fatura Nr.88/2023 KORIGJUESE, e cila mban të njëjtën orë dhe datë me atë Nr.88/2023, është tërësisht e riprodhuar jashtë sistemit të fiskalizimit duke përdorur të njëjtat të dhëna të faturës Nr.88/2023 (si përsa i përket Kodit të Qr të Fiskalizimit, numrit, datës dhe orës së lëshimit, operatorit, sasisë së artikullit), por duke ndryshuar llojin e artikullit në OKSID HEKURI.


Kjo provohet edhe nga procesverbali datë 12.01.2026 ku është skanuar kodi i faturës dhe nga skanimi dalin të njëjtat të dhëna me atë të faturës 88/2023 datë 03.10.2023 të “Kurum International” sh.a., me kod operatori cc924cg033, artikulli është **“Oksid zinku (në thasë) 2000t”** me blerës Sokolaj sh.p.k.

Ashtu siurse u citua edhe më lart, në sistemin e tatimeve nuk ekziston asnjë Fature Tatimore me Nr.88/2023 korigjuese datë 03.10.2023 që të ketë korrigjuar artikullin nga Oksid Zinku në Oksid Hekuri.

I. Shoqëria Sokolaj të njëjtin produkt të blerë nga Kurum ia ka shitur shoqërisë GS Minerals Doo (në pronësi të Gjovana Sokolaj), me përshkrimin Oksid Hekuri (Zn) me faturat si më poshtë:

- Nr.58 datë 11.11.2023 për 588.75 ton Oksid Hekuri (Zn), me vlerë 29.437.50 USD;
- Nr.13/2024 datë 27.03.2024, për 637.74 ton Oksid Hekuri (Zn), me vlerë 31.887.00 USD;
- Nr.28/2024 datë 22 prill 2024 për 81.36 ton oksid Hekuri (Zn) me vlere USD 4,068.00;
- Nr.58/2024 datë 03/07/2024 për 2,816.30 ton Oksid Hekuri (Zn) në shumën USD 40,815.00;

Faturat janë regjistruar ne librat e shoqërisë GS Minerals d.o.o. fakt që është konfirmuar nga autoritetet doganore kroate.



Gjithshtu kopje të këtyre faturave janë dorëzuar në organin procedues edhe nga Gjovana Sokolaj sipas procesverbalit të sekuestrimit datë 27.08.2024 si dhe janë administruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

Shtetasja Gjovana Sokolaj ka qenë në dijeni të faktit se fatura Nr.88/2023 korigjuese ishte e faslifikuar pasi edhe për llogari të subjektit Sokolaj në sistemin tatimeve dhe e deklaruar prej saj në librat e blerjes, është deklaruar fatura Nr.88/2023 datë 03.10.2023 të "Kurum International" sh.a, me kod operatori cc924cg033, artikulli është "Oksid zinku (në thasë) 2000f" me blerës Sokolaj sh.p.k. dhe asnjë faturë korigjuese.

Siç rezulton nga sa më sipër, në faturat e sipërcituara subjekti Sokolaj i jep artikullit të blerë nga Kurum si "oksid zinku", një përshkrim të ri "Oksid Hekuri (Zn)".

II. Shoqëria GS Minerals d.o.o. (në pronësi të Gjovana Sokolaj) ia shet mallrat shoqërive Terry Thriving Trade Limited nga Hong Kongu dhe North Creek Resource PTE. Limited Singapor sipas faturave të sipërcituara me përshkrimin "**HQ IRON OXIDE**". (HQ-High Quality).

Nga këto transaksione të GS Minerals d.o.o. rezulton se:

- Artikulli Oksid Hekuri (Zn) ndryshon sërish përshkrim duke u paraqitur si "**HQ IRON OXIDE**";
- Sasia prej 2.816.300 kg bruto shitet në vlerën prej 140.815.00 USD, me të njëjtën vlerë që Sokolaj ja ka shitur Gs Minerals,**

III. Transportimi dhe depozitimi i materialit që Sokolaj ka eksportuar, i blerë nga Kurum sipas kontratës datë 01.08.2023, është kryer nga Kurum, ashtu sikurse është rënë dakort në kontratë dhe sikurse konfirmohet nga vetë Kurum me shkresën Nr.651 prot datë 16.10.2024 ku kanë depozituar edhe dokumentacionin e mjeteve që kanë kryer transportin.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga kompania Kurum dhe ashtu sikurse është parashikuar në kontratën e lidhur mes palëve, deklarimeve të dhëna nga punonjësit e kësaj shoqërie, konfirmimit zyrtar me shkresën Nr.651 prot datë 16.10.2024 depozituar në prokurori bashkëlidhur së cilës edhe dokumentacioni mjeteve që kanë kryer transportin dhe procesverbalit datë 30.09.2024 për dokumentacioni e paraqitur nga Mujo Ilazaj, drejtor transporti pranë Kurum, sasia prej rreth 2.852,740 kg sipas tyre "Oksid Hekuri", është transportuar me kamionët e shoqërisë **Kurum**.

Sipas procesverbalit datë 16.10.2024, punonjësi i Kurum, Rami Bunga ka dorëzuar listën e të dhënave në lidhje me peshën, datën, automjetin, nisjen dhe destinacionin në lidhje me transportin e oksidit të hekurit (okalin) nga kompania Kurum drejt kalatës lindore të portit të Durrësit për llogari të shoqërisë Sokolaj sh.p.k. me pesëh totale 2.852,740 kg. Sipas kësaj liste lloji i artikullit që është transportuar nga data 26.09.2023 deri në datë 09.11.2023 është "**OKALIN**".

Siç vihet re materiali I transportuar tashmë ka një përshkrim tjetër duke u paraqitur si **OKALIN**.

IV. Materiali është depozituar në sheshet e shoqërisë "**EMS Albanian Port Operator**" (në vijim **EMS APO**) sh.p.k. me NIPT L318045506A, me vendodhje në Portin Durrës, sipas kontratave që ka lidhur me GS Minerals d.o.o.

Në funksion të verifikimit të kontratave të lidhura midis G.S. Minerals d.o.o. dhe Sokolaj me EMS APO nga ku rezultuan se, ndërmjet qiradhënësit: shoqërisë EMS Albanian Port Operator sh.p.k. (në

vijim EMS APO), me NIPT L318045506A, me përfaqësues Florian Cimo dhe qiramarrësit: shoqërisë kroate GS Minerals d.o.o, me NIPT OBI61130788157, me administratore Gjovana Sokolaj, janë lidhur këto kontratatë dhënat si më poshtë:

1. Kontratë qiraje, nr.61 datë 26.09.2022, me objekt dhënien në shfrytëzim me qëllim depozitim e mallit oksid zinku në Big Bags, me kushtin që ky mall është me destinacion exp-import me/nga transporti detar, në sheshin e stokimit në Terminalin Lindor të Portit Durrës, një sipërfaqe prej 400 m2. Kohëzgjatja e kontratës është 6 muaj, nga data e nënshkrimit të saj.
2. Kontratë qiraje, nr.14 datë 27.03.2023, me objekt dhënien në shfrytëzim me qëllim depozitim e mallit oksid zinku, me kushtin që ky mall është me destinacion exp-import me/nga transporti detar, në sheshin e stokimit në Terminalin Lindor të Portit Durrës, një sipërfaqe prej 400 m2. Kohëzgjatja e kontratës është 6 muaj, nga data e nënshkrimit të saj.
3. Kontratë qiraje, nr.54 datë 25.09.2023, me objekt dhënien në shfrytëzim me qëllim depozitim e mallit oksid zinku, me kushtin që ky mall është me destinacion exp-import me/nga transporti detar, në sheshin e stokimit në Terminalin Lindor të Portit Durrës, një sipërfaqe prej 1400 m2. Kohëzgjatja e kontratës është 6 muaj, nga data e nënshkrimit të saj.
4. Kontratë qiraje, nr.8 datë 25.03.2024, me objekt dhënien në shfrytëzim me qëllim depozitim e mallit oksid zinku, me kushtin që ky mall është me destinacion exp-import me/nga transporti detar, në sheshin e stokimit në Terminalin Lindor të Portit Durrës, një sipërfaqe prej 1400 m2. Kohëzgjatja e kontratës është 6 muaj, nga data e nënshkrimit të saj.

Me kërkesën e datës 24.06.2024, shoqëria qiramarrëse GS Minerals d.o.o, ka bërë kërkesë për zgjidhjen e kësaj kontrate qiraje, me datë 05.07.2024, pasi nga ana e tyre do të merren të gjitha masat mbi evadimin e plotë të sendeve të depozituara dhe lirimit të ambienteve të marra me qira.

Nga EMS APO për llogari të kontratave të mësipërme (edhe pse kontratat kanë qenë me qiramarrës GS Minerals d.o.o.), faturat e shërbimeve janë lëshuar për Sokolaj sh.p.k. për shërbimet për qeranë, peshimin dhe ngarkimin e materialit në anije.

Faturat e lëshuara për mbushje kontenierësh për periudhën Nëntor 2023-Korrik 2024 janë si vijon:

- Nr.1460/2023 datë 15.11.2023, sasia 588.75 ton (588.750 KG), për mbushje kontenieri që dalin në export deklarata doganore R 41205 (datë 14.11.2024).
- Nr.366/2024 datë 29.03.2024, sasia 637.74 ton (637.740 KG), për mbushje kontenieri që dalin në export deklarata doganore R 11842 (datë 27.03.2024).
- Nr.455/2024 datë 23.04.2024, sasia 81.36 ton (81.360 KG), për mbushje kontenieri që dalin në export deklarata doganore R 15663 datë 22.04.2024.
- Nr.825/2024 datë 08.07.2024, sasia 2,816.30 ton (2.816.300 KG), për mbushje kontenieri që dalin në export deklarata doganore R 27224 datë 04.07.2024.

Nga analizimi i këtyre faturave dhe deklarateve doganore të eksportit, por edhe faturave të lëshuara për pagesën e qirasë sipas kontratave të sipërcituara rezulton se, për periudhën Nëntor 2023-Korrik 2024, Sokolaj ka eksportuar një sasi prej 4124.15 ton i deklaruar si oksid hekuri (zn) si vijon:

- Nga data 25.09.2023 deri në datë 02.10.2023, është depozituar Oksid Zinku në total prej 2077.400 ton

- Nga data 26.10.2023 deri në datë 09.11.2023, është depozituar Bik Baks, sasia në total prej 668.820 ton;

Sasia e depozituar nga data 25.09.2023 deri në datë 09.11.2023 ka qendruar në territorin e EMS deri në eksportin e datës 04.07.2024, rifuxho në pjesën më të madhe dhe në një sasi më të vogël në thesë.

Sasitë e tjera të materialit të eksportuar në datat 14.11.2023, 27.03.2024 dhe 22.04.2024 kanë qenë të depozituara më parë sipas kontratës nr.14 datë 27.03.2023, fakt që konfirmohet nga faturat tatimore për pagesën e qirasë për muajt mars-shtator 2023 deri në lidhjen e kontratës nr.54 datë 25.09.2023.

V. Nga dokumentacioni i sekuestruar nga agjencia doganore Joti Spedition dhe Dega e Doganës Durrës rezulton se, shoqëria Sokolaj sh.p.k. ka kryer 4 (katër) eksporte me përshkrimin e artikullit "*Okside dhe hidrokside hekuri Jo Dual Use OKSID HEKURI (ZN)*" si vijon:

1. Deklarata doganore R 41205 datë 14.11.2023, me eksportues Sokolaj sh.p.k., marrës GS Minerals Doo, vend origjine Albania, vendi i destinacionit Tailanda, shuma totale në faturë 29,437.50 USD, 23 kontenierë, përshkrimi i mallit është: Okside dhe hidrokside hekuri Jo Dual Use OKSID HEKURI (ZN) = 588.750 KG.

Bashkëlidhur kësaj deklarata ndodhet dokumentacioni si vijon:

- Listë e kontenierëve me të dhënat për numrat e tyre dhe peshën për 23 kontenierë në total 588.750 kg;
- Fatura numër Nr.58 datë 11.11.2023 për 588.75 ton Oksid Hekuri (Zn) me vlerë 29.437.50 USD, me shitës Sokolaj dhe blerës G.S. Minerals d.o.o.
- Fatura Nr.88/2023 datë 03.10.2023, me kod operatori cc924cg033, me shitës Kurum International, blerës Sokolaj sh.p.k., për artikullin "*Oksid zinku (në thesë) 2000t*", për pagesë në avancë;
- Autorizimi datë 14.11.2023, ku administratorja e shoqërisë "Sokolaj" sh.p.k. autorizon agjencinë doganore "Joti Spedition" si përfaqësues të tërthortë për deklarimin e mallrave të ardhura në emrin e saj;

Kjo deklarëtë është regjistruar dhe depozituar në sistemin Asycuda World nga agjenti doganor **Mikail Hila** që i përket shoqërisë Joti Spedition dhe janë konfirmuar nga punonjësit e Degës së Doganës Durrës, doganieri **Edmond Voda** dhe përgjegjësi i turnit **Julian Kapedani**.

Nga dokumentacioni i mësipërm rezulton se kjo praktikë doganore është në kundërshtim me Kodin Doganor dhe nuk duhet të ishte lejuar të kryhej nga agjenti doganor dhe punonjësit e Degës së Doganës Durrës.

Së pari: Në deklaratën e eksportit artikulli Oksid Hekuri (Zn), emërtohet sipas një artikulli që nuk ekziston në Kodin e Nomenklaturës pra duke i shtuar Zn, shkurtim i cili i përket elementit kimik Zink. Përshkrimi nga punonjësit doganorë i artikullit si Oksid Hekuri (Zn), është kryer edhe në kushtet kur fatura e shitjes lëshuar nga Kurum është **Oksid Zinku**, fatura e shitjes e lëshuar nga Sokolaj është **Oksid hekuri (Zn)** dhe në Bill of Lading (në vijim BL) përshkruhet si **concentrate zink**, pra tre lloje të ndryshme artikujsh.

Së dyti: Artikulli "Okside dhe Hidrokside hekuri" i është shtuar edhe përshkrimi "Jo Dual Use". Shtimi i përshkrimit të artikullit jashtë emërimit të përcaktuar në Kodin e Nomenklaturës, është bërë pa administruar asnjë analizë kimiko-fizike të artikullit, pa një dokument të lëshuar nga shoqëria Kurum, e cila ka shitur artikullin që të konfirmojë faktin nëse oksidi i zinkut që ka shitur është ose jo, Jo Dual Use, asnjë vetedeklarim nga eksportuesi për këtë fakt dhe asnjë dokument që vërteton përdorimin final të këtij produkti. Shtimi në përshkrim të emërimit "Jo Dual Use" është bërë pa u verifikuar dhe vlerësuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, por me qëllimin pikërisht për t'ju shmangur këtij verifikimi.

Së treti: Nga informacioni i datës 22.01.2026 i oficerit të policisë gjyqësore Besnik Tarja rezulton se, lidhur me kërkesën "Nëse mallrat "Oksid Hekuri (ZN)", të cilat janë deklaruar në kodin tarifar 28211000, gjatë deklarimit me EX 1 nr R 41205 dt 14.11.2023, do të ishin deklaruar "Oksid Zinku", siç pasqyrohet në faturën e TVSH-së së subjektit "KURUM INTERNATIONAL" sha për subjektin "SOKOLAJ", **në kodin tarifar 28170000**, (sipas Kodit të nomenklaturës I përket llojit të artikullit oksid zinku), cilat "Profile Risku" do e kishin goditur praktikën e eksportit ku mallrat do të ishin deklaruar në kodin tarifar 28170000", bëhet me dije se:

Në sistemin AW, në modulën e selektivitet ekziston LISTA_MBETJE_EX që përfshin kodin 28170000, dhe profili MBETJE_EX i cili vepron në procedurat eksportit (mbi këtë listë), 100 % në kontroll dokumentar me mesazhin: *"Në bazë të ligjit nr.10463 dt. 22.09.2011, i ndryshuar, VKM nr. 825 (It. 13.10.2010, VKM nr. 99 dt. 18.02.2005, të kryhen të gjitha kontrollet e nevojshme dokumentare, me qëllim ndalimin e Eksportit të mbetjeve nga territori i Shqipërisë, pa qenë të pajisura me autorizimin përkatës të Eksportit, të lëshuar nga Ministri i Mjedisit. Në rast konstatimi të ngarkesave të tilla në Eksport, të ndalohej Eksporti deri në paraqitjen me autorizimin përkatës. Për mallrat e deklaruar me kodet tarifore 2811 22 00 dhe 7019, të verifikohen nëse janë të reja apo mbetje, autorizimi i eksportit dhe certifikata e cilësisë të kërkohej vetëm në rast se janë mbetje. Të kryhet edhe skanimi. Kontakt Drejtoria Antitrafik: dra@dogana.gov.al Në rast konstatimi të shkeljes së Kodit Penal, të njoftohet Drejtoria Hetimit email: hetimi@dogana.gov.al.*

Së katërti: Agjenti doganor Mikail Hila, me procesverbalin datë 13.08.2024 nuk ka dorëzuar kopje të faturës 88/2023 datë 03.10.2023 për shitjen e artikullit oksid zinku, duke e fshehur atë, por kjo faturë ka qenë pjesë e praktikës doganore datë 14.11.2023 të kryer prej tij dhe është dorëzuar nga një punonjëse tjetër i kësaj agjensie me procesverbalin e datës 29.08.2024 dhe rezulton dhe nga dokumentacioni i sekuestruar në datë 19.01.2026 pranë agjensisë Joti Spedition, i dorëzuar nga administratori i Joti Spedition, Dashnor Hila.

2. Deklarata doganore R 11842 datë 27.03.2024, me eksportues është "Sokolaj" sh.p.k., marrës "GS Minerals d.o.o", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Tailanda, shuma totale në faturë 31,887.00 USD, 24 kontenierë, përshkrimi i mallit është: Okside dhe hidrokside hekuri Jo Dual Use OKSID HEKURI (ZN) = 637.740 KG.

Bashkëlidhur kësaj deklarata ndodhet dokumentacioni si vijon:

- Fatura Nr.19107/2023 datë 16.11.2023, për artikullin Oksid Hekuri, në sasinë 852.740 kg,
- me shitës Kurum International, blerës Sokolaj sh.p.k.;
- Fatura nr.13/2024 date 27.03.2024 për 637.74 ton Oksid Hekuri (Zn) me vlerë 31.887.00 USD, paguar 27.03.2024 me shitës Sokolaj dhe blerës G.S. Minerals d.o.o.;

- Listë e kontenierëve me të dhënat për numrat e tyre dhe peshën për 24 kontenierë;
- Autorizimi datë 14.11.2023, ku administratorja e shoqërisë “Sokolaj” sh.p.k. autorizon agjencinë doganore “Joti Spedition” si përfaqësues të tërthortë për deklarimin e mallrave të ardhura në emrin e saj.

Kjo deklaratë është depozituar në sistemin Asycuda World nga agjenti doganor Josif Gjika sipas userit dhe regjistruar në këtë sistem nga agjenti doganor Albert Alla. Në fakt është kryer nga **agjenti doganor Mikail Hila**, pasi shtetasit Josif Gjika dhe Albert Alla nuk punojnë më si agjentë doganor. Ky fakt konfirmohet nga vërtetimi i pagës për Albert Alla i administruar nga e-albania datë 13.01.2026, nga i cili rezulton se, marrëdhënia e punës me subjektin “JOTI SPEDITION” ka filluar në datën 01.02.2018 dhe ka përfunduar në datë 14.11.2022 dhe këqyrja e e-albania se Josif Gjika datë 19.01.2026, ku për shtetasin Josif Gjika nuk ka të dhëna që të jetë i deklaruar si punonjës i Joti Spedition apo i ndonjë agjencie tjetër doganore gjatë vitit 2024. Gjithashtu, fakti se kjo deklaratë është depozituar në sistemin Asycuda World nga agjenti doganor Mikail Hila konfirmohet edhe nga deklaratimet e shtetasit Dashnor Hila, administratori i shoqërisë Joti Spedition. Gjithashtu edhe shtetasi Josif Gjika ka konfirmuar se nuk është depozituar prej tij, por nga Mikail Hila.

Deklarata doganore është konfirmuar nga **doganieri Indrit Lika** dhe përgjegjësi i turnit **Julian Kapedani**, fakt që konfirmohet nga këqyrja e sistemit ASYCUDA ËORD datë 29.12.2025.

Në këtë deklaratë doganore edhe pse fatura e shitjes nga Kurum është oksid hekuri, fatura e Sokolaj për GS Minerals është për oksid hekuri (Zn), Bill of Lading për concentrate zinku, deklarata e eksportit ka përshkrim në kundërshtim me Kodin e Nomenklaturës.

3. Deklarata doganore R 15663 datë 22.04.2024, ku eksportues është Sokolaj sh.p.k, marrës GS Minerals d.o.o, vend origjine Albania, vendi i destinacionit Tailanda, shuma totale në faturë 4,068.00 USD, 3 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Okside dhe hidrokside hekuri Jo Dual Use OKSID HEKURI (ZN) = 81.360 KG.

Bashkëlidhur kësaj deklarata ndodhet dokumentacioni si vijon:

- fatura nr 28/2024 datë 22 prill 2024 për 81.36 ton oksid Hekuri (Zn) me vlerë USD 4,068.00, me shitës Sokolaj dhe blerës G.S. Minerals d.o.o.;
- Listë e kontenierëve me të dhënat për numrat e tyre dhe peshën për 3 kontenierë, 81.360kg;
- fatura Nr.19107/2023 datë 16.11.2023, për artikullin Oksid Hekuri, në sasinë 852.740 kg,
- me shitës Kurum International, blerës Sokolaj sh.p.k.
- Autorizimi datë 14.11.2023, ku administratorja e shoqërisë “Sokolaj” sh.p.k. autorizon agjencinë doganore “Joti Spedition” si përfaqësues të tërthortë për deklarimin e mallrave të ardhura në emrin e saj;

Kjo deklaratë doganore është depozituar në sistemin Asycuda World dhe regjistruar në këtë sistem nga agjenti doganor **Mikail Hila** dhe është konfirmuar nga doganieri **Indrit Lika** dhe përgjegjësi i turnit **Julian Kapedani**.

Këtë deklaratë doganore edhe pse fatura e shitjes nga Kurum është oksid hekuri, fatura e Sokolaj për GS Minerals është për oksid hekuri (Zn), Bill of Lading për concentrate zinku, deklarata e eksportit ka përshkrim në kundërshtim me Kodin e Nomenklaturës.

Në këtë eksport përdoret e njehta faturë e përdorur edhe në eksportin e datës 27.03.2024, fatura Nr.19107/2023 datë 16.11.2023, për artikullin Oksid Hekuri, në sasinë 852.740 kg, me shitës Kurum International, blerës Sokolaj sh.p.k.

4. Deklarata doganore R 27224 datë 04.07.2024, me eksportues është Sokolaj sh.p.k., marrës GS Minerals d.o.o, vend origjine Albania, vendi i destinacionit Tailanda, shuma totale në faturë 140,815.00 USD, 102 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Okside dhe hidrokside hekuri Jo Dual Use OKSID HEKURI (ZN) = 2.816.300 KG.

Bashkëlidhur kësaj deklarata ndodhet dokumentacioni si vijon:

- Faturë tatimore shitje nr.58/2024 datë 03.07.2024, me shitës “Sokolaj” dhe blerës GS Mineral Doo, për 2,816.30 ton **Oksid Hekuri (ZN)**, me vlerë 140.815 USD,
- Listë e kontenierëve me të dhënat për numrat e tyre dhe peshën për 102 kontenierë;
- Faturë elektronike tatimore **88/2023 Korrigjuese** datë 03.10.2023, me kod operatori cc924cg033, me shitës shoqërinë “Kurum International” sh.a dhe blerës shoqërinë “Sokolaj” sh.p.k, ku janë shitur 2.000 t **Oksid Hekuri**.
- Fatura Nr.19107/2023 datë 16.11.2023, për artikullin Oksid Hekuri, në sasinë 852.740 kg, me shitës Kurum International, blerës Sokolaj sh.p.k.

Kjo deklaratë doganore është depozituar në sistemin Asycuda World nga agjenti doganor **Mikail Hila** dhe konfirmuar nga doganieri **Shkëlqim Jakupi** dhe përgjegjësi i turnit **Helidon Lila**.

Siç rezulton përsa më sipër nga Sokolaj është bërë porosia dhe përshkrimi i mallit për eksportin e datave 14.11.2023, 27.03.2024, 22.04.2024 dhe 04.07.2024 për llojin e mallit “**Zink Concentrate**”, pavarësisht se e ka blerë si oksid zinku, oksid hekuri dhe në deklaratat e eksportit me përshkrimin okside dhe hidrokside hekuri jo dual Use.

Në këtë eksport përdoret e njehta faturë e përdorur edhe në eksportet e kryera në datë 27.03.2024 dhe 22.04.2024 si dhe fatura tatimore **88/2023 Korrigjuese** datë 03.10.2023, ku janë shitur 2.000 t **Oksid Hekuri**, e cila sipas deklarimeve të Kurum dhe Sokolaj ka korigjuar llojin e artikullit nga oksid zinku në oksid hekuri dhe (e cila rezulton e falsifikuar).

Bazuar në deklaratën doganore dhe dokumentacionin shoqërues punonjësit e doganës duhet të kishin refuzuar kryerjen e eksporteve pasi në dokumentacion ka pasur mangësi të dukshme dhe pasaktësi në përshkrimin e mallit që po eksportohej.

VII. Transportimi me anije i kontenierëve për të katër eksportet e kryera nga Sokolaj të datave: 14.11.2023, 27.03.2024, 22.04.2024 dhe 04.07.2024, është realizuar nga shoqëria MSC pas kërkesës së shtetases Gjovana Sokolaj dhe për të cilat **MSC** ka lëshuar Bill of Lading me të dhënat si më poshtë:

- Nr.606AL0006073, përshkrimi i mallit: **bulk, solid, fine particles of Zinc Concentrate**, 588.730.000 kg (kjo sasi përputhet me deklaratën doganore R 41205 datë 14.11.2023)
- Nr.606AL0006551, përshkrimi i mallit: **bulk, solid, fine particles of Zinc Concentrate**, 637.740.000 kg (kjo sasi përputhet me deklaratën doganore R 11842 datë 27.03.2024).
- Me datë 20.04.2024, Nr.606AL0006640, përshkrimi i mallit: **Cu Concentrate bulk**, 81.360 kg (kjo sasi përputhet me deklaratën doganore R 15663 datë 22.04.2024).

Për eksportin datë 04.07.2024:

- Nr.606AL0006881, përshkrimi i mallit: **bulk, solid, fine particles of Zinc Concentrate**, 583.630.000 kg, me bill of lading no. MEDUYB036828.
- Nr.606AL0006915, përshkrimi i mallit: **bulk, solid, fine particles of Zinc Concentrate**, 573.045.000 kg, me bill of lading no. MEDUYB036844.
- Nr.606AL0006914, përshkrimi i mallit: **bulk, solid, fine particles of Zinc Concentrate**, 545.105.000 kg, me bill of lading no. MEDUYB036836.
- Nr.606AL0006916, përshkrimi i mallit: **bulk, solid, fine particles of Zinc Concentrate**, 554.220.000 kg, me bill of lading no. MEDUYB036851.
- Nr.606AL0006929, përshkrimi i mallit: **bulk, solid, fine particles of Zinc Concentrate**, 555.325.000 kg, me bill of lading no. MEDUYB037081.

VI. Sipas aktit të ekspertimit rezulton se nga krahasimi i rezultateve analitike të 11 mostrave të marra nga kontenerët me rezultatet përkatëse të mostrave PROK-3, PROK-1, PROK-2 dhe PROK-5, konstatohet se 11 mostrat përputhen me mostrat PROK-3 (Kurum International) dhe PROK-5 (Alliance sh.p.k.). Këto materiale i përkasin të njëjtit material industrial, përkatësisht pluhurit të furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace dust – EAF dust) të tipit të pasur me zink (Zn-rich).

Duke ju referuar sa më sipër dhe nga analizimi i të gjitha praktikave doganore të cilat kanë të njejtat fatura të “Kurum” si origjinë malli, janë bërë tek e njejtja agjenci doganore, në vijim të kontratës datë 01.08.2023 të lidhur midis Kurum dhe Sokolaj, kontratave të lidhura me EMS nga GS Minerals d.o.o, ka dyshime të arsyeshme të cilat të krijojnë bindjen se edhe sasi të eksportuara me deklaratat doganore të datave 14.11.2023, 27.03.2024 dhe 22.04.2024 janë të të njëjtit lloj “pluhur i furrës elektrike të çelikut (Electric Arc Furnace dust – EAF dust), të tipit të pasur me zink (Zn-rich).

Për këtë qëllim në bashkëpunim me autoritetet doganore shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë i është kërkuar informacion autoriteteve të Tailandës në lidhje me eksportet e kryera në datat 14.11.2023, 27.03.2024 dhe 22.04.2024, nëse ato kanë mbërritur dhe janë marrë në dorëzim nga shoqëritë që e kanë blerë, i janë nënshtruar analizave dhe cdo të dhënë tjetër që disponojnë. Deri në këtë fazë nuk ka mbërritur ndonjë konfirmim.

Bazuar në këto të dhëna mbi dokumentet e paraqitur pranë autoriteteve doganore ku evidentohen shkelje, dokumente të falsikuara dhe pasaktësi në përshkrimin e mallit të eksportuar janë kryer veprime më të thelluara hetimore mbi veprimet që ka kryer çdo subjekt, që nga prodhimi/krijimi i mbetjeve të rrezikshme e deri në eksportimin e tyre.

Përpjekjet e Kurum dhe Sokokaj për të eksportuar mbetje të rrezikshme kanë nisur që në vitin 2022 me kërkesën për tu pajsiur me autorizim për transportin e mbetjeve të rrezikshme me kodin 10 02 07*, mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve që përmbajnë që substanca të rrezikshme.

Veprimet në secilën hallkë dhe secilin subjekt listohen në mënyrë të strukturuar, përpos sa më sipër, edhe si më poshtë vijon:

Në lidhje me subjektin Kurum International sh.a.:

Sipas ekstraktit historik të shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL SH.A” sh.a printuar në datë 30.12.2025 rezulton se, ky subjekt është regjistruar në datë 07.07.2000, me datë themelimi

10.11.1998, me zyrë qendrore në Tirane, me objekt veprimtarie: *Prodhim, tregtim i celiqeve te ndertimit e profileve te tjera te hekurit, importimi dhe eksportimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, konfeksioneve, elektroshtepiake, karburante e lubrifikante, lende te para ndihmese per industrine e celikut e te gjithë mineraleve te tjera. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit, hoteleri, ndertime te ndryshme. Prodhim gelqere, oksigjen, azot, avull e tregtim te tyre. Prodhim, Import-Eksport, tregtim, furnizim i energjise elektrike, energjise diellore dhe energjise nepermjet eres. Grumbullim, demolim, perpunim, tregtim, import-eksport te skrapeve te ndryshem. Prodhim, tregtim me shumice dhe pakice, eksport-import i materialeve te industrise se celiqeve sic eshte dhe pa u kufizuar vetem me to: aliazhet metalike, derdhjet metalike, konstruksionet e celikut, profilet me saldim dhe te petezuara, tubat me saldim dhe pa saldim. elementet e tjere te konstruksioneve metalike etj. Prodhim, tregtim me shumice dhe pakice, eksport-import, punime sipërfaqesore dhe/ose nentokesore te produkteve minerare qe perdoren si lende hyrese ne industrine metalurgjike. Kerkim, zhvillim, prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te gasoil, benzines, solarit, mazutit, bitumit, gazit te lengezuar te naftes (GLN), naftes, gazit dhe te gjitha nenprodukteve te tjera te naftes. Import - eksport dhe perdorim te burimeve te rrezatimit jonizues. Grumbullim, ruajtje/magazinim, transportim, riciklim dhe/ose asgjesim i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme. Transport Ndërkombëtar Mallrash për të tretët, për vete, dhe/ose me qira, transporte mallrash jashtë norme të mjetit. Prodhim oksigjen, argon, azot, avull , import-eksport, tregëtim dhe shitje me shumicë e pakicë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.*

Administrator i shoqërisë ka qenë Z. Erdal Demir prej datës 25.09.2019 deri në datë 08.12.2025.

Sipas historikut rezulton se është emëruar administrator i shoqërisë Z. Bulent Yazici prej datës 08.12.2025 deri në datë 08.12.2028, si dhe është larguar administratori Erdal Demir.

Nga aktet e këqyruara dhe sekuestruara pranë Kurum, akteve të përcjella me shkresën nr.548 prot., dt. 27.08.2024 të Kurum, protokolluar në zyrën tonë me nr.63022 dt. 02.09.2024, dhe dokumentacionit të administruar sipas procesverbalit të sekuestrimit datë 23.08.2024 nga Ministria e Mjedisit rezulton se shoqëria Kurum International sh.a. është i pajisur me:

- Leje mjedisore e tipi A me numer identifikimi 2378, dt. 26.09.2016 k dr. 30 dhe në vitin 2023 ka rinovuar lejen mjedisore e cila mban datën 09.07.2023, me nr identifikimi 2375/1, K.Nr.77.
- Licencë të kategorisë 111.2 b DT. 12.10.2020 K.RT. 38 dhe nr. identifikimi 416 për “Grumbullimin, transportimi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme”.

I pyetur nga policia gjyqësore, shtetasi turk **Erdal Demir**, administrator i shoqërisë Kurum prej datës 25.09.2019, ka deklaruar se, kontratën ndërmjet Kurum dhe Sokolaj e ka nënshkruar ai në cilësinë e administratorit. Ashtu siç është e përcaktuar në kontratë, kompania “Kurum Internacional” sh.a. do t’i shiste kësaj kompanie mbetjen Oksid Hekuri (*mbetje jo e rrezikshme*).

I pyetur në lidhje me sasinë e oksidit të zinkut që shoqëria Kurum International prodhon në një vit, shtetasi Erdal Demir ka deklaruar se, sasia e mbetjes Oksid Zinku me kod **10 02 07 *** të gjeneruar nga kompania Kurum në një periudhë kohore 1 vjeçare është afërsisht **1 % e sasisë së lëndës së parë (skrap)** që përpunon kompania për të gjeneruar hekurin që tregton. Në peshë rezulton rreth **5000 ton** në vit.



I pyetur në lidhje me faktin se çfarë bën kompania me këtë produkt, shtetasi Erdal Demir ka deklaruar se, shoqëria Kurum ka një departament i cili meret me mjedisin. Ky departament bën mbledhjen e mbetjeve të gjeneruara, i paketon ato në thasë të mëdhenj në një hapësirë të përcaktuar.

Në bazë të lejeve dhe licencave që mund të kenë kompanitë e ndryshme, **kompania Kurum bën shitjen e këtyre mbetjeve.**

Me kompaninë Sokolaj sh.p.k. kanë kohë që bashkëpunojnë dhe se në vitin 2021-2022 i kanë shitur kësaj kompanie mbetje **Oksid Zinku me kod 10 02 07 *** (mbetje të rrezikshme), ndërsa në vitin 2023 i kanë shitur vetëm mbetje Oksid Hekuri (jo të rrezikshme). Sasia e oksidit të hekurit që Kurum i ka shitur Sokolaj, është transportuar nga kompania Kurum drejt Kalatës Lindore të Portit të Durrësit me kamionët e kompanisë Kurum. Ngarkimi në kontenierë nuk është bërë nga shoqëria Kurum dhe nuk ka dijeni në lidhje me këtë fakt.

Shtetasi **Rami Bunga**, i punësuar si specialist pranë zyrës së mjedisit tek kompania Kurum, i pyetur në lidhje me llojin e mbetjeve që gjeneron kompania Kurum, ka deklaruar se, kjo kompani gjeneron mbetje të dala nga procesi teknologjik dhe mbetje të tjera. Gjatë procesit teknologjik në uzinën e çelikut, gjenerohen mbetjet: **“mbetje të ngurta nga trajtimet e gazrave, që përmbajnë substancë të rrezikshme”**, që në gjuhën teknike njihet si **“oksid zinku”** ose pluhur i kapur nga sistemi i pluhur kapjes. Ky produkt, sipas lejes së mjedisit dhe katalogut të mbetjeve ka kodin **10 02 07***. Gjithashtu, gjenerohet **“skorje e pa përpunuar”**, e cila ka kodin **10 02 02**, Smerec nga mulliri. që në gjuhën teknike njihet si **“Okalin”** ose në gjuhën e përditëshme **“Oksid Hekuri”** që i përket kodi **10 02 10**.

I pyetur në lidhje me me sasinë që gjeneron kompania Kurum për secilën nga mbetjet e cituara, shtetasi Rami Bunga ka deklaruar se, në lidhje me mbetjet **oksid zinku**, nga karta teknologjike, sasia e prodhuar është **1.5% deri në 2 % të sasisë së skrapit të përpunuar për prodhim**. Kjo në peshë për 4 ose 5 vitet e fundit ka qenë rreth 25.000 deri në 30.000 ton. Përsa i përket **oksidit të hekurit**, sipas kartës teknologjike, është 1.5% e sasisë së prodhimit të hekurit. që në peshë përkthehet rreth 40.000 ton.

I pyetur nëse shoqëria Kurum bën analiza të mbetjeve të gjeneruara dhe ku i bëjnë ato, shtetasi Rami Bunga ka deklaruar se ai personalisht ka marrë kampionë të mbetjeve të gjeneruara dhe i ka dërguar për analiza pranë laboratorit gjeologjik, i cili ndodhet në afërsi të zonës Vasil Shanto, Tiranë.

I pyetur në lidhje me administrimin e mbetjeve që gjenerohen nga procesi teknologjik nga kompania Kurum, shtetasi Rami Bunga ka deklaruar se, **oksidit i zinkut** futet në thasë të mëdhenj dhe magazinohet, ndërsa oksidi i hekurit depozitohet në sheshin përkatës. Në momentin që një produkt do evadohet, Rami paiset me dokumentacionin e duhur, i cili ka të bëjë me zbatimin e kushteve të lejes së mjedisit e konkretisht: kontrata e bashkëpunimit ndërmjet Kurum dhe kompanisë që merr mbetjet, leja dhe licenca e duhur e kompanisë që i merr për trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve, licenca e transportit ose kontratë me një kompani të licensuar për të kryer transferimin e mbetjeve me kodet përkatës sipas llojit të mbetjes.

Shtetasi **Mujo Ilazaj**, me detyrë drejtor transporti drejtues teknik për disa mjete pranë shoqërisë Kurum, ka deklaruar se, në lidhje me transportin e bërë për llogari të kompanisë Sokolaj, është kontaktuar nga administratori i kompanisë Kurum z. Erdal Demir, i cili e ka njoftuar se duhet ta suportonte me mjete transporti, për të bërë një transport nga kompania Kurum drejt terminalit lindor të mbuluar nga EMS në portin e Durrësit. Menjëherë, ka njoftuar shoferët të paraqiten pranë

departamentit të shitjes ku bëhen dokumentat përkatëse për çdo kamion sipas mallit që ngarkohen për në destinacionin pritës dhe në përfundim të transportit të çdo rruge, të gjithë dokumentacionet që jepen nga departamenti përkatës, dorëzohen përsëri tek ky departament, që në këtë rast është departamenti shitës. Në lidhje me këtë transport shtetasi Mujo Ilazaj ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e automjeteve të përdorura nga kompania Kurum për të kryer këtë transport.

Nga dokumentacioni i administruar nga AKM në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria Kurum si detyrim i Ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe mbajtës të lejeve të sipërcituara rezulton se, për periudhën 2022-2024 ka lidhur kontrata për shitjen e mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve të rrezikshme me disa subjekte ku janë evidentuar deri në këtë fazë të hetimit shkelje të ligjit si nga Kurum ashtu edhe nga subjektet kontraktuese si më poshtë:

- Sokolaj sh.p.k.
- Alliance Resource sh.pk.
- Bajrami N sh.p.k.

Në lidhje me subjektin Sokolaj sh.p.k.:

Sipas ekstraktit historik të shoqërisë Sokolaj sh.p.k. printuar në datë 13.08.2024 rezulton se ky subjekt është regjistruar në datë 10.07.2006, me datë themelimi 22.06.2006, me seli në Durrës, rruga "Vath Turja", pasuria 108/24 ZK 8517, me objekt veprimtarie *tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme,zbatim të punimeve të ndërtimit,rritje shpendësh, grumbullim, përpunim dhe shitje të mbetjeve joindustriale, eksport-import i mbetjeve jo të rrezikshme si zinku, bakri etj, grumbullim transportim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, etj.*

Administratore e shoqërisë është **Zj. Oliziana Pemati** prej datës 03.08.2023 deri në datë 02.08.2028 dhe **Gjovana Sokolaj** nga data 31.08.2018 deri në datë 02.08.2028, me të drejta të plota dhe ta pakufizuara për të vepruar për cdo veprimtari të shoqërisë bashkërisht dhe vetëm. Ortake e shoqërisë Zj. Gjovana Sokolaj.

- Sipas historikut rezultoi se, në datë 26.06.2006 ortakë të shoqërisë kanë qenë Gjovana Sokolaj dhe **Doni Sokolaj** me 50% të kuotave secili, ndërsa përfaqësues ligjor ka qenë Gjovana Sokolaj.

Në datë 03.11.2010 është shtuar administratore Olizana Pemati dhe është larguar Gjovana Sokolaj.

Në datë 29.06.2011 është shtuar administrator Gjovana Sokolaj dhe është larguar Olizana Pemati.

Sipas kontratës nr.370 rep dhe nr.262 kol datë 29.04.2013 është bërë shitja e kuotave 50% nga Doni Sokolaj tek Serdar Can Hakliol.

Sipas kontratës së shitjes Nr.329 rep dhe nr.111/1 kol datë 04.02.2014 është kryer shitja e kutoave të ortakut Serdar Can Hakliol tek ortakja Gjovana Sokolaj e cila bëhet ortakë e vetme e shoqërisë.

Sipas vendimit nr.2 datë 29.05.2014 është larguar përfaqësuesja Gjovana Sokolaj dhe është emëruar **Olizana Pemati**.

Në datë 20.11.2014 me vendimin nr.3 të shoqërisë është shtuar objekti i veprimtarisë për grumbullim, përpunim dhe shitje të mbetjeve metalike industrial dhe jo industrial.

Në datë 15.10.2015 është shtuar adresa e shoqërisë në Krujë, Durrës.

Sipas kontratës së shitjes datë 18.11.2015 495 e kuotave i është shitur ortakut Doni Sokolaj.

Sipas kontratës datë 28.12.2015 është bërë shitja kuotave nga ortakut Doni Sokolaj tek Gjovana Sokolaj e cila bëhet ortakë e vetme e shoqërisë si dhe shtohet adresë tjetër në Shkodër.

Në datë 31.08.2018 është larguar administrator Oliziana Pematit dhe është vendosur Gjovana Sokolaj.

Në datë 27.10.2020 është shtuar objekti i veprimtarisë për eksport-import i mbetjeve jo të rrezikshme si zinku, bakri etj.

Në datë 09.12.2020 është shtuar adresa në uzinë e prodhimit të ferrokromit Elbasan.

Në datë 28.10.2021 është shtuar adresa Durrës, rruga Vath Turja.

Në datë 24.03.2022 është shtuar objekti i veprimtarisë për grumbullim, transportim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Në datë 06.04.2023 është hequr adresa Elbasan, uzina e prodhimit të Ferrokromit.

Në datë 03.08.2023 është vendosur riemërimi administratorës Gjovana Sokolaj dhe emërimi i administراتores Oliziana Pematit me të drejta të plota bashkërisht dhe veç e veç.

Shoqëria "Sokolaj" sh.p.k. është pajisur me 2 leje nga Ministria e Mjedisit për:

i) transport të mbetjeve të rrezikshme

ii) eksport të mbetjeve jo të rrezikshme

Shoqëria Sokolaj nuk rezulton të ketë Autorizim për eksportim të mbetjeve të rrezikshme dhe as nuk i është aprovuar një kërkesë e tillë për periudhën 2022-2024.

Shoqëria Sokolaj ka blerë nga Kurum artikullin Oksid Zinku, pa pasur leje të veçantë për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, ndërkohë që për transportimin e këtyre mbetjeve të cilat klasifikohen me kodin 10 07 02* kërkohet autorizim i posaçëm për eksportin e mbetjeve. Sipas Ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" nenit 51 të këtij ligji si dhe VKM-së Nr.641 datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe të inerteve", përveç lejes mjedisore të tipit B si dhe lejes mjedisore të tipit 1112B, për transportin e tyre duhet dhe leje e veçantë të cilën nuk e ka pasur.

Rezulton nga aktet e administruara nga AKM se, subjekti Sokolaj sh.p.k. ka aplikuar për një leje të tillë dhe në datën 12.12.2022 me shkresën nr. 6433/2 prot i është kërkuar plotësim dokumentacioni, të cilin ajo nuk e ka plotësuar dhe më pas ka vijuar me kryerjen e veprimtarisë së paligjshme.

Rezulton se shtetasja Gjovana Sokolaj në agjencinë doganore ka deklaruar produktin si "oksid hekuri" ashtu si edhe është përcaktuar në kontratën me shoqërinë Kurum, ndërkohë që fatura e deklaruar në tatime është oksid zinku dhe në faturën e shitjes bërë shoqërisë GS Minerals d.o.o me seli në Kroaci, i ka shtuar si element në kllapa kodin ZN pra "Okside hekuri (ZN).

Në kërkesën e datës 19.08.2022, Sokolaj shprehet se bazuar në kontratën me gjeneruesin e mbetjeve Kurum International sh.a. angazhohet ti blej mbetjet me kod 10 02 07*, me sasi vjetore 25.000 ton në vit, me vend origjine Kurum, Elbasan. Me mjetin e pajisur me ADR i marrë me qera nga Sokolaj do të transportojë këto mbetje në portin e Durrësit dhe me anije kontenierësh me

destinacion tranziti Turqi dhe me destinacion Tajlandën. Nuk rezulton të jetë lëshuar autorizim për këtë kërkesë nga Ministria e Mjedisit.

Në vitin 2023 Sokolaj i drejton Ministrisë së Mjedisit një kërkesë tjetër për tu pajisur me autorizim për eksport mbetjeve të rrezikshme e konkretisht:

Me shkresën e datës 07.03.2023 subjekti Sokolaj i ka drejtuar kërkesë për autorizimin e eksportit të mbetjeve Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar te kjo Ministri me nr.283/1prot., date 30.03.2023.

Nga kjo shkresë rezulton se, subjekti Sokolaj bazuar në kontratën me gjeneruesin e mbetjeve Kurum International sh.a, ndër të tjera angazhohet t'i blejë dhe mbetjet **me kod 100207*** (mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme). Sasia vjetore e këtyre mbetjeve është 25000 ton/vit për vitin e parë pasi ka stok sasi. Kjo sasi do të dërgohet deri në përfundimin e kontratës me blerësin 31.12.2029. Sasia totale parashikohet 50.000 ton deri në 21.12.2029.

Vendi i origjinës së këtyre mbetjeve është Shqipëria, me adresë Elbasan Bradashesh vend i ushtrimit të aktivitetit të gjeneruesit të mbetjeve Kurum International, ku më pas me mjetin e pajisur me licencën përkatëse për transportin e këtyre mbetjeve (Mbetja nuk është pjesë e Aneksit A të ADR) me targë AAR811 në përdorim të subjektit Sokolaj i pajisur me licencë III.2.B për transportin e këtyre mbetjeve, do të transportohen drejt Portit të Durrësit.


Më pas, destinacioni me anije kontenierësh është transporti drejt vendit të importit Port Haiphong, Lot C12, Khanh Phu Industrial Zone, Khanh Phu Ward, Yen Khanh District, Ninh binh Province, **Vietnam** ku do kryhet shkarkimi i ngarkesës për tu marrë nga porositësi sipas procedurave doganore dhe ligjeve të Tailandës bazuar në kontratën e lidhur mes palëve. Paketimi do të bëhet në vendin e origjinës në thasë plastike (Big Bags) të cilët do të futen në kontenier 20 feet për tu transportuar me kamion drejt Portit të Durrësit e më pas futen në kontenierët për tu transportuar me anije transporti kontenierësh.

Sa më sipër, bazuar në praktikat e administruara pranë AKM, rezulton se shoqëria Sokolaj dhe Kurum kanë pasur marrëdhënie bashkëpunimi të vazhdueshme për të eksportuar pikërisht këtë lloj mbetje të rrezikshme me kod **me kod 100207***. Mosdhënia e autorizimit nga Ministria e Mjedisit për të eksportuar këtë lloj mbetje, ka bërë që shoqëria Sokolaj dhe Kurum ta eksportojnë këtë mbetje në kundërshtim me ligjin, pa autorizimin përkatës duke fshehur natyrën e vërtetë të mbetjes në aktet shkresore, pavarësisht se nëpërmjet pasaktësive dhe mospërrputhjeve mes tyre, konkludohet në mënyrë të arsyeshme se objekti i shitblerjes kanë qenë pikërisht mbetjet me kod 10 02 07* (mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme).

Me datë 21.03.2022 midis shoqërive Maresh sh.p.k. me administrator Mariglent Hasa me NIPT L42802203U dhe shoqërisë Sokolaj, është lidhur akt-marrëveshje "Për depozitimin e mbetjeve".

Qëllimi i akt-marrëveshjes është që shoqëria Sokolaj sh.p.k. të depozitojë mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme sipas kodeve përkatëse në Lejen Mjedisore të tipit "B" PN-0418-04-2021 në mjediset e shoqërisë Maresh sh.p.k, sipas rregulloreve përkatëse për transferimin e këtyre mbetjeve. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 1 vjeçare.

Shoqëria "Maresh" sh.p.k e disponon kodin 191002 në lejen e tij mjedisore, por ka të drejtë vetëm ta magazinon dhe ta ruajë përkohësisht me operacionet D15, R12 dhe R13. Nuk mundet shoqëria



Maresh sh.p.k ta trajtojë këtë mbetje kur kjo shoqëri vetë ka për detyrë ta dërgojë në subjekt të licencuar për trajtim dhe nuk mund të jetë destinacion final, por ka detyrimin vetë t'i çojë dikur për trajtim, ka të drejtë vetëm t'i ruajë përkohësisht.

Lidhur me subjektin Alliance Resource shpk:

Nga të dhënat shkresore rezulton se, Alliance Resource sh.p.k është person juridik i krijuar në vitin 2017 me themelues shtetasen Mbarime Koroci dhe Wen Ming. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.455, datë 3.7.2019 *"Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë metarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Alliance Resource", shpk, si qiramarrës, për pasurinë me sipërfaqe tëpërgjithshme 57390 m²"* kjo shoqëri ka marrë me qera "Objekti nr. 226 "Depo e Koncentratit të Hekurit" me sipërfaqe të përgjithshme 2655 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 1500 m² dhe sipërfaqe funksionale 1155 m² me nr. pasurie 611, Objekti 1-3G "Vaskat e Betonit, me sipërfaqe të përgjithshme 400 m² nga ku sipërfaqe ndërtimore 400 m² dhe truall 400 m² me nr. pasurie 624 dhe truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 54 335 m², ZK 3965", në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes së Prodhim Çeliqueve, Elbasan". Adresa e kësaj shoqërie është Ish-Uzina 12, Kombinati Metalurgjik, Depo e Koncentratit, Bradashesh.

Në vitin 2021 është larguar administratori Erdes Nushi dhe administratore e shoqërisë është caktuar ortakja **Mbarime Koroci**.

Ndër të tjera, nga administrimi i dokumentacionit të kësaj shoqërie, evidentohet fakti se më datë 03.02.2020 kjo shoqëri e përfaqësuar nga shtetasi **Erdes Nushi** ka lidhur një kontratë shitje me afat 5 vjeçar, të mallit Oksid Hekuri me kod doganor 2821000 në sasinë 1500-2500 Ton/muaj. Kjo kontratë është lidhur me shoqërinë Ertako LTD, e përfaqësuar nga shtetasja **Mbarime Koroci**. Kjo shoqëri, sipas kontratës rezulton me adresë në Ajeltake Road, Ajeltake Island, Marshall Islands. Në këtë kontratë nuk rezulton vendi i dorëzimit (destinacioni) i mallit që do të shitet. Adresa e e-mailit e vendosur në këtë ekstrakt rezulton aurelkoroci@hotmail.com, që rezulton se është administrator i shoqërisë "Koroçi" sh.p.k me NIPT K92403506N.

1. **Në datë 21.01.2021** është lidhur kontratë "Për menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme" midis shoqërisë "**Kurum Internacional**" sh.a me NIPT K02727230T me administrator Erdal Demir, i përfaqësuar me prokurë nga Yusuf Sezai Kurum dhe Arif Shkalla, në cilësinë e krijuesit të mbetjeve dhe shoqërisë "**Alliance Resource**" sh.p.k me NIPT L71911027L me administrator Erdest Nushi në cilësinë e menaxhuesit të licencuar dhe shoqërisë "Koroçi" sh.p.k me NIPT K92403506N me administrator Aurel Koroçi. Objekti i kontratës konsiston në dorëzimin e mbetjeve pluhur nga sistemi pluhur kapës, nga ana e krijuesit të mbetjeve për depozitim dhe trajtim nga ana e menaxhuesit të licensuar, pas grumbullimit të tyre në terrenin e stoqeve në kompleksin "Kurum Internacional" sh.a., Elbasan. **Kodi i këtyre mallrave është 10 02 07*- mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substancë të rrezikshme.**

Kjo kontratë është e vlefshme deri në përfundimin e sasisë së kontraktuar.

Sipas kësaj kontrate, menaxhuesi i licencuar të jetë i pajisur me Leje Mjedisi për aktivitetin që ushtron, të zbatojë rregulloren e mjedisit si dhe të ndjekë legjislacionin e sigurimit të shëndetit në

punë deri në depozitim dhe trajtimin /riciklimin e mbetjeve objekt kontrate pas marrjes së tyre nga kompleksi i Kurum International sh.a, Elbasan.

Sasia që do të faturohet sipas kushteve të kësaj kontrate është **2780 ton**, kundrejt çmimit prej **54 USD / ton** me TVSH.

2. Në datë **15.06.2023** është lidhur kontratë tjetër “Për menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme” midis shoqërisë “Kurum Internacional” sh.a me NIPT K02727230T me administrator Erdal Demir, i përfaqësuar me prokurë nga Yusuf Sezai Kurum dhe Arif Shkalla, në cilësinë e krijuesit të mbetjeve dhe shoqërisë “Alliance Resource” sh.p.k. me NIPT L71911027L me administratore Mbarime Koroçi në cilësinë e menaxhuesit të licencuar. Objekti i kontratës konsiston në dorëzimin e mbetjeve pluhur nga sistemi pluhur kapës (me përmbajtje Oksid Zinku 5-20 %) nga ana e krijuesit të mbetjeve për depozitim dhe trajtim nga ana e menaxhuesit të licensuar, pas grumbullimit të tyre në terrenin e stokeve në kompleksin “Kurum International” sh.a., Elbasan.

Kodi i këtyre mallrave është 10 02 07*- mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substancë të rrezikshme.

Kjo kontratë është e vlefshme deri në përfundimin e sasisë së kontraktuar.

Krijuesi i mbetjeve do të marrë përsipër organizimin e lëvrimit të mbetjeve duke filluar nga data 03.07.2023, sipas sasive të grumbulluara të mbetjeve objekt kontrate, të cilat do të provohen nëpërmjet një dokument transferimi të firmosur nga të dyja palët.

Menaxhuesi i licencuar është i pajisur me Leje Mjedisit Tipi A Nr. Identifikimi 3137/1 dt 16.12.2020 Komisioni Nr 47 Nr 8240 Prot për aktivitetin që ushtron dhe të zbatojë rregulloren e mjedisit si dhe të ndjekë legjislacionin e sigurimit të shëndetit në punë deri në depozitim dhe trajtimin /riciklimin e mbetjeve objekt kontrate pas marrjes së tyre nga kompleksi i Kurum International sh.a., Elbasan.

Sasia që do të faturohet sipas kushteve të kësaj kontrate është në varësi të mbetjes së gjeneruar nga procesi prodhimit kundrejt çmimit prej 1 (një) lek / ton me TVSH.

3. Më datë **10.05.2024** është lidhur kontratë tjetër “Për menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme” midis shoqërisë “Kurum Internacional” sh.a me NIPT K02727230T me administrator Erdal Demir, i përfaqësuar me prokurë nga Yusuf Sezai Kurum dhe Arif Shkalla, në cilësinë e krijuesit të mbetjeve dhe shoqërisë “Alliance Resource” sh.p.k me NIPT L71911027L me administratore Mbarime Koroçi në cilësinë e menaxhuesit të licencuar. Objekti i kontratës konsiston në dorëzimin e mbetjeve pluhur nga sistemi pluhur kapës (me përmbajtje Oksid Zinku 5-20 %) nga ana e krijuesit të mbetjeve për depozitim dhe trajtim nga ana e menaxhuesit të licensuar, pas grumbullimit të tyre në terrenin e stokeve në kompleksin “Kurum International” sh.a., Elbasan.

Kodi i këtyre mallrave është 10 02 07*- mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substancë të rrezikshme.

Kjo kontratë është e vlefshme deri me datë 10.05.2025.

Krijuesi i mbetjeve do të marrë përsipër organizimin e lëvrimit të mbetjeve duke filluar nga data 13.05.2024 sipas sasive të grumbulluara të mbetjeve objekt kontrate, të cilat do të provohen nëpërmjet një dokumenti transferimi të firmosur nga të dyja palët.



Menaxhuesi i licencuar është i pajisur me Leje Mjedisi Tipi A Nr. Identifikimi 3137/1 dt 16.12.2020 Komisioni Nr 47 Nr 8240 Prot për aktivitetin që ushtron dhe të zbatojë rregulloren e mjedisit si dhe të ndjekë legjislacionin e sigurimit të shëndetit në punë deri në depozitim dhe trajtimin /riciklimin e mbetjeve objekt kontrate pas marrjes së tyre nga kompleksi i Kurum International sh.a., Elbasan. Sasia që do të faturohet sipas kushteve të kësaj kontrate është në varësi të mbetjes së gjeneruar nga procesi prodhimit kundrejt çmimit të përcaktuar nga palët në momentin e lëvrimit të mallit.

Në të treja kontratat e sipërcituara rezulton se, krijuesi i mbetjeve do të grumbullojë në mënyrën e duhur mbetjet objekt kontrate që dalin nga kompleksi i Kurum International sh.a. Elbasan në terrenin e stokeve. Pas grumbullimit të këtyre mbetjeve do të njoftojë menaxhuesin e licencuar në mënyrë që të kryejë lëvrimin e tyre.

Menaxhuesi i licencuar zotohet se prej marrjes së mbetjeve objekt kontrate do t'i trajtojë pranë impiantit të trajtimit të mbetjeve.

Krijuesi i mbetjeve merr përsipër ngarkimin e mallit me mjetet e veta si dhe peshimin në peshoren elektronike, përfshirë edhe transportimin e mbetjeve objekt kontrate deri në adresën e Menaxhuesit të licencuar. Krijuesi i mbetjeve është i pajisur me Licencë Nr.416 Dt.12.10.2020 të kategorisë III 2 B "Për Grumbullim Transportim i Mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme" dhe me Kod Unik KM10170.

Menaxhuesi i licencuar mban përgjegjësi për përpunimin e tyre sipas rastit përkatës të nivelit të ndotjes që mbetjet kanë.

Sipas procesverbalit të policisë gjyqësore datë 30.10.2024 rezulton se administratorja Mbarime Koroci ka dorëzuar kontratën e lidhur me Kurum datë 10.05.2024 dhe faturat e blerjes nga Kurum:

- 1.Fatura Nr.7816 datë 21.05.2024 me shitës Kurum dhe blerës "Alliance Resource" sh.p.k. të artikullit oksid zinku në saishë prej 2.000.000 kg (2000t) në vlerën 25.200,13 USD.
- 2.Fatura Nr.9976 datë 24.06.2024 me shitës Kurum dhe blerës "Alliance Resource" sh.p.k. të artikullit oksid zinku në saishë prej 250.000 kg (250t) në vlerën 9998,99 USD.
- 3.Fatura Nr.12188 datë 30.07.2024 me shitës Kurum dhe blerës "Alliance Resource" sh.p.k. të artikullit oksid zinku në saishë prej 250.000 kg (250t) në vlerën 9997,87 USD.
4. 3 (tre) fleta analize në gjuhën angleze datë 24.10.2024, me klient "Alliance Resource" sh.p.k., me të dhëna të ndryshme të rezultateve të parametrave të elementëve kimik.
5. Fletë analize në gjuhën angleze datë analize 24.07.2024 (datë printimi 02.09.2024), me sample name: EAF-EEC-01.

Rezulton se shoqëria "ALLIANCE RESOURCE" sh.p.k ka kryer eksporte në vitin 2023, të "Oksid Zinku" në Kinë te "Guangxi Furuan Metal Material" dhe në Belgjikë te "Jean Goldschmidt International" s.a.

Nga dokumentacioni i administruar me shkresën nr.8396/1prot datë 05.11.2024 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan rezulton se shoqëria "Koroci" sh.p.k. me NIPT K92403506N i ka shitur blerësit "Alliance Resource" me NIPT L71911027L, okside ZN nëpërmjet faturave:

- **Nr.1 datë 01.03.2023** me përshkrim malli **Okside ZN**, në sasinë 150000 kg, në vlerën 1035000 lek;

USD;

Shoqëria "Alliance Resource" sh.p.k ka kryer eksportet me marrës Jean Goldschmidt International s.a Bruxelles Belgjikë dhe Guangxi Furuan Metal Material Co, Ltd Nanning China, nëpërmjet deklarave doganore si më poshtë:

1. Deklarata doganore R40800 datë 15.10.2024, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 129,880.00 USD, 128 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 129,688.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.287 datë 14.10.2024 i laboratorit "Albkontroll C&A" për mostrën oksid zinku.
2. Deklarata doganore R27432 datë 05.07.2024, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 53,305.00 USD, 64 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 56,110.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.168 datë 02.07.2024 i laboratorit "Albkontroll C&A" për mostrën oksid zinku.
3. Deklarata doganore R34907 datë 02.09.2024, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 107,049.00 USD, 131 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 125,743.5000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.284 datë 30.08.2024 i laboratorit "Albkontroll C&A" për mostrën oksid zinku.
4. Deklarata doganore R17638 datë 08.05.2024, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 76,883.00 USD, 131 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 102,510.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.119 datë 07.05.2024 i laboratorit "Albkontroll C&A" për mostrën oksid zinku.
5. Deklarata doganore R13960 datë 10.04.2024, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 55,944.00 USD, 87 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 79,920.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.75 datë 09.04.2024 i laboratorit "Albkontroll C&A" për mostrën oksid zinku.
6. Deklarata doganore R7364 datë 20.02.2024, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 80,389.00 USD, 148 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 114,618.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.35 datë 19.02.2024 i laboratorit "Albkontroll C&A" për mostrën oksid zinku.
7. Deklarata doganore R39203 datë 02.11.2023, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 72,258.00 USD, 176 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 120,430.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.349 datë 01.10.2023 i laboratorit "Albkontroll C&A" për mostrën oksid zinku.
8. Deklarata doganore R29422 datë 02.09.2023, ku eksportues është "Alliance Resource" sh.p.k, marrës "Jean Goldschmidt International s.a", vend origjine Albania, vendi i destinacionit Belgium, shuma totale në faturë 60,348.00 USD, 156 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid



- **Nr.2 datë 25.04.2023** me përshkrim malli **Okside ZN**, në sasinë 150000 kg, në vlerën 1035000 lek;
- **Nr.3 datë 02.05.2023** me përshkrim malli **Okside ZN**, në sasinë 150000 kg, në vlerën 1035000 lek;
- **Nr.4 datë 04.12.2023** me përshkrim malli **Okside ZN**, në sasinë 150000 kg, në vlerën 1035000 lek;
- **Nr.1 datë 09.03.2024** me përshkrim malli **Okside ZN**, në sasinë 150000 kg, në vlerën 1035000 lek;
- **Nr.2 datë 30.03.2024** me përshkrim malli **Okside ZN**, në sasinë 150000 kg, në vlerën 1035000 lek;
- **Nr.3 datë 24.05.2024** me përshkrim malli **Okside ZN**, në sasinë 150000 kg, në vlerën 1035000 lek;

Shoqëria “Alliance Resource” me NIPT L71911027L i ka shitur blerësit “Jean Goldschmidt International” s.a me adresë place de l’Albertine 2, oksid zinku nëpërmjet faturave:

- **Nr.2 datë 18.07.2023** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 22.5 ton, në vlerën 11250 USD;
- **Nr.4 datë 02.09.2023** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 100.58 ton, në vlerën 60348 USD;
- **Nr.5 datë 01.11.2023** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 120.43 ton, në vlerën 72258 USD;
- **Nr.1 datë 20.02.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 114.842 ton, në vlerën 80389.41 USD;
- **Nr.2 datë 08.04.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 79.92 ton, në vlerën 55944 USD;
- **Nr.3 datë 08.05.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 102.51 ton, në vlerën 76882.50 USD;
- **Nr.4 datë 05.07.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 56.11 ton, në vlerën 53304.51 USD;
- **Nr.5 datë 31.08.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 125.94 ton, në vlerën 0.00 USD (fatura nuk shfaqet te tatime.gov.al);
- **Nr.6 datë 31.08.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 125.94 ton, në vlerën 107049 USD;
- **Nr.7 datë 31.08.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë -125.94 ton, në vlerën 0.00 USD;
- **Nr.9 datë 15.10.2024** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 129.88 ton, në vlerën 129880 USD;

Shoqëria “Alliance Resource” me NIPT L71911027L i ka shitur blerësit “Guangxi Furuan Metal Material co” l.t.d me adresë Nanning, China, oksid zinku nëpërmjet faturës:

- **Nr.1 datë 26.05.2023** me përshkrim malli **Oksid zinku**, në sasinë 77.89 ton, në vlerën 54523

zinku; peroksid zinku = 100,346.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.269 datë 01.08.2023 i laboratorit “Albkontroll C&A” për mostrën oksid zinku.

9. Deklarata doganore R22693 datë 19.07.2023, ku eksportues është “Alliance Resource” sh.p.k, marrës “Jean Goldschmidt International s.a”, vend origjine Albania, vendi i destinacionit Kina, shuma totale në faturë 11,250.00 USD, 1 kontenier, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 22,500.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.221 datë 17.07.2023 i laboratorit “Albkontroll C&A” për mostrën oksid zinku.

10. Deklarata doganore R15879 datë 29.05.2023, ku eksportues është “Alliance Resource” sh.p.k, marrës “Huangxi Furuan Metal Material co” Ltd Nanning China, vend origjine Albania, vendi i destinacionit Kina, shuma totale në faturë 54,523.00 USD, 125 kontenierë, ndërsa përshkrimi i mallit është: Oksid zinku; peroksid zinku = 77,890.0000 KG. Bashkëlidhur kësaj deklarate ndodhet edhe certifikate analize nr.111 datë 25.05.2023 i laboratorit “Albkontroll C&A” për mostrën oksid zinku. Sasia totale e eksportuar nga shoqëria Alliance Resource, nëpërmjet deklaratave doganore të mësipërme është 929,755.5 kg.

Deklaratat doganore të sipërcituara kanë kod tarifor 28170000 dhe në bazë të ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 i ndryshuar dhe VKM-së nr.825 datë 13.10.2010 dhe VKM-së nr.99 datë 18.02.2005, duhet të kryhen të gjitha kontrollet e nevojshme dokumentare me qëllim ndalimin e eksportit të mbetjeve nga territori i Shqipërisë, pa qenë të pajisura me autorizim përkatës të eksportit, të lëshuar nga Ministri i Mjedisit. Në rast konstatimi të ngarkesave të tilla në Eksport, të ndalohej eksporti deri në paraqitjen me autorizim përkatës.

Në dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave doganore të sipërcituara nuk rezultojnë autorizim përkatës për eksport të lëshuar nga Ministri i Mjedisit, për sa më sipër, por vetëm Leja e Mjedisit Tipi A nr.3137/1, K.Nr.47, nr.8240prot datë 16.12.2020.

Nga shtojca 1 “Formati i regjistrimit të transfertave individuale të mbetjeve të rrezikshme” “Pluhur nga sistemi pluhur kapës” (“Mbetje të ngurta nga trajtimi i gazeve, që përmbajnë substance të rrezikshme”), të raportuar nga shoqëria Kurum në AKM, rezultojnë se për vitin 2023 ka deklaruar për marrësin shoqërinë Alliance Resource të dhënat si më poshtë:

- **Mbetje të rrezikshme,**
- Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme,
- **Kod të mbetjes sipas katalogut Shqiptar të mbetjeve 10 02 07 *,**
- Intervali kohor 03.07.2023-21.07.2023,
- Numra regjistrimi të automjeteve: AB 301 KU, AB 302 KU, AB 303 KU, AB 304 KU, AB 305 KU, AB 306 KU, AB 307 KU,
- **Sasia totale 8611 ton.**

Ndërsa, nga shtojca 1 “Formati i regjistrimit të transfertave individuale të mbetjeve të rrezikshme” “Mbetje të ngurta nga trajtimi i gazeve, që përmbajnë substance të rrezikshme”, të raportuar nga shoqëria Kurum International sh.a në AKM, rezultojnë se për vitin 2024 ka deklaruar për marrësin shoqërinë “Alliance Resource” sh.p.k, të dhënat si më poshtë:

- Mbetje të rrezikshme,
- Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme,
- Kod të mbetjes sipas katalogut Shqiptar të mbetjeve 10 02 07 *,



- Intervali kohor 13.05.2024-17.05.2024,
- Numra regjistri të automjeteve: AB 301 KU, AB 302 KU,
- **Sasia totale 2000 ton.**

Te shtojca 1 sasia totale rezulton 2000 t dhe intervali kohor 13.05.2024-17.05.2024, ndërsa te tabela në excel regjistri i transfertave sasia totale rezulton 1005 ton dhe intervali kohor 13.05.2024-15.05.2024, pra një diferencë prej 995 ton.

Shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në deklaratimet e saj në Regjistrat e transfertave Individuale të mbetjeve deklaroi se dërgon te shoqëria “Alliance Resource” sh.p.k, mbetje të rrezikshme me kodin 10 02 07* (mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme), ndërkohë që shoqëria “Alliance Resource” sh.p.k nga ana tjetër deklaroi se ka tërhequr nga “Kurum International sh.a” sh.a, mbetje jo të rrezikshme me kodin: 10 02 08 (mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve), të tjera nga ato të përmendura në 10 02 07, edhe pse mbetjet me kod 10 02 07* janë evidentuar edhe gjatë inspektimit në vitin 2024.

Sipas dokumentacionit të administruar nga AKM sipas procesverbalit të këqyrjes dhe marrjes së provës material datë 31.12.2025 në lidhje me raportimet e kryera nga subjekti Alliance Resource rezultojnë të dhënat si më poshtë:

Për vitin 2021-2022 nuk ka matje, deklaroi që nuk ka pasur aktivitet.

2. Raportimet 3 mujore 2022-2023

- Dhjetor 2022-mars 2023, deklaroi se nuk ka pasur aktivitet sepse ka qenë në fazë remonti (nuk ka monitorime).
- Mars 2023-qershor 2023, nuk ka foto në raport gjatë monitorimeve, nuk ka PDF e transfertave asnjëra, nuk lexohen dokumentat e transferimit dhe as sasia në CD (error).
- Qershor 2023-shtator 2023, deklaroi sërish se nuk ka pasur aktivitet, në fazë remonti (nuk ka monitorime).
- Shtator 2023-dhjetor 2023, deklaroi se nuk ka pasur aktivitet, (nuk ka monitorime).

Rezulton se nuk ka asnjë dokument transferimi për këtë periudhë, asnjë sasi mbetje të deklaruar dhe asnjë kontratë me operator të licencuar fundor.

3. Raportimet 3 mujore 2023-2024

- Dhjetor 2023-mars 2024, deklaroi se nuk ka pasur aktivitet, në fazë remonti (foto të furrës së bllokuar), dokumenti i transferimit bosh.
- Mars 2024-qershor 2024, raport vetëmonitorimi nga 2 studio “Alpha” dhe “Swot”. Sërish deklaroi se nuk ka mbetje të gjeneruara pasi ka punuar me intesitet të ulët (30 ditë total), dokumenti i transferimit bosh.
- Qershor 2024-shtator 2024, deklaroi se nuk ka pasur aktivitet, sërish në fazë remonti.
- Shtator 2024-dhjetor 2024, raport vetëmonitorimi me “Alpha” studio. Mbetje të trajtuara nga Alliance me kod 100208=820 ton. Mbetje të gjeneruara kod 100501=320 ton, që do të thotë trajtohen më tej me operator të licencuar. Por në raportime nuk ka të dhëna për kontratat të lidhura me operator për trajtimin e mbetjeve tratë dhe as ndonjë dokument transferimi.

Në faqen nr.32 (7/16) deklaroi se i ka marrë nga Kurum me kodin 100208, ndërkohë me Kurum ka kontratë për mbetje të rrezikshme me kodin 100207*. Nuk rezultoi dokumenti i

transferimit. Nga procesi teknologjik është prodhuar edhe 350 ton koncentrat zinku dhe 150 ton humbje nga delagështimi i materialit. Mungojnë raportimet për menaxhimin e këtyre sasive.

4. Raportimet 3 mujore 2024-2025

- Dhjetor 2024-mars 2025, konstatohen të njëjtat problematike si në raportimin për shtator

Nga analiza e kontratave, dokumentacionit financiar, regjistrave mjedisorë dhe deklarimeve doganore rezulton se shoqëria “Alliance Resource” sh.p.k ka marrë nga “Kurum International” Sh.a mbetje të rrezikshme me kod 10 02 07* (mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme), të cilat, në kundërshtim me objektin e kontratave dhe detyrimet ligjore, nuk janë trajtuar si mbetje, por janë faturuar, magazinuar dhe tregtuar si produkt “oksid zinku”, duke u eksportuar në tregje të huaja.

Konstatohet mospërputhje e rëndë deklarimesh midis palëve lidhur me klasifikimin e mbetjeve (10 02 07*), si dhe mospërputhje sasishë midis regjistrave të transfertave, faturimit dhe deklaratave doganore, çka cënon rëndë parimin e gjurmueshmërisë së mbetjeve të rrezikshme. Shoqëria Alliance Resource sh.p.k. nuk ka provuar ekzistencën dhe funksionimin real të kapaciteteve teknike për trajtimin e këtyre mbetjeve, përfshirë:

- menaxhimin e skorieve pas procesit,
- trajtimin dhe shkarkimin e ujërave teknologjike,
- posedimin e lejeve përkatëse për përdorimin dhe shkarkimin e ujërave.

-Në këto kushte, rezulton se mbetjet e rrezikshme janë maskuar si lëndë e parë/produkt, janë futur në qarkullim tregtar dhe janë eksportuar, pa u trajtuar sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi.


-Këto veprime përbëjnë shkelje të drejtpërdrejtë të pikave 1, 3, 4 dhe 5 të nenit 23 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe krijojnë indicie për shmangie të detyrimeve mjedisore dhe keqdeklarim të natyrës së mbetjeve.

-Për periudhën qershor 2023 – shtator 2023 Alliance Resource sh.a. ka deklaruar se nuk ka pasur aktivitet pasi ka qene në fazë remonti, ndërkohë rezulton të ketë eksportuar një sasi prej 122,846.00 kg oksid zinku, peroksid zinku.

Për periudhën shtator 2023 – dhjetor 2023, Alliance Resource sh.a. ka deklaruar se nuk ka pasur aktivitet dhe nuk ka raporte vetëmonitorimi, ndërkohë rezulton të ketë eksportuar sasinë prej 220,776.00 kg oksid zinku, peroksid zinku:

-Për periudhat dhjetor 2023 – mars 2024, mars 2024 – qershor 2024 dhe qershor 2024 – shtator 2024, Alliance Resource sh.a. ka deklaruar se nuk ka pasur aktivitet tre mujorin e parë dhe të tretë, ka qene në fazë remonti dhe për tre mujorin e dytë ka punuar me intensitet të ulët (30 ditë total). Por pavarësisht se deklararon se nuk ka mbetje të gjeneruara ose të pranuar, ndërkohë rezultojnë faturat e mëposhtme të shitjes:

- Nr.1 datë 20.02.2024 me përshkrim malli Oksid zinku, në sasinë 114.842 ton, në vlerën 80389.41 USD;
- Nr.2 datë 08.04.2024 me përshkrim malli Oksid zinku, në sasinë 79.92 ton, në vlerën 55944 USD;
- Nr.3 datë 08.05.2024 me përshkrim malli Oksid zinku, në sasinë 102.51 ton, në vlerën 76882.50 USD;



- Nr.4 datë 05.07.2024 me përshkrim malli Oksid zinku, në sasinë 56.11 ton, në vlerën 53304.51 USD;
- Nr.5 datë 31.08.2024 me përshkrim malli Oksid zinku, në sasinë 125.94 ton, në vlerën 0.00 USD (fatura nuk shfaqet te tatime.gov.al);
- Nr.6 datë 31.08.2024 me përshkrim malli Oksid zinku, në sasinë 125.94 ton, në vlerën 107049 USD;
- Nr.7 datë 31.08.2024 me përshkrim malli Oksid zinku, në sasinë -125.94 ton, në vlerën 0.00 USD;

Përsa më sipër, nga Alliance Resource edhe pse raporton pranë AKM-së se nuk ka aktivitet, ka vazhduar eksportin e oksidit të zinkut si product dhe jo si mbetje.

-Për periudhën qershor 2024 – shtator 2024 Alliance Resource sh.a. ka deklaruar se nuk ka pasur aktivitet pasi ka qene në fazë remonti, ndërkohë që I ka blerë Kurum sasinë prej 500.000 kg oksid zinku.

Rezulton se ka disakordancë të deklarimeve të tre mujorëve detyrim sipas lejes së tipit a dhe të sasive nëpër faturat e shitjes si më sipër.

Nga shtojca 1 “Formati i regjistrimit të transfertave individuale të mbetjeve të rrezikshme” “Pluhur nga sistemi pluhur kapës” (“Mbetje të ngurta nga trajtimi i gazeve, që përmbajnë substance të rrezikshme”), të raportuar nga shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, rezulton se për vitin 2023 ka deklaruar për marrësin shoqërinë “Alliance Resource” sh.p.k, dorëzimin e kodit të mbetjes sipas katalogut Shqiptar të mbetjeve 10 02 07*. Gjatë intervalit kohor 03.07.2023-21.07.2023 një sasi **Sasia totale 8611 ton**. Në këtë periudhë Alliance deklaroi se nuk ka pasur aktivitet, ka qenë në fazë remonti dhe nuk deklaroi asnjë mbetje të gjeneruar ose të pranuar.

Ndërsa, nga shtojca 1 “Formati i regjistrimit të transfertave individuale të mbetjeve të rrezikshme” “Mbetje të ngurta nga trajtimi i gazeve, që përmbajnë substance të rrezikshme”, të raportuar nga shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, rezulton se për vitin 2024 ka deklaruar për marrësin shoqërinë “Alliance Resource” sh.p.k. dorëzimin e kodit të mbetjes sipas katalogut Shqiptar të mbetjeve 10 02 07* gjatë intervalit kohor 13.05.2024-17.05.2024 një sasi prej 2000 ton.

Rezulton se, kur është kryer inspektimi nga AKM në muajin gusht 2024 (pasi në media u publikua dyshimi se ishin eksportuar mbetje të rrezikshme me origjinë shoqërinë Kurum) Alliance nuk ka vendosur në dispozicion as kontratën me Kurum dhe as ndonjë dokument mbi mënyrën e transportimit apo dorëzimit të kësaj sasive mbetje të rrezikshme, dhe as destinacionin fundor të kësaj sasive.

Bazuar në dokumentacionin e inspektimit të AKM lidhur me veprimtarinë e kësaj shoqërie lidhur me mbetjet e blera nga Kurum International sha, rezulton se më datë 29.08.2024 AKM ka kryer inspektim pranë Alliance Resource shpk. Inspektimi është kryer menjëherë pasi është dhënë njoftimi edhe në media mbi shkeljet ligjore në fushën e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme. Bazuar në procesverbalin e datës 29.08.2024 AKM ka evidentuar shkeljet si vijon:

-Subjekti nuk na paraqiti dokumentet e transferimit për mbetje jo të rrezikshme të gjeneruara nga procesi teknologjik që disponon.



-Subjekti nuk na paraqiti dokumentet e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme të marra nga subjekti Kurum International sha.

Kushtet për transferimin dhe dorëzimin e mbetjeve janë të përcaktuara në Lejen e Mjedisit të lëshuar për këtë shoqëri, e cila nuk e ka zbatuar.

Për rrjedhojë, ky subjekt ka kryer shkelje në menaxhimin e mbetjeve pasi përvec faktit që nuk ka disponuar dokumentacionin, sasia e mbetjeve është gjendur në stok, ndërkohë që subjekti marrës i mbetjes së rrezikshme ka detyrën e trajtimit të tyre dhe jo të magazinonjë sasi të mëdha mbetjesh duke i lënë të patrajuara duke shtuar efektet e rrezikut të lëshimit të gazrave toksikë në mjedis e në ajër.

Po kështu, Alliance nuk ka paraqitur dokumentacion provues se çfarë ka ndodhur me këto mbetje, si janë trajtuar, nëse janë transportuar a shitur tek të tretë, apo janë eksportuar, duke shtuar dyshimet se shoqëria Kurum në bashkëpunim me të tretët dhe në rastin konkret edhe me shoqërinë Alliance shpk ka shkelur legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve duke i transferuar mbetjet tek të tretët në sasi shumë të mëdha, me kosto të ulët për të shmangur kostot e asgjësimit. Po kështu, Kurum nuk ka ndjekur në vijmësi (mbikëqyrë) si prodhuesi i mbetjeve deri në procesin fundor se ku kanë përfunduar këto mbetje e si janë trajtuar.

Krahas mospërputhjeve të të dhënave që Kurum raporton si përsa I përket sasisve dhe kodit të mbetjeve, Kurum ka shitur mbetje të rrezikshme tek shoqëria "Alliance Resource" sh.p.k. e cila nuk disponon kushtet e nevojshme për trajtimin e këtyre mbetjeve. Po kështu, sasisë e shitura nga Kurum janë mbetje të rrezikshme në sasi shumë të mëdha, për të cilat Alliance nuk ka kapaciteti të menaxhojë.

Alliance Resource deklaroi se i trajton këto mbetje sipas shtojcës 2 të ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar përmes operacionit R4 riciklim/ripërtëritja e metaleve dhe komponimeve të tyre. Ndërkohë që këto mbetje të cilat janë të rrezikshme nuk mund të riciklohen njësoj si mbetjet që prodhohen pas procesit të prodhimit, pasi janë mbetje toksike.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 1, 3, 4 dhe 5 të nenit 23¹, nenit 25², nenit 26³ të ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, ku

¹ Neni 23 i ligjit për menaxhimin e mbetjeve -Kontrolli i mbetjeve të rrezikshme

1. Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në përputhje me këtë ligj. Këto kushte përfshijnë masat që sigurojnë gjurmueshmërinë e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre, si dhe kontrollin e mbetjeve të rrezikshme, me qëllim plotësimin e kërkesave të këtij ligji.

3. Leja e mjedisit për personat fizikë a juridikë, që krijojnë, grumbullojnë, transportojnë, magazinonjë apo trajtojnë mbetje të rrezikshme, përcakton kushtet që duhen përmbushur për të siguruar zbatimin e pikës 1 të këtij neni dhe përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

4. Transporti i mbetjeve të rrezikshme bëhet vetëm me mjete që:

a) janë të përshtatshme për tipin dhe sasinë e mbetjeve të rrezikshme që transportohen;
b) janë në përputhje me standardet rrugore;
c) plotësojnë të gjitha kërkesat përkatëse të ADR-së;
ç) janë regjistruar paraprakisht për këtë qëllim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

përcaktohet se krijuesi ka detyrimin të sigurojë gjurmushmërinë e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre, të sigurojë që blerësi të ketë lejen përkatëse për trajtimin apo asgjësimin e mbetjeve.

Lidhur me subjektin Bajrami N dhe personin fizik "Petrë Qosja":

Në hetim të sasisë së mbetjeve të rrezikshme që prodhon shoqëria Kurum dhe destinacionin e tyre, janë administruar kontratat e lidhura me shoqërinë Bajrami N shpk me administrator Nazif Bajrami në cilësinë e menaxhuesit të licencuar dhe personit fizik Petrë Qosja.

1. Kontratë me subjektin BAJRAMI N sh.p.k. për shitjen e mbetjeve me kodet 10 02 01; 10 02 02

Në datë 01.10.2021 është lidhur kontratë "Për menaxhimin e mbetjeve jo të rrezikshme" "Skorje e papërpunuar dhe skorje e përpunuar midis shoqërisë "Kurum Internacional" sh.a me NIPT K02727230T me administrator Erdal Demir, i përfaqësuar me prokurë nga Yusuf Sezai Kurum dhe Shkalla, në cilësinë e krijuesit të mbetjeve dhe shoqërisë "**Bajrami N**" sh.p.k me NIPT K02727202O me administrator **Nazif Bajrami** në cilësinë e menaxhuesit të licencuar dhe personit fizik "**Petrë Qosja**" me NIPT K73029205N në cilësinë e tregtarit të mbetjeve.

Në këtë kontratë në lidhje me personin fizik "Petrë Qosja" citohet se, në vijim të kësaj kontrate do të quhet tregtar i mbetjeve me NUIS: K73029205N, licencë LN-7003-11-2013, datë 11.11.2013, për "Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë e me qira".

Objekti i kontratës konsiston në dorëzimin e mbetjeve skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar, nga ana e krijuesit të mbetjeve për depozitim dhe trajtim nga ana e menaxhuesit të licencuar, pas grumbullimit të tyre në terrenin e stoqeve në kompleksin e "Kurum Internacional" sh.a, Elbasan.

5. Transporti i mbetjeve të rrezikshme bëhet në përputhje të plotë me çdo akt tjetër në fuqi për transportin e produkteve të rrezikshme.

² Neni 25 - Etiketimi i mbetjeve të rrezikshme

1. Mbetjet e rrezikshme grumbullohen, transportohen dhe magazinohen në mënyrë të përkohshme vetëm kur ato janë ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me këtë ligj.

³ Neni 26 - Dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme

1. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik të një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike.

2. Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e dokumentit të dorëzimit;

b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;

c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;

ç) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);

d) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;

dh) përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasi të respektive;

e) hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrime të tyre.

3. Marrësi në dorëzim, brenda 30 ditëve, i dërgon dorëzuesit një konfirmim me shkrim për marrjen e mbetjeve të rrezikshme.

5. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme, ruan dokumentacionin e transferimit për një kohë prej të paktën 3 vjetësh nga data kur fillon dorëzimi dhe ua vë ato në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, pas paraqitjes së kërkesës së tyre me shkrim.

Kodi i këtyre mallrave është 100201- mbetje nga përpunimi i skorjeve dhe 100202 skorje e papërpunuar. Kjo kontratë është e vlefshme deri me datë 01.10.2022.

Menaxhuesi i licencuar zotohet se prej marrjes së mbetjeve objekt kontrate do t'i trajtojë pranë impjantit të tij për prodhim betoni dhe për shtrim rrugësh si stabilizant. Sipas kësaj kontrate, menaxhuesi i licencuar të jetë i pajisur me Leje Mjedisi për aktivitetin që ushtron, të zbatojë rregulloren e mjedisit si dhe të ndjekë legjislacionin e sigurimit të shëndetit në punë deri në depozitim dhe trajtimin /riciklimin e mbetjeve objekt kontrate pas marrjes së tyre nga kompleksi i Kurum International sh.a, Elbasan. Menaxhuesi i licencuar të sigurojë lëvrin e mbetjeve objekt kontrate në mënyrë të tillë që të mos i derdhë ato në mjedis apo të mos e dëmtojë mjedisin gjatë marrjes së tyre.

Krijuesi i mbetjeve merr përsipër ngarkimin e mallit me mjetet e veta si dhe peshimin në peshoren elektronike, përfshirë edhe transportimin e mbetjeve objekt kontrate deri në adresën e Menaxhuesit të licencuar. Krijuesi i mbetjeve është i pajisur me Licencë Nr.416 Dt.12.10.2020 të kategorisë III 2 B “Për Grumbullim Transportim i Mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme” dhe me Kod Unik KM10170.

Sasia e lëvruar e mallit objekt kontrate faturohet nga ana e agentit të mbetjeve (subjektit Petrit Qosja) kundrejt çmimit 1 euro / ton + TVSH për llogari të krijuesit të mbetjeve (Kurum International sh.a).

2. Në datë 04.01.2023 është lidhur kontratë “Për menaxhimin e mbetjeve jo të rrezikshme”

“Skorje e papërpunuar dhe skorje e përpunuar” midis shoqërisë “Kurum Internacional” sh.a me NIPT K02727230T me administrator Erdal Demir në cilësinë e krijuesit të mbetjeve dhe shoqërisë “Bajrami N” sh.p.k me NIPT K02727202O me administrator Andon Prifti në cilësinë e menaxhuesit të licencuar dhe personit fizik “Petrit Qosja” me NIPT K73029205N në cilësinë e tregtarit të mbetjeve.

Në këtë kontratë në lidhje me personin fizik “Petrit Qosja” citohet se, në vijim të kësaj kontrate do të quhet tregtar i mbetjeve me NUIS:K73029205N, licencë LN-7003-11-2013, datë 11.11.2013, për “Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë e me qira”.

Objekti i kontratës konsiston në dorëzimin e mbetjeve skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar, nga ana e krijuesit të mbetjeve për depozitim dhe trajtim nga ana e menaxhuesit të licencuar, pas grumbullimit të tyre në terrenin e stokeve në kompleksin e “Kurum International” sh.a, Elbasan.

Kodi i këtyre mallrave është 100201- mbetje nga përpunimi i skorjeve dhe 100202 skorje e papërpunuar.

Kjo kontratë është e vlefshme deri me datë 04.01.2024.

Menaxhuesi i licencuar zotohet se prej marrjes së mbetjeve objekt kontrate do t'i trajtojë pranë impjantit të tij për prodhim betoni dhe për shtrim rrugësh si stabilizant.

Sipas kësaj kontrate, menaxhuesi i licencuar të jetë i pajisur me Leje Mjedisi për aktivitetin që ushtron, të zbatojë rregulloren e mjedisit si dhe të ndjekë legjislacionin e sigurimit të shëndetit në punë deri në depozitim dhe trajtimin /riciklimin e mbetjeve objekt kontrate pas marrjes së tyre nga kompleksi i Kurum International sh.a, Elbasan.

Menaxhuesi i licencuar të sigurojë lëvrin e mbetjeve objekt kontrate në mënyrë të tillë që të mos i derdhë ato në mjedis apo të mos e dëmtojë mjedisin gjatë marrjes së tyre.



Krijuesi i mbetjeve merr përsipër ngarkimin e mallit me mjetet e veta si dhe peshimin në peshoren elektronike, përfshirë edhe transportimin e mbetjeve objekt kontrate deri në adresën e Menaxhuesit të licencuar. Krijuesi i mbetjeve është i pajisur me Licencë Nr.416 Dt.12.10.2020 të kategorisë III 2 B “Për Grumbullim Transportim i Mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme” dhe me Kod Unik KM10170.

Sasia e lëvruar e mallit objekt kontrate faturohet nga ana e agentit të mbetjeve (subjektit Petrit Qosja) **kundrejt çmimit 1 euro / ton + TVSH** për llogri të krijuesit të mbetjeve (Kurum International sh.a).

Subjekti BAJRAMI N sh.p.k. disponon lejet si më poshtë:

-Leje Mjedisit Tipi B, PN7008-08-2018;

-Leje Mjedisit Tipi B, PN-9415-02-2015;

-Leje Mjedisit Tipi B, PN-6671-12-2013.

BAJRAMI N nuk disponon leje për përpunimin/trajtimin e skorjeve, por vetëm lejet e sipërpërmendura. Asnjë nga kodet 10 02 01 apo 10 02 02 nuk përmbahet në lejet e tij mjedisore.

Nga shtojca 1 “Formati i regjistrit të transfertave individuale të mbetjeve jo të rrezikshme” “Skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar”, të raportuar nga shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, rezulton se për vitin 2022 ka deklaruar për marrësin personin fizik “Petrit Qosja” dhe shoqërinë “Bajrami N” sh.p.k, të dhënat si më poshtë:

-Mbetje jo të rrezikshme,

- Skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar,
- Kod të mbetjes sipas katalogut Shqiptar të mbetjeve 100201 dhe 100202,
- Intervali kohor 16.11.2021-25.03.2022,
- Numra regjistri të automjeteve: Nuk rezultojnë targat që ka deklaruar shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në deklarime gjatë hetimit,
- Sasia totale 15996 ton.

-Mbetje jo të rrezikshme,

- Skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar,
- Kod të mbetjes sipas katalogut Shqiptar të mbetjeve 100201 dhe 100202,
- Intervali kohor 18.05.2022-24.09.2022,
- Numra regjistri të automjeteve: AA 006 AT,
- Sasia totale 16263 ton.

Nga shtojca 1 “Formati i regjistrit të transfertave individuale të mbetjeve jo të rrezikshme” “Skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar”, të raportuar nga shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, rezulton se për vitin 2023 ka deklaruar për marrësin personin fizik “Petrit Qosja” dhe shoqërinë “Bajrami N” sh.p.k, të dhënat si më poshtë:

- Mbetje jo të rrezikshme,
- Skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar,
- Kod të mbetjes sipas katalogut Shqiptar të mbetjeve 100201 dhe 100202,
- Intervali kohor 16.02.2023-12.05.2023,
- Numra regjistri të automjeteve: Nuk rezultojnë targat që ka deklaruar shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në deklarime gjatë hetimit,

- Sasia totale 10359 ton.

Nga shtojca 1 “Formati i regjistrimit të transfertave individuale të mbetjeve jo të rrezikshme” “Skorje e përpunuar dhe skorje e papërpunuar”, të raportuar nga shoqëria “Kurum International sh.a” sh.a në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, rezulton se për vitin 2022 dhe 2023 ka deklaruar për marrësin personin fizik “Petrin Qosja” dhe shoqërinë “Bajrami N” sh.p.k, se i ka **shitur 15996 ton mbetje, 16253 ton mbetje dhe 10359 ton mbetje.**

Ndërkohë, nga verifikimet rezulton se shoqëria “Bajrami N” sh.p.k me NUIS K027272020 ka lidhur kontratë me shoqërinë “Kurum International sh.a” sh.a, për kodet 100201 dhe 100202, por shoqëria “Bajrami N” sh.p.k **nuk disponon leje për përpunimin/trajtimin e skorjeve, por vetëm lejet e mjedisit të tipit “B” pn-7008-08-2018, pn-9415-0202015 dhe pn-6671-12-2013. Asnjëri prej kodeve 100201 dhe 100202 nuk përfshihet në lejet mjedisore të kësaj shoqërie.**

Nga të dhënat e administruara nuk ka asnjë informacion se çfarë procesi pune ka ndodhur, ku janë depozituar këto mbetje, dhe si janë trajtuar pasi nuk ka asnjë regjistrim të deklaruar mbi to.

Rezulton se në kontratën e lartpërmendur është dhe një palë e tretë që shërben si tregtar i mbetjeve dhe transportues i licencuar për transport mallrash ndërkombëtar, që është personi fizik “Petrin Qosja” me NUIS K73029205N. Në akte rezulton numri i licencës LN-7003-11-2013 “Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe qira”, por nga verifikimi në QKB rezulton se kjo licencë është në emër të personit fizik Elton Doka me NUIS K82810206S.

Sa më sipër, Kurum interantional ka shitur mijëra ton mbetje tek një shoqëri e cila nuk ka licencë për ti menaxhuar këto mbetje, dhe kjo shoqëri në bashkëpunim me një person fizik ka marrë përsipër të kryejë transport dhe menaxhim të mbetjeve pa pasur leje mjedisi për të kryer këtë aktivitet dhe pa pasur kapacitet e nevojshme.

Personi fizik Petrin Qosja rezulton të mos ketë as licencë për transport të mallrave të zakonshëm, ndërkohë që për transport të mbetjeve duhet leje e posaçme nga Ministria e Mjedisit. Nuk disponohet asnjë formular, “Formati i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, sipas vendim nr.229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 1, 6 dhe 9 të nenit 21 të ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

Lidhur me subjektin “EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO)”:

Në funksion të këtij procedimi penal u administrua dokumentacion dhe nga EMS në lidhje me kontratat e lidhura me GS Minerals d.o.o., nga i cili rezulton se:

Sipas ekstraktit historik të shoqërisë “EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO)” sh.p.k., printuar në datë 18.12.2025 rezulton se, ky subjekt është regjistruar në datë 04.06.2013, me datë themelimi 03.06.2013, me zyrë qendrore në Durrës, lagjia 13, Porti i Durrësit, Terminali Lindor, Hyrja nr.5, 2001, me objekt veprimtarie: Menaxhimi, operimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik dhe adaptimi i Terminali Lindor në Portin e Durrësit sipas marrëveshjes koncensionare të lidhur me Qeverinë Shqiptare. Operimi i Terminalit do të përfshijë, pa u kufizuar vetëm në to, ngarkimin dhe shkarkimin kryesisht të anijeve me ngarkesa rifuxho si ato të mineraleve

dhe qymyrit dhe të materialeve të tjera rifuxho, por edhe në anijeve me ngarkesa të përgjithshme/gjenerale dhe për ngarkesa për projekte, sipas rastit. Shërbimet që do të ofrohen do të përfshijnë gjithashtu edhe aktivitetet e lidhura me to, me anijet dhe ngarkesa, të tilla si përpunimi i ngarkesave, lëvizja e ngarkesave në anije dhe lidhja e tyre, depozitimi dhe magazinimi i ngarkesave, asemblimi i mallrave, mbushja dhe zbrazja e konteinerëve, lëvizje ekstra dhe sistemime, transportin, spontimi, marrjen dhe shpërndarjen.

Administrator i shoqërisë ka qenë Z. Manfred Muller prej datës 03.06.2013 deri në datë 04.06.2023. Sipas historikut rezulton se është emëruar administrator i shoqërisë Z. Ingo Hesse prej datës 03.05.2023 deri në datë 03.05.2028, si dhe është larguar administratori Manfred Muller.

Sipas historikut rezulton se është emëruar administrator i shoqërisë Z. Florian Çimo prej datës 31.07.2024 deri në datë 30.07.2027, si dhe është larguar administratori Ingo Hesse.

Më datë 06.05.2013, **Ministria e Punëve Publike dhe Transportit** ka lidhur kontratë koncensionit me shoqërinë **“EMS Shipping&Traiding GmbH (EMS ose Konkensionari)”** kompani me përgjegjësi të kufizuar themeluar sipas ligjeve të Republikës Gjermane, regjistruar në Gjermani në 1986, për dhënien në koncesion menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit.

Objekti i koncensionit është: Menaxhimi, operimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik dhe adaptimi për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin Lindor Durrës. Operimi i terminalit do të përfshijë ngarkimin dhe shkarkimin kryesisht të anijeve me ngarkesë rifuxho, minerale qymyri, etj, por edhe të anijve me ngarkesa të përgjithshme/gjenerale dhe për ngarkesa për projekte, sipas rastit. Përsa i përket përpunimit të ngarkesave rifuxho operatori do të bëjë të gjitha përpjekjet për të arritur një shkallë të lartë specializimi me qëllim rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostove për njësi. Shërbimet që do të ofrohen do të përfshijnë gjithashtu edhe aktivitetet e lidhura me to, me anijet dhe ngarkesa të tilla si përpunimi i ngarkesave, depozitimi, magazinimi, lëvizje ekstra, transportin, spontimi, marrjen dhe shpërndarjen dhe përfshirë marrjen e masave për burimet e kërkuara në infrastrukturë, mjete, pajisje, sisteme, praktika, procedura, programe, organizim dhe burime njerëzore në përputhje me praktikën më të mira industriale dhe siç janë të specifikuar në Termat e Referencës (TeR).

Periudha e koncensionit është 35 vite.

Në këtë kontratë është cilësuar se, Autoriteti Portual Durrës ose APD është personi juridik i cili përfaqëson interesin publik të Portit të Durrësit, i krijuar sipas ligjit nr.9310, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe riorganizimin e tij”.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me Akt Miratimin Leje Mjedisit Tipi B, nr.5945 prot., datë 29.07.2022, nr. i identifikimit të Lejes 4154 K.Nr.97, ka dhënë mendimin për miratimin e lejes, subjektit “EMS Albanian Port Operator (EMS APO) me NUIS L31804506A, me adresë Durrës, Porti i Durrësit, Terminali Lindor, Hyrja nr.5. Kjo leje i është miratuar këtij subjekti.

Veprimtaria e përcaktuar në këtë leje është: Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe dhe magazinimi i hekurishteve/skraveve të metalit që **nuk përmbajnë material të rrezikshëm.**

Në pikën 1.4 të kësaj leje përcaktohet se: Kjo leje jepet me qëllim parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes në përputhje me Ligjin Nr.53/2020, datë 30.04.2020 për disa ndryshime në ligjin

Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” të ndryshuar dhe legjislacionin mjedisor në fuqi dhe nuk e përjashton mbajtësin e kësaj Leje nga detyrimet që rrjedhin nga ligjet e tjera në fuqi. Ndërmjet qiradhënësit Shoqërisë “**EMS Albanian Port Operator**” (**EMS APO**) sh.p.k. me NIPT L318045506A, me përfaqësues Florian Cimo dhe qiramarrësit Shoqërisë “**GS MINERALS d.o.o**” kroate me NIPT OBI61130788157, me administrator Gjovana Sokolaj janë lidhur kontrat qiraje për oksid zinku (të përshkruara më sipër).

Rezulton se me datë 10.07.2024, nga adresa e e-mailit (eko studio) është dërguar e-mail te adresa gazmend@ems-apo.com (Gazmend Sina), me subjekt: Raportet mjedisore! Nga përmbajtja e këtij e-maili rezulton se, gazmend@ems-apo.com është njoftuar që ka ardhur periudha për hartimin e raporteve mjedisore vjetore dhe e vetëmonitorimit për periudhën janar-korrik 2024 për subjektin “EMS Albanian Port Operator” sh.p.k, sasinë e mbetjeve të gjeneruara për këtë periudhë. Në këtë e-mail shkruhet që: bashkëlidhur do të gjeni regjistrin e mbetjeve dhe autorizimin ku ju autorizoni Eko-Studio-Projekt për mostrimin, hartimin dhe dorëzimin e dokumentave në AKM, sipas urdhërit nr.92 datë 02.05.2022, ju lutem të na e dërgoni sërish të firmosur dhe të vulosur.

Në vijim, me datë 12.07.2024 nga adresa e e-mailit gazmend@ems-apo.com (Gazmend Sina) është dërguar e-mail te adresa “Eko studio” dhe në Cc: “Florian Cimo”, me subjekt: Raportet mjedisore!. Nga printimi i këtij e-maili te rubrika “Attachments” rezulton përshkrimi “EMS APO-Regjistër mbetjesh 07.24.docx; Matjet Mjedisore 12.23-6.24.pdf.

Nga përmbajtja e këtij e-maili rezulton se ngarkesat e përpunuara 01.01.2024-30.06.2024, subjekt i lejes mjedisore eksport janë:

- Krom me anije+ me konteinerë;
- **koncentrate/zink rifuxho+ me konteinerë-2969 ton;**
- skrap rifuxho;
- Çimento përpunim me cikël të mbyllur autobot-anije;

Nga përmbajtja e këtij e-maili rezulton edhe se Eko-studios i është kërkuar mendim në lidhje me raportet e matjeve që ka realizuar Autoriteti Portual Durrës për periudhën 12/23-06/24, të cilat i ka bashkëlidhur në e-mail.

Me autorizimin nr.61 prot datë 10.07.2024 të administratorit të shoqërisë “EMS Albanian Port Operator” sh.p.k Z.Ingo Hesse, është autorizuar shoqëria “Eko-Studio-Projekt” sh.p.k, e regjistruar në QKR me numër NIPT: L03614803Q dhe në QKL me licensë profesionale me numër LN-2652-01-2011, e pajisur me laborator të akredituar nfa DPA me numër regjistrimi LT 070 për kryerjen e të gjitha veprimeve proceduriale për kampionim, testim dhe analizim të mostrave si dhe për hartimin dhe dorëzimin e të gjitha dokumentave në zbatim të kushteve të Lejes së Mjedisit dhe konform Urdhërit nr.92 datë 02.05.2024 të drejtorit të AKM, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Sipas lejes EMS APO duhet të bëjë cdo 6 muaj vetëdeklarim pranë AKM, në lidhje me perjudhën kohore 01.01.2024 deri më 31.06.2024 EMS APO i ka dërguar Eko Albania tabelën e ngarkesave të përpunuara nga ata, ku ndër të tjera vihet re se është përpunuar mbetja “Koncentrate/zink rifuxho me kontenier”, që sipas lejes së mjedisit kjo lëndë nuk është e përfshirë.

Në raportet e menaxhimit të mbetjeve të EMS APO, të hartuar nga “Eko-Studio-Projekt” sh.p.k. me administrator Shkëlzen Madani, konstatohet se te rubrika “Rikuperimi/asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme”, sasia mesatare për muaj nuk është deklaruar.



Nga dokumentacioni i administruar nga Autoriteti Portual Durrës, rezulton se në raportet 3-mujore që janë bërë nga Njësia e Mjedisit të këtij institucioni për shoqërinë EMS APO, përfaqësuar nga inspektorët Xhulio Golgota dhe Iva Musa fundit ka nënshkruar dhe punonjësi i EMS APO, shtetasi Gazmend Sina, i cili ka qenë në dijeni të eksportit të bërë nga shoqëria "Sokolaj" (GS Minerals Doo), ku nëpërmjet e-mailit të datës 12.07.2024 ia ka dërguar të dhënat për vetëmonitorim shoqërisë "Eko-Studio-Projekt" sh.p.k, ndër to dhe **koncentrate/zink rifuxho+ me konteinerë-2969 ton**, por në raportet 3 mujore të lartpërmenduar nuk rezulton e pasqyruar kjo ngarkesë apo ky produkt dhe as një e dhënë për këtë eksport.

Në raportet mujore për periudhën shtator-dhjetor 2023 e në vijim nuk është raportuar edhe për okidën e zinkut i cili ndodhej në sheshin e depozitimit të EMS sipas kontratës së lidhur me GS Minerals d.o.o. Këta inspektorë të mjedisit kanë qenë pjesë e grupit të punës sipas Urdhërit Nr.904 datw 05.03.2029 "Mbi funksionimin dhe monitorimi e kontratës së koncesionit", për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen e terminalit lindor në Portin e Durrësit", pika 3/a,b, c, d, I ndryshuar me urdhërin Nr.1114 datë 14.04.2020.

Shoqëria EMS APO sh.p.k. me NIPT L318045506A, me administratorë shtetasit **Manfred Muller** dhe **Ingo Hesse** dhe përfaqësues shtetasin **Florian Çimo** është shoqëria koncesionare me objekt të koncesionit menaxhimin, operimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik dhe adaptimin për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin Lindor Durrës, etj.


Rezulton se kjo shoqëri është e pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, por në leje nuk parashikohet që ky subjekt të ketë të drejtë të depozitohet dhe të menaxhojë mbetjen Oksid Zinku pasi kjo mbetje kërkon leje të veçantë sepse është mbetje e rrezikshme dhe mban kodin 10 07 02 * kod të cilin EMS nuk e disponon në përmbajtjen e lejes, si dhe as për Oksid Hekuri dhe Oksid Zinku.

Subjekti EMS APO është i pajisur me Leje Mjedisi Tipi B më datë 29.07.2022 me numër leje 4154 nga ana e Agjencisë Kombëtare e Mjedisit, e miratuar nga Ministri i Mjedisit, ku si objekt veprimtarie ka magazinimin, ngarkimin ose shkarkimin në masë të madhe të çimentos ose të klinkerit të çimentos përpara transportit të tyre në masë të madhe si dhe magazinimin e hekurishteve/skrapeve të metalit **që nuk përmbajnë material të rrezikshëm.**

Bazuar në procesverbalin për këqyrjen e email të shtetasit Ardit Omeri me detyrë drejtor i Njesisë së Mjedisit në Autoritetin Portual Durrës, rezulton se ky shtetas me datë 16.08.2021 ka dërguar e-mail te adresa info@akm.gov.al dhe në cc:Pirro Vengu (drejtor i Autoritetit Portual Durrës) me subjekt të e-mailit : **Dhënie Mendimi mbi aplikimin për pajisje me Leje Mjedisi të Operatorit EMS APO** dhe Attachments: MBI NJOFTIMIN E EMS_APO.pdf .

Me shkresën nr.2819 prot., datë 16.08.2021 të Autoritetit Portual Durrës, i është dërguar dhënie mendimi mbi njoftimin e Operatorit EMS APO pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr.379prot. 376, datë 13.07.2021, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit.

Nëpërmjet kësaj shkrese, Autoriteti Portual Durrës si njohës i mirë i problematikave mjedisore nga operimi i Operatorit EMS APO në terminalin lindor, shpreh mendimin e konsultuar me grupin e monitorimit të Kontratës Koncesionare për çështjet mjedisore si më poshtë :



Për licensimin me lejen mjedisore përkatëse për aktivitetet me ID 3.1.d dhe ID 5.5 shprehin mendim negativ në situatën në të cilën aktualisht operon Operatori pasi ka problematika të tilla si:

- *Mungesa e infrastrukturës automatike me sprucatorë lagës për mospërhapjen e grimcave si (PM 2.5 dhe PM 10) etj,;*
- *Mungesa e impjantit të trajtimit të ujrave të ndotur të cilët përfundojnë në mjedisin detar me ngarkesa të tilla si çimento, mbetje të metaleve etj;*
- *Mungesa e zonimit dhe ndarjes në terminal për çdo tip ngarkese rifuxho që mbërrin duke krijuar problematika me përzierjen e mallrave rifuxho;*
- *Larja e shesheve pas përfundimit të operacioneve të ngarkim shkarkimit nuk kryhet rregullisht;*
- *Mjetet e rënda të cilat hyjnë në terminal nuk lahen pas daljes prej tij duke krijuar ndotje;*
- *Nga përpunimi i këtyre materialeve favorizuar shpesh dhe nga kushtet atmosferike krijohet një ndotje e cila impakton negativisht jo vetëm territorin e portit të Durrësit por edhe banesat e qytetarëve në afërsi të portit.*

Referuar dispozitave ligjore të ligjit Nr.10431, datë 09/06/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjit nr.52/2020 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, ligjit Nr.8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, ligjit Nr.9130, datë 08.09.2003 “Për autoritetin portual”, si dhe detyrimeve kontraktuale të koncensionarit EMS-APO, pika 12.1.1 “Menaxhimi dhe Shfrytëzimi”, nënpike h, shprehen se: **Licensimi i kësaj veprimtarie do të ishte në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara.**

Në vijim, me datë 11.08.2022 shtetasi Ardit Omeri i ka dërguar e-mail shtetasit Pirro Vengu, me subjekt të e-mailit : Informacion mbi perputhshmërinë kontraktuale dhe ligjore të Operatorit EMS APO lidhur me çështjet Mjedisore dhe bashkëlidhur me këtë e-mail “Leja mjedisore EMS 2022 në pdf”. Nëpërmjet këtij e-maili ka vënë në dijeni drejtorin e Autoritetit Portual Durrës Z.Pirro Vengu Si më poshtë: *Duke marrë shkas nga Akt-Miratimi i Lejes Mjedisore të tipit B të koncesionarit EMS-APO lidhur me veprimtaritë e depozitimit të skrapeve të metalit dhe proceseve të ngarkim-shkarkimit të çimentos në terminalin lindor, procesi i aplikimit për Miratimin e Lejes Mjedisore, ka si kërkesë specifike njoftimin e palëve të interesuara (ku APD është palë e interesuar dhe e prekur) për dëgjuesën publike, proces për të cilin APD nuk është njoftuar, por me iniciativën e Njesisë së Mjedisit ka dërguar **MENDIMIN NEGATIV** me shkresën dërguar nga ana e tyre në muajin gusht 2021.*

Lidhur me këtë email të drejtorit të Njesisë së Mjedisit në Autoritetin Portual Durrës, rezulton AKM nuk ka kthyer përgjigje. Ndërkohë që rezulton se nga ARM Durrës ushtruar inspektim pranë shoqërisë EMS-APO dhe ka evidentuar pikërisht shkeljet, të cilat i janë bërë më parë me dije nëpërmjet shkresës dhe emailit të Autoritetit Portual Durrës dhe Drejtorit të Njesisë së Mjedisit të këtij autoriteti.

ARM (Durrës) ka ushtruar inspektim dhe në përfundim të inspektimit ka vendosur sanksionimin me gjobë të shoqërisë EMS – APO për mospërmbyllje të kushteve të lejes mjedisore, dhe ka pezulluar aktivitetin e EMS – APO.



Kjo shoqëri i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesë për anulimin e akteve administrative për shkak se nuk janë nxjerrë nga autoriteti kompetent si dhe kanë kërkuar sigurimin e padisë për heqjen e pezullimit.

Gjykata me vendimin nr.197, datë 08.11.2022 ka pranuar pjesërisht kërkesën për sigurimin e padisë duke hequr pezullimin për ushtrimin e aktivitetit dhe duke lejuar EMS – APO të ushtrojë veprimtarinë në shkelje të lejes së mjedisit pasi inspektimi është kryer në shkelje të rregullave përkatëse.

Gjykata administrative me vendimin nr.1243, të datës 19.04.2024 ka pranuar pjesërisht objektin e padisë duke konstatuar pavlefshmërinë e akteve administrative të nxjerra nga AKR (Durrës).

Nga momenti i miratimit të lejes së mjedisit, deri në dhënien e vendimit të Gjykatës, por edhe më pas, EMS APO ka ushtruar aktivitetin me vetëdijen se ka qenë në shkelje të lejes mjedisore. Fakti që Gjykata ka pranuar kërkesë padinë për çështje kompetence, nuk i heq kësaj shoqërie përgjegjësinë që ka pranuar të grumbullojë e magazinohet mbetje të rrezikshme, duke qenë në dijeni se nuk i përmbush standardet e kërkuara nga vetë leja e mjedisit.

Në çdo rast, leja e mjedisit i është dhënë subjektit EMS APO vetëm për magazinim a grumbullim të hekurishteve e skrapeve që nuk përmbajnë material të rrezikshëm. Që do të thotë, se EMS APO ka pasur detyrimin të krijojë sistem verifikues mbi mallrat që pranon të grumbullohen apo magazinohen në sipërfaqen e administruar prej saj në Portin e Durrësit.

Në rastin objekt hetimi EMS APO ka pranuar në të paktën 4 raste të grumbullojë mbetje të rrezikshme që i përkasin Kodit të katalogut të mbetjeve 10 02 07* pa kryer asnjë lloj verifikimi dhe pa pasur asnjë mekanizëm sigurie për të shmangur efektet e dëmshme në mjedis dhe në shëndet.

Ndërkohë, nga momenti i sigurimit të padisë ku AKM ka qenë palë në proces dhe ka marrë dijeni se masa sanksionuese e inspektimit është kryer në shkelje të ligjit jashtë kompetencës, nuk ka marrë asnjë masë paralelisht për të kryer një inspektim të ri, apo për të propozuar që masën përkatëse ta marrë autoriteti kompetent, qe ne kete rast ka qene Ministri.

EMS APO ka kryer raportin e vetëmonitorimit nëpërmjet një subjekti të licencuar ku ka raportuar edhe mbi sasi të lëndëve që janë eksportuar, grumbulluar apo magazinuar. Në këtë raport mungon raportimi mbi eksportin e oksidit të zinkut, koncentratit të zinkut apo mbetjeve të tjera me përpërje të lartë zinku sic është në rastin konkret mbetja e kodit 10 02 07*.

Lidhur me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka miratuar lejet si më poshtë:

- Shoqërisë “Kurum International” sh.a, i ka miratuar Lejen e Mjedisit tipi “A”, nr.4628 prot., datë 09.07.2023, nr.leje 2375/1, k.nr.77.
- Shoqërisë “EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO)” sh.p.k, i ka miratuar Lejen e Mjedisit tipi “B”, nr.5945 prot., datë 29.07.2022, nr.leje 4154, k.nr.97.
- Shoqërisë “Sokolaj” sh.p.k, i ka miratuar Lejen e Mjedisit tipi “B”, nr.2020 prot., datë 19.03.2024, nr.leje 4665, k.nr.20.

Me shkresën e datës 07.03.2023 subjekti "Sokolaj" i ka drejtuar kërkesë për autorizimin e eksportit të mbetjeve Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar te kjo Ministri me nr.283/1 prot., date 30.03.2023.

Nga kjo shkresë rezulton se, subjekti "Sokolaj" bazuar në kontratën me gjeneruesin e mbetjeve "Kurum International" sh.a, ndër të tjera angazhohet t'i blejë dhe mbetjet me kod 100207* (mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme).

Sasia vjetore e këtyre mbetjeve është 25000 ton/vit për vitin e parë pasi ka stok sasive.

Kjo sasi do të dërgohet deri në përfundimin e kontratës me blerësin 31.12.2029.

Sasia totale parashikohet 50.000 ton deri në 21.12.2029.

Vendi i origjinës së këtyre mbetjeve është Shqipëria, me adresë Elbasan Bradashesh vend i ushtrimit të aktivitetit të gjeneruesit të mbetjeve "Kurum International", ku më pas me mjetin e pajisur me licencën përkatëse për transportin e këtyre mbetjeve (Mbetja nuk është pjesë e Aneksit A të ADR) me targë AAR811 në përdorim të subjektit "Sokolaj" i pajisur me licencë III.2.B për transportin e këtyre mbetjeve, do të transportohen drejt Portit të Durrësit.

Më pas destinacioni me anije kontenierësh është transporti drejt vendit të importit Port Haiphong, Lot C12, Khanh Phu Industrial Zone, Khanh Phu Ward, Yen Khanh District, Ninh Binh Province, Vietnam ku do kryhet shkarkimi i ngarkesës për tu marrë nga porositësi sipas procedurave doganore dhe ligjeve të Tailandës bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.

Paketimi do të bëhet në vendin e origjinës në thasë plastike (Big Bags) të cilët do të futen në kontenier 20 feet për tu transportuar me kamion drejt portit të Durrësit e më pas futen në kontenierët për tu transportuar me anije transporti kontenierësh.

Në këtë praktikë dokumentare të kësaj kërkesë për autorizimin e eksportit rezulton dhe **Licenca e kategorisë III.2.B nr.3732 prot datë 20.04.2022, nr.identifikimi 466, k.nr.44, për subjektin "Sokolaj" sh.p.k** me NUIS K64312403D, me aktivitet të licencuar transport i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme dhe lloji i mbetjeve transport i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Drejtues teknik rezulton shtetasi Elton Elezi.

Sipas kësaj licence subjekti duhet të regjistrojë sasinë e mbetjeve që grumbullon, transporton dhe të dërgojë informacion çdo 6 muaj në AKM-në dhe ARM-në e qarkut përkatës, për mënyrën e zbatimit të kushteve në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe mënyrën e zbatimit të kushteve në Akt Miratimin e licencës. Operatori duhet të pajiset me "Kodin Unik të Transportit" pranë MTM-së.n Licenca është e vlefshme për sa kohë funksionin aktiviteti i licensuar.

Me shkresën nr.18491 prot., datë 04.09.2024 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, lidhur me subjektet "Kurum International" sh.a dhe "Sokolaj" sh.p.k.

Në përgjigje të kësaj shkrese, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr.9305/1 prot., datë 23.09.2024 ka informuar se, bazuar në raportimet e regjistrave të transfertave të mbetjeve pranë AKM-së subjekti "Kurum International" për vitin 2024 ka deklaruar që ka transferuar kodin e mbetjeve 100207* në sasi 1005 ton në subjektin "Alliance Resource".

Ndërkohë, është kërkuar edhe dokumentacioni mbi inspektimin e kryer nga ana e AKM pranë shoqërisë Alliance Resource shpk për të evidentuar sasinë e blerë nga Kurum international sh.a dhe destinacionin e këtyre mbetjeve. Nga të dhënat shkresore rezulton se Alliance Resource sh.p.k është

person juridik i krijuar në vitin 2017 me themelues shtetasen Mbarime Koroci dhe Eën Ming me administrator shtetasin Erdest Nushi.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.455, datë 3.7.2019 "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë metarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënëse, dhe shoqërisë "Alliance Resource", shpk, si qiramarrës, për pasurinë me sipërfaqe tëpërgjithshme 57390 m²" kjo shoqëri ka marrë me qera "Objekti nr. 226 "Depo e Koncentratit të Hekurit" me sipërfaqe të përgjithshme 2655 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 1500 m² dhe sipërfaqe funksionale 1155 m² me nr. pasurie 611, Objekti 1-3G "Vaskat e Betonit. me sipërfaqe të përgjithshme 400 m² nga ku sipërfaqe ndërtimore 400 m² dhe truall 400 m² me nr. pasurie 624 dhe truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 54 335 m², ZK 3965", në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes së Prodhim Çeliqueve, Elbasan".

Adresa e kësaj shoqërie është Ish-Uzina 12, Kombinati Metalurgjik, Depo e Koncentratit, Bradashesh.

Bazuar në dokumentacionin e inspektimit të AKM lidhur me veprimtarinë e kësaj shoqërie lidhur me mbetjet e blera nga Kurum International sha rezulton se më datë 29.08.2024 AKM ka kryer inspektim pranë Alliance Resource shpk. Inspektimi është kryer menjëherë pasi është dhënë njoftimi edhe në media mbi shkeljet ligjore në fushën e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme.

Bazuar në procesverbalin e datës 29.08.2024 AKM ka evidentuar shkeljet si vijon:

-Subjekti nuk na paraqiti dokumentet e transferimit për mbetje jo të rrezikshme të gjeneruara nga procesi teknologjik që disponon.

-Subjekti nuk na paraqiti dokumentet e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme të marra nga subjekti Kurum International sha.

Lidhur me këto dy shkelje, subjekti Alliance është gjobitur me 390.000 Lekë dhe 1.300.000 Lekë. Ndërsa, nëpërmjet vendimit përfundimtar mbi këtë inspektim, në datë 17.09.2024 AKM ka vendosur dënimin përfundimtar 390.000 Lekë dhe ka lënë edhe shënimin për korrigjimin e shkeljeve si vijon:

"-Subjekti te marri masa te menjehershme sa vijon: Mbetjet e dala nga procesi teknologjik ti dergoj ne subjekt te pajisur me lejen dhe lincesen perkatese dhe te plotesoi dokumentat e transferimit sipas VKM ne fuqi. Mbetjet e dala nga procesi teknologjik, si dhe mbetjet qe merren per trajtim ti ruaje/magazinoje ne nje ambient te pershtatshme te pajisur me infrastrukturen e duhur sipas kushteve te percaktuara ne lejen mjedisore. Subjekti per cdo mbetje qe mere per trajtim te plotesoi dokumentat e transferimit sipas vkm ne fuqi dhe te raportoi ne AKM sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ne lejen mjedisore."

Ndërsa, sipas listës së verifikimeve rezulton se inspektorët e AKM kanë evidentuar se:

"Nga inspektimi ne terren u konstatuan mbetje ne stoke ne sasi te konsiderueshme te llojit pluhur i cili sipas deklarimit te perfaqesuesit te subjektit eshte mbetje e ngurta te tipit pluhur e dale nga sistemi pluhur kapeze nga prodhimi i celikut të subjektit Kurum International sha për të cilat na paraqiti kontrate per menaxhimin e mbetjeve te ngurta nga trajtimet e gazave qe permbajne substance te rrezikshme te klasifikuara sipas katalogut shqiptare te mbetjeve me kodin 10 02 07, gjithashtu u konstatuan mbetje te dala nga procesi teknologjik i shoqerise Alliance Resource te cilat



ishin magazinuar ne ambientet e aktivitetit. Subjekti per mbetjet e konstatuara ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit, nuk na vendosi ne dispozicion dokumentat e dorezimit dhe transferimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme dhe rregjistrin per sasine e mbetjeve te ruajtura/magazinuara, transferuara dhe asgjesuara nga operator te licensuara.

Mungesa e dokumentacionit provues mbi trajtimin, dorëzimin, transferimin e mbetjeve është konsideruar në shkelje të ligjit nr. 10463 të datës 22.9.2011 Për menaxhimin e integruar të mbetjeve si dhe **në shkelje të Kushit 8 të lejes mjedisore për menaxhimin e mbetjeve.**

Lidhur me këto shkelje të evidentuara, AKM ka marrë vetëm masën e sanksionit administrativ me gjobë dhe ka dhënë sugjerime. Inspektorët e inspektimit janë punonjësit Përparim Mancellari dhe Junid Tahiraj. Ndërsa vendimi është marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM Arta Dollani.

Nisur nga këto të dhëna, është marrë dokumentacioni shtesë mbi inspektimet e kryara pranë shoqërisë Alliance Resource shpk nga ku rezulton se AKM ka kryer inspektime në këtë shoqëri në 14.12.2021, 2022, 2023 dhe në gusht 2024, si dhe në vitin 2025. Para është kryer 1 inspektim çdo vit.

Në vitin 2021 me objekt inspektimi “Zbatimi i kushteve mjedisore” nuk janë konstatuar shkelje ndërkohë që rezulton se nuk janë plotësuar të gjitha pikat e inspektimit.


Në 18-19.05.2022 është kryer inspektimi i rradhës me objekt “shkarkimet në ajër nga operatorët industrial pranë ish Metalurgjikut Elbasan-Indico nga të tretët”. Në këtë inspektim janë konstatuar një sërë shkeljesh nga ana e Alliances Resource shpk lidhur me menaxhimin e instalimit, mungesën e raportit vjetor, mungesën e planit të përputhshmërisë, mungesën e raportit të monitorimit, mungesën e planit për menaxhimin e mbetjeve, mungesën e dokumentacionit dhe raportimit, mungesën e planeve për cmontim dhe mbyllje të instalimit.

Lidhur me këto shkelje nuk është marrë asnjë masë administrative por i është lënë detyrë subjektit që të dorëzojë dokumentacionin brenda datës 03.06.2022. Në datë 03.06.2022 është marrë vendimi përfundimtar ku është cituar se shkeljet janë korrigjuar brenda afatit.

Në 10.11.2023 kjo shoqëri është inspektuar sërish ku është konstatuar si shkelje mosparaqitja e kontratës me operatorë të licensuar për grumbullim, transportim dhe asgjësim përfundimtar për mbetjet sipas tabelës 8.1.2 “Zgjidhje nga prodhimi parësor dhe dytësor” me nr katalogu 10 05 01. Për këtë shkelje është gjobitur me 100000 Lekë. Në datë 01.12.2023 është njoftuar vendimi përfundimtar ku nuk është caktuar ndaj subjektit sanksion administrativ.

Në datë 15.07.2025 është kryer sërish inspektim pranë këtij subjekti ku nuk janë gjetur shkelje. Lidhur me plotësimin e kushtit të menaxhimit të mbetjeve sipas lejes mjedisore nga ana e inspektorëve është konstatuar se ***“Subjekti ka kontratë me shoqërinë Kurum International sha për menaxhimin e mbetjeve të ngurta për menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga trajtimet e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme. ...”.***

Bazuar në sa më sipër, shoqëria Alliance Resource shpk nuk ka pasqyruar në mënyrë transparente **sasinë që merr nga shoqëria Kurum mbi mbetjet me Kod katalogu 10 02 07*.** Po kështu, AKM në inspektimet e kryera vetë si dhe nëpërmjet ARM (Elbasan) nuk ka kryer vlerësime të plota mbi sasinë që merr kjo shoqëri nga shoqëria Kurum sh.a, pagesat, si dhe kapacitetet e menaxhimit të kësaj lloji mbetje të rrezikshme dhe toksike me Kod 10 02 07*.



Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar me procesverbalin e datës 14.01.2026, nga shtetasi Ardit Omeri me detyrë drejtor i Njesisë së Mjedisit në Autoritetin Portual Durrës, rezultoi se ky shtetas me datë 16.08.2021 ka dërguar e-mail te adresa info@akm.gov.al dhe në cc: Pirro Vengu (drejtor i Autoritetit Portual Durrës) me subjekt të e-mailit: **Dhënie Mendimi mbi aplikimin për pajisje me Leje Mjedisit të Operatorit EMS APO** dhe Attachments: MBI NJOFTIMIN E EMS_APO.pdf.


Në këtë e-mail AKM-së i është bërë me dije se, referuar njoftimit, publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbi procedurën e konsultimit me publikun dhe mendimin e palëve të interesuara, mbi aplikimin për pajisje me Leje Mjedisit të tipit B, të Operatorit Ekonomik, EMS APO, i cili ushtron veprimtarinë në territoret e Autoritetit Portual Durrës, si palë e interesuar shprehin mendimin e institucionit të cilin e gjeni bashkengjitur këtij emaili.

Me shkresën nr.2819 prot., datë 16.08.2021 të Autoritetit Portual Durrës, i është dërguar dhënie mendimi mbi njoftimin e Operatorit EMS APO pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr.379 prot., datë 13.07.2021, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit.

Nëpërmjet kësaj shkrese janë bërë me dije se: referuar njoftimit bërë publik në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi procedurën e aplikimit për pajisje me Leje Mjedisore të operatorit EMS APO për veprimtarinë me ID3.1.d “Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe”, pikën ID 5.5 “Magazinimi i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme” si palë e interesuar dhe monitoruese e Koncesionarit EMS APO, Autoriteti Portual Durrës si njohës i mirë i problematikave mjedisore nga operimi i Operatorit EMS APO në terminalin lindor shpreh mendimin e konsultuar me grupin e monitorimit të Kontratës Koncesionare për çështjet mjedisore si më poshtë:

Për licensimin me lejen mjedisore përkatëse për aktivitetet me ID 3.1.d dhe ID 5.5 shprehin mendim negativ në situatën në të cilën aktualisht operon Operatori pasi ka problematika të tilla si:

- Mungesa e infrastrukturës automatike me sprucatorë lagës për mospërhapjen e grimcave si (PM 2.5 dhe PM 10) etj,;
- Mungesa e impjantit të trajtimit të ujrave të ndotur të cilët përfundojnë në mjedisin detar me ngarkesa të tilla si çimento, mbetje të metaleve etj;
- Mungesa e zonimit dhe ndarjes në terminal për çdo tip ngarkese rifuxho që mbërrin duke krijuar problematika me përzierjen e mallrave rifuxho;
- Larja e shesheve pas përfundimit të operacioneve të ngarkim shkarkimit nuk kryhet rregullisht;
- Mjetet e rënda të cilat hyjnë në terminal nuk lahen pas daljes prej tij duke krijuar ndotje;
- Nga përpunimi i këtyre materialeve favorizuar shpesh dhe nga kushtet atmosferike krijohet një ndotje e cila impakton negativisht jo vetëm territorin e portit të Durrësit por edhe banesat e qytetarëve në afërsi të portit.



Referuar dispozitave ligjore të ligjit Nr.10431, datë 09/06/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjit nr.52/2020 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, ligjit Nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, ligjit Nr.9130, datë 08.09.2003 “Për autoritetin portual”, si dhe detyrimeve kontraktuale të koncesionarit EMS-APO, pika 12.1.1 “Menaxhimi dhe Shfrytëzimi”, nën-pika h, shprehen se: **Licensimi i kësaj veprimtarie do të ishte në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara.**

Në vijim, me datë 11.08.2022 shtetasi Ardit Omeri i ka dërguar e-mail shtetasit Pirro Vengu, me subjekt të e-mailit: Informacion mbi perputhshmërinë kontraktuale dhe ligjore të Operatorit EMS APO lidhur me çështjet Mjedisore dhe bashkëlidhur me këtë e-mail “Leja mjedisore EMS 2022 në pdf”. Nëpërmjet këtij e-maili ka vënë në dijeni drejtorin e Autoritetit Portual Durrës Z.Pirro Vengu Si mëposhtë:

Duke marrë shkas nga Akt-Miratimi i Lejes Mjedisore të tipit B të koncesionarit EMS-APO lidhur me veprimtarinë e depozitimit të skrapeve të metalit dhe proceseve të ngarkim-shkarkimit të çimentos në terminalin lindor, procesi i aplikimit për Miratimin e Lejes Mjedisore, ka si kërkesë specifike njoftimin e palëve të interesuara (ku APD është palë e interesuar dhe e prekur) për dëgjuesën publike, proces për të cilin APD nuk është njoftuar, por me iniciativën e Njesisë së Mjedisit ka dërguar **MENDIMIN NEGATIV** me shkresën dërguar nga ana e tyre në muajin gusht 2021.

Mendimi i tyre nuk është reflektuar në AKT REFUZIMET e mëparëshme të AKM për këtë subjekt. Leja Mjedisore e tipit B është lëshuar nga AKM dhe inspektimi i përputhshmërisë ligjore kryhet nga Drejtoria e Inspektimit pranë këtij Autoriteti.

Në rolin e mbikëqyresit të kontratës koncesionare lidhur me komponentin mjedisor, Njësia e Mjedisit referuar inspektimeve periodike të kryera në Terminalin Lindor, vëren një mospëputhje të infrastrukturës faktike me kushtet e vendosura në lejen mjedisore, konkretisht: Mungon infrastruktura me sprucatorë për kapjen e pluhurave dhe grimcave (pika 7.1.2), Mungon vaska e dekantimit, lidhja me rrjetin e kanalizimit të qytetit pasi ujrë derdhen në puseta të patrajtuara e më pas në mjedis ujorë pritëse në kundërshtim me pikën 7.2.2 dhe 7.3.2.

Referuar ligjit 10448 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar me ligjin 52/2020, specifikisht nenit 27, pika “b”, revokimi i lejes së tipit B bëhet kur mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit me propozimin e inspektoratit kompetent dhe miratimin e Ministrit.

Në vlerësimin e tyre duhet iniciuar një inspektim i programuar nga AKM, për të parë përputhshmërinë ligjore dhe zbatueshmërinë e kushteve të vendosura në lejen përkatëse mjedisore dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Leja Mjedisore është akti i miratuar pas deklarimeve të subjektit dhe kontrolli real i përputhshmërisë së deklarimeve për të cilat subjekti është përgjegjës me gjendjen faktike në terren, është objekt verifikimi i strukturës inspektuese.

Ndërkohë që rezulton se ARM Durrës ka ushtruar inspektim pranë shoqërisë EMS-APO dhe ka evidentuar pikërisht shkeljet, të cilat i janë bërë më parë me dije nëpërmjet shkresës dhe emailit të Autoritetit Portual Durrës dhe Drejtorit të Njesisë së Mjedisit të këtij autoriteti.

ARM (Durrës) ka ushtruar inspektim dhe në përfundim të inspektimit ka vendosur sanksionimin me gjobë të shoqërisë EMS – APO për mospërmbushje të kushteve të lejes mjedisore dhe ka pezulluar aktivitetin e EMS – APO.

Kjo shoqëri i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesë për anulimin e akteve administrative për shkak se nuk janë nxjerrë nga autoriteti kompetent si dhe kanë kërkuar sigurimin e padisë për heqjen e pezullimit.

Gjykata me vendimin nr.197, datë 08.11.2022 ka pranuar pjesërisht kërkesën për sigurimin e padisë duke hequr pezullimin për ushtrimin e aktivitetit dhe duke lejuar EMS – APO të ushtrojë veprimtarinë në shkelje të lejes së mjedisit pasi inspektimi është kryer në shkelje të rregullave përkatëse.

Gjykata administrative me vendimin nr.1243 të datës 19.04.2024 ka pranuar pjesërisht objektin e padisë duke konstatuar pavlefshmërinë e akteve administrative të nxjerra nga ARM (Durrës).

Nga momenti i miratimit të lejes së mjedisit, deri në dhënien e vendimit të Gjykatës, por edhe më pas, EMS APO ka ushtruar aktivitetin me vetëdijen se ka qenë në shkelje të lejes mjedisore. Fakti që Gjykata ka pranuar kërkesë padinë për çështje kompetence, nuk i heq kësaj shoqërie përgjegjësinë që ka pranuar të grumbullojë e magazinohet mbetje të rrezikshme, duke qenë në dijeni se nuk i përmbush standardet e kërkuara nga vetë leja e mjedisit.

Ndërkohë, nga momenti i sigurimit të padisë ku AKM ka qenë palë në proces dhe ka marrë dijeni se masa sanksionuese e inspektimit është kryer në shkelje të ligjit jashtë kompetencës, nuk ka marrë asnjë masë paralelisht për të kryer një inspektim të ri apo për të propozuar që masën përkatëse ta marrë autoriteti kompetent.

AKM ka qëndruar pasive në pritje të vendimit të Gjykatës për zgjidhjen e çështjes në themel, duke e ditur dhe duke e pasur të evidentuar në mënyrë të qartë se subjekti nuk ka përmbushur kriteret e lejes mjedisore dhe aktivitetin vijonte ta kryente në shkelje të kërkesave ligjore dhe të lejes mjedisore.

Kjo pasojë, mund dhe duhet të ishte shmangur që në fazën e trajtimit të kërkesës për tu pajisur me leje mjedisore ku AKM është informuar nga APD se EMS APO nuk i përmbushte kriteret për tu pajisur me një leje të tillë.

Duke miratuar lejen pa përmbushur kriteret dhe duke ja lënë detyrë subjektit që të fillojë të përmbushë kriteret pas miratimit të lejes, AKM ka prodhuar këtë pasojë de facto ku EMS APO ka ushtruar aktivitetin pa përmbushur kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë për magazinimin e grumbullimin e mbetjeve, e sidomos ato në formë pluhuri të konsideruara të rrezikshme për mjedisin dhe/apo shëndetin.

Së treti, AKM ka kryer shkelje në ushtrim të detyrës si institucion mbikëqyrës dhe përgjegjës për respektimin e kriterëve të sigurisë në fushën e mjedisit. Rezulton se AKM nuk ka kryer inspektime periodike tematike, por vetëm inspektime vjetore të përgjithshme, në të cilat gjithashtu evidentohen shkelje mbi rezultatet e inspektimit.

Po kështu, rezulton se AKM nuk ka mbikëqyrur proceset mbi dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme, transportimin e tyre si dhe të sigurojë efikasitetin e gjurmueshmërisë së tyre deri në destinacionin final për tu siguruar se mbetjet nuk janë hedhur në vende të pasigurta, të pamiratuara si venddepozitime apo se nuk janë trajtuar apo përzier me substanca e materiale të tjera që mund të përdoren në aktivitete e materiale me përdorim të përgjithshëm.

Nenin 56 i ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, me titull Inspektimi parashikon se:
“1. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit inspekton instalimet, mbi të cilat zbatohet

ky ligj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

5. Inspektimet për çdo operacion grumbullimi dhe transporti përfshijnë origjinën, natyrën, sasinë e mbetjeve të grumbulluara e të transportuara deri në destinacionin përfundimtar."

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 17.7.2019 për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të mjedisi, parashikon se:

"AKM-ja ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendi.

AKM-ja ka këto funksione kryesore:

1. Sigurimin e performancës mjedisore;

2. Kërkimin dhe dijen mjedisore;

3. Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin;

4. Inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

3. AKM-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson AKM-në në marrëdhëniet me të tretët. Agjencitë rajonale të mjedisit drejtohen nga drejtuesit përkatës të tyre dhe raportojnë te drejtori i Përgjithshëm i AKM-së.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në përputhje me përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

5.3 Në lidhje me vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin:

a) vlerësimin e ndikimit në mjedis të shkaktuar nga projekte, aktivitete të subjekteve të ndryshme dhe fenomene natyrore/klimaterikë etj., duke mundësuar një mjedis brenda standardeve dhe parametrave të kërkuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, për jetë cilësore dhe të shëndetshme të qytetarëve;

b) përgatitjen e projektdeklaratave mjedisore për programe, plane, strategji, projekte;

c) hartimin e databazës së lejeve mjedisore ku të reflektohen të gjitha aplikimet për leje të bëra nga subjekte të ndryshme;

ç) përgatitjen e formatit standard të kërkesës për leje mjedisi;

d) pranimin e aplikimeve për leje mjedisore dhe realizimin e procedurës së vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik për pajisjen me leje (A, B, C);

dh) verifikimin e saktësisë së informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi (të tipit A, B) dhe përgatitjen e mendimit të argumentuar për ministrin në lidhje me miratimin ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara;

e) kryerjen e opionencës teknike për lejet mjedisore dhe hartimin e opionioneve profesionale;

ë) përcaktimin e përgjegjësiave mjedisore dhe vlerësimin e riskut, që ka si objekt parandalimin e rikuperimit e dëmeve që i shkaktohen mjedisit, organizimin e sektorit për marrjen e masave, rehabilitimin e mjedisit etj.

5.4 Në lidhje me inspektimin dhe kontrollin e veprimtarive lidhur me sektorin e mjedisit dhe ujërave:

a) përgatitjen e raporteve periodike mbi vlerësimin e mjedisit;

b) përgatitjen dhe ndjekjen e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;

c) sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi;

ç) kryerjen e inspektimeve dhe kontroleve përmes një programi tematik mbi bazë risku, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore, siç parashikohet në ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;

d) sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave.

Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit e miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm e datës 01.12.2021 parashikon se:

Detyrat funksionale Drejtori i Drejtorisë së licencimit:

1. Ndjek planin e punës së drejtorisë duke iu përgjigjur nevojave të AKM për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje mjedisore sipas parashikimeve ligjore;

3. Miraton dokumentin përfundimtar të qëndrimit të drejtorisë në lidhje me opionencën teknike të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aplikimet e dorëzuara në AKM;

4. Koordinon qëndrimet e sektorëve të drejtorisë në lidhje me dokumentin përfundimtar që i sugjerohet drejtorit të Përgjithshëm të AKM dhe atij që i dorëzohet Ministrisë në lidhje me aplikimin për leje mjedisore;

5. Mbikqyr procesin e lejeve mjedisore;

6. Është përgjegjës për të ngritur alert në lidhje me informacionin që ka të bëjë me përgjegjësitë mjedisore të subjekteve fizik dhe juridik me aktivitet mbi mjedisin;

Detyrat funksionale Drejtori i Drejtorisë së inspektimit:

1. Siguron zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të mjedisit, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit", të ligjit "Për lejet e mjedisit", si dhe përputhshmërinë e kushteve të lejes me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

2. Harton programin vjetor të inspektimit dhe ja dërgon për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-se;

3. Harton raportin vjetor të inspektimit, të cilin ja paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-se;

4. Siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore sipas Parimit "Ndotësi paguan";

5. Kryen kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur, si dhe çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit,

6. Organizon dhe drejton veprimtarinë e drejtorisë, duke siguruar zbatimin e kërkesave të ligjeve dhe akteve nënligjore për pjesën që mbulon drejtoria;

10. Përgatit programin vjetor të inspektimit, mbi bazën e riskut, si dhe raportin vjetor të inspektimeve, i cili i percillet Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-se;

11. Përgjegjësjet për organizimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë të punës së tij;

15. Monitoron dhe kontrollojnë veprimtarinë e Sektorëve të Inspektimit Mjedisor në Degët Rajonale, në zbatim të programeve përkatëse të inspektimit mjedisor, si dhe të respektimit të parimeve, procedurave dhe afateve ligjore,
16. Koordinon inspektimin dhe kontrollin e zbatimit të detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-se”.

Të njëjtat detyra sipas kësaj rregullore kanë edhe përgjegjësit e sektorëve dhe specialistët, duke respektuar sigurisht hierarkinë ku specialistët kryejnë detyrën që lidhet me fushën e sektorit dhe drejtorisë përkatëse sipas detyrave që ka drejtoria duke raportuar, duke dhënë llogari tek eprorët si dhe duke u mbikëqyrur në kryerjen e detyrave dhe cilësisë së punës prej tyre. Konkretisht, lidhur me inspektimin parashikohet se:

Detyrat funksionale Inspektori i Sektorit:


1. Menaxhimi dhe grumbullimi i të dhenave dhe dokumentacionit që dorëzohet nga personat fizikë dhe juridik, si pjesë e raportimit në lidhje me respektimin e parimeve dhe kushteve të lejes mjedisore;
2. Harton dhe koncepton kthimin e përgjigjes me anën e shkresës zyrtare për personat fizikë dhe juridikë veprimtaritë e të cilëve janë subjekte të lejes që dorëzojnë dokumentacion mbi zbatimin e kriterëve dhe kushteve të lejes.
3. Ndjek përditësimin e të dhenave në databasën perkates të operatoreve.
4. Harton informacione në lidhje me subjektet e licensuara, të cilët nuk kanë raportuar, sipas kushteve dhe parimeve të lejes mjedisore dhe j'a paraqet Përgjegjësit të Sektorit;
5. Bashkërendon punën me sektorët e drejtorisë për kontrollin e subjekteve, të cilët nuk kanë raportuar
6. Harton dhe ndjek realizimin e detyrave të parashikuara në planet mujore dhe vjetore të punës së sektorit, duke evidentuar problemet që dalin, si dhe sugjeron dhe propozon zgjidhje të eprorit të tij;

IV.III Fusha e Veprimtarisë së Sektorit të Inspektimit Mjedisor:

- a. Përgatitja e metodikave të inspektimit, të cilat duhet të hartohen në përputhje me kushtet specifike të kategorive të subjekteve ku ata veprojnë;
- b. Përgatit programin vjetor të inspektimit mbi bazën e rriskut, si dhe raportin vjetor të inspektimeve.

Detyrat funksionale të Përgjegjësit të Sektori:

1. Organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e sektorit që mbulon, duke siguruar zbatimin e kërkesave të ligjeve dhe akteve nënligjore për pjesën që mbulon sektori;
2. Bashkërendon punën me sektorët e tjerë për zbatimin e detyrave që kërkojnë bashkërendimin për fushën që mbulon drejtoria;
3. Harton dhe ndjek realizimin e detyrave të parashikuara në planet mujore dhe vjetore të punës së sektorit, duke evidentuar problemet që dalin, si dhe sugjeron dhe propozon zgjidhje të eprorit të tij;



4. Ndhmon dhe udhëzon Drejtoret Rajonal dhe Përgjegjësit e Degëve Rajonale lidhur me zbatimin e praktikave më të mira ligjore dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit mjedisor

5. Jep mendim për hartimin e akteve ligjore e nënligjore për mjedisin, marrin pjesë në grupe pune e komisione të ngritura me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm apo akteve nënligjore; 6. Marrin pjesë në trajnime, seminare e konferenca kombëtare e ndërkombëtare, që lidhen me fushën e përgjegjësisë që mbulojnë;

7. Ndhmon në përgatitjen e programit vjetor të mjedisit; ...

Sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk e ka përmbushur detyrën për garantimin e respektimit të detyrimeve ligjore të legjislacionit për mjedisin si dhe për menaxhimin e mbetjeve, ku nuk ka kryer vlerësime të plota për licencimin e subjekteve për transport e grumbullim të mbetjeve të rrezikshme dhe rezulton se nuk e ka monitoruar zbatimin e kriterëve të lejes. Në rastin e licencimit të ESM APO, i është dërguar edhe shkresë zyrtare për mangësitë që ka subjekti për të përfituar një leje të tillë dhe një fakt i tillë nuk është marrë në konsideratë prej tyre, duke mos kryer asnjë verifikim faktik mbi mangësitë e vena në dijeni.

Po kështu, rezulton se nuk ka kryer inspektime në pëpruthje me ligjin pranë shoqërisë Kurum international sha, Alliance Resource shpk, Sokolaj shpk dhe ESM APO, duke lejuar grumbullimin, transportimin dhe më pas kontrabandimin e mbetjeve të rrezikshme me kod 10 02 07* të cilat sipas të dhënave të administruara nga Prokuroria, në të paktën 4 vitet e fundit janë transportuar me qindra mijëra tonelata në vit. Ndërkohë që shoqëria Kurum ka deklaruar se ka prodhuar vetëm 1000 ton mbetje me kod 10 02 07*, nga të dhënat rezulton se ka tregtuar vetëm tek Sokolaj shpk nëpërmjet 4 fatura në vitin 2023 dhe 2024 mbi 4122 Ton mbetje të rrezikshme.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kërkuar informacion me shkresë nga Kurum e cila me shkresën nr.9305/1 prot., datë 23.09.2024 ka informuar se, bazuar në raportimet e regjistrave të transfertave të mbetjeve pranë AKM-së subjekti “Kurum International” për vitin 2024 ka deklaruar që ka transferuar kodin e mbetjeve **100207*** në sasi **1005 ton** në subjektin “Alliance Resource”.

Ndërkohë, AKM nuk ka kryer më parë asnjë lloj verifikimi në terren, të kryejë analiza dhe të kontrollojë shitjen e mbetjeve që prodhon Kurum international sha bazuar në kartën teknologjike. Vetëm pasi është bërë publik rasti i eksportimit të mbetjeve AKM ka kërkuar informacion shkresor në shtator 2024, se sa mbetje të rrezikshme ka transferuar shoqëria prodhuese. Ndërkohë që AKM ka detyrimin të mbikëqyrë çdo proces që shfaq rrezik për mjedisin.

Referuar kontratave të shit-blejjes me shoqërinë Sokolaj, Kurum zotohej të vendoste në dispozicion nga 25.000 Ton deri në 50.000 Ton mbetje, dhe AKM për këto fakte nuk ka kryer asnjë verifikim dhe asnjë analizë laboratorike, edhe pse e ka detyrim ligjor dhe pranë çdo ARM-je funksionon zyra e analizës.

Së fundmi, **AKM nuk ka monitoruar cilësinë e vetëmonitorimeve që kanë kryer shoqëritë që janë marrë me menaxhimin e mbetjeve ku rezulton se monitorimet janë kryer fiktivisht, pasi asnjëra prej shoqërive si më sipër cituar nuk përmbush kriteret e diktuar nga ligji dhe në lejet përkatëse mjedisore për të ushtuar veprimtarinë në përputhje me normat në scilën nga hallka e procesit. Mbetjet nga këto shoqëri janë trajtuar e menaxhuar jashtë standardeve mjedisore ndërkohë që kompanitë që kanë kryer vetëmonitorimin dhe analizat e mbetjeve kanë**

vepruar në funksion të shoqërive duke manipuluar rezultatet. Rezultatet e manipuluar janë konstatuar në rastet kur ka mospërputhje mes raportimeve dhe gjendjes faktike dhe të dhënave që kanë rezultuar përgjatë hetimit nga aktet shkresore, faturat e shitjes, inspektimet në disa raste.

Studiot “Alpha”, “Leni-Ing” dhe “Eko-Studio-Projekt” që kanë bërë vetëmonitorimet kanë për detyrë që të bëjnë vetëmonitorime reale, nga dokumentacioni rezulton se janë të paplota si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, ku pikat e marrjes së mostrave për zhurmën, ajrin dhe ujin nuk janë të evidentuara sipas kushteve ligjore.

Subjektet “Alpha” dhe “Leni-Ing” kanë bërë analiza për shoqërinë “Kurum International sh.a” sh.a. Subjekti “Alpha” ka bërë analiza edhe për shoqërinë “Alliance Resource” sh.p.k.

Subjekti “Eko-Studio-Projekt” ka bërë analiza për shoqërinë “EMS” sh.p.k, por pavarësisht se me e-mailin e datës 12.07.2024 që i është dërguar nga adresa e e-mailit gazmend@ems-apo.com (Gazmend Sina) me subjekt: Raportet mjedisore, ju është bërë me dije se ngarkesat e përpunuara 01.01.2024-30.06.2024, subjekt i lejes mjedisore eksport janë dhe **koncentrate/zink rifuxho+ me konteinerë-2969 ton, rezulton se ky produkt (artikull) nuk është raportuar prej tyre.**

Subjekti eko studio projekt e ka konkluduar shoqërinë EMS si në përputhje me standardet ndërkohë që kjo shoqëri ka pasur mangësi në plotësimin e kriterëve që në momentin e lëshimit të lejes mjedisore për të.

Subjekti Sinamati ka aplikuar për shoqërinë “Sokolaj” sh.p.k në AKM, por rezulton që dokumentacioni është i paplotë sepse nuk paraqet të gjithë problematikat që ka te stacioni i transferimit dhe duhet ta verifikonte këtë dokumentacion.

Këto mangësi dhe problematika AKM ka pasur detyrimin ti monitorojë dhe inspektojë, ndërkohë që nuk është kryer asnjë inspektim serioz real. Edhe në rastet e inpektimeve që janë kryer nuk janë marrë masa parandaluese, duke forcuar bindjen për organin e Prokurorisë se ky institucion duke përfshirë drejtuesin e drejtorisë së përgjithshme dhe drejtuesit dhe inspektorët e drejtorisë të lejeve dhe drejtorisë së inspektimit kanë qenë në dijeni të shkeljeve dhe nuk kanë kryer detyrës në përputhje me ligjin.

AKM ka detyrë ligjore të monitorojë mënyrën sesi shoqëritë zbatojnë lejet dhe si operojnë në realitet duke i nënshtruar inspektim, kushteve infrastrukture e instalimeve, shkarkimeve të ujërave, nivelin e ndotjes në ajër nga pluhurat, kushteve të transportit, por padyshim edhe sasisë që prodhohet dhe destinacioni i kësaj sasie. Pasi bazuar në dokumentacionin e marrë nga Prokuroria rezultojnë mospërputhje të dukshme mes sasive të prodhuara, të shitura, të eksportuara dhe AKM nuk ka kryer detyrën e ngarkuar me ligj, edhe pse indiciet e në këtë fushë ka shkelje i ka pasur gjithnjë si me shkresa nga autoritetet e tjera, ashtu edhe nëpërmjet denoncimeve mbi të cilat janë motivuar disa inspektime fiktive.

Kjo bindje përforcohet edhe më tepër nga fakti që për shoqërinë ESM APO, institucionit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit i është bërë me dije me shkresë zyrtare se ky subjekt nuk përmbush standardet për të marrë leje mjedisore por gjithësesi nga ana e AKM është vijuar me propozimin e lejes së mjedisit, duke evidentuar edhe në përmbajtje të lejes se subjekti duhet të përmbushë standartet të cilat nuk i plotëson. Pas kësaj, AKM nuk ka marrë asnjë masë reale për të parandaluar shkeljet ligjore por ka qëndruar në pasivitet të plotë.

Neni 54 i ligjit për menaxhimin e mbetjeve parashikon se:

Pavarësisht nga kërkesat e ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe nga kërkesat e

akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, leja e mjedisit e referuar në nenin 53 të këtij ligji, përmban, gjithashtu, kushte të tjera që duhen plotësuar, ku përcaktohen:

- a) llojet dhe sasi të mbetjeve që trajtohen;
- b) operacionet që përfshihen në leje, kërkesat teknike dhe kërkesat që lidhen me territorin në fjalë;
- c) masat e sigurisë dhe masat parandaluese që duhen marrë;
- ç) metoda që duhet përdorur për secilin operacion;
- d) operacionet e monitorimit dhe të kontrollit që nevojiten;
- dh) dispozitat për mbylljen dhe kujdesin e mëtejshëm, sipas nevojës.

Ndërsa, në nenin 55 paashikohet se:

1. Kërkesa për mbajtjen dhe përditësimin e të dhënave për mbetjet përcaktohet në:

- a) lejen e mjedisit për personin fizik apo juridik, që krijon mbetje;
- b) licencën e transportit për personin fizik apo juridik, që grumbullon ose transporton mbetje;
- c) licencën e tregtarit dhe/apo të agjentit;
- ç) lejen e mjedisit për personin fizik apo juridik, që kryen çdo lloj operacioni për trajtimin e mbetjeve.

2. Të dhënat e referuara në pikën 1 të këtij neni përfshijnë:

- a) të dhëna kronologjike për sasinë, natyrën dhe origjinën e mbetjeve;
- b) sipas rastit, destinacionin, shpeshësinë e grumbullimit, mënyrën e transportit dhe metodën e trajtimit të parashikuar sipas llojit të mbetjeve.

3. Personat e referuar në këtë nen i mbajnë të dhënat për mbetjet e rrezikshme për të paktën 3 vjet.

4. Personat e referuar në këtë nen i mbajnë të dhënat për mbetjet jo të rrezikshme për të paktën 1 vit.

5. Personat fizikë dhe juridikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, i vënë të dhënat e referuara në pikën 2 të këtij neni në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Inspektoriatit për Mjedisin, në bazë të kërkesës së tyre me shkrim.

6. Personat fizikë dhe juridikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjes, në bazë të kërkesës së tyre me shkrim, evidenca të dokumentuara që tregojnë se operacionet e menaxhimit janë kryer.

Ndërkohë që verifikime të tilla mbi sasi të prodhuara, destinacionin e tyre dhe respektimin e standarteve të menaxhimit nuk janë respektuar nga AKM. Edhe pasi është marrë dijeni mbi problematikën mbi eksportimin e mbetjeve në kundërshtim me ligjin në gusht 2024, AKM nuk është në gjendje të raportojë mbi sasi të reale të mbetjeve që janë prodhuar, përpunuar, ricikluar, rikuperuar, agjësuar, eskportuar dhe as destinacionin e tyre.

Vetëmonitorimi i shoqërive nuk e shkarkon AKM nga përgjegjësia e cila duhet të ballafaqonte të dhënat duke kryer monitorime dhe inspektime mbi zbatimin e lejeve përkatëse. Aq më tepër kur ka pasur indicie se disa shoqëri nuk i përmbushnin kriteret e për rrjedhojë raportet e vetëmonitorimit nuk mund të merreshin si të mirëqena.

Për rrjedhojë, drejtuesi i përgjithshëm i AKM si dhe drejtuesit dhe inspektorët e drejtorive respektive për dhënien e licencave dhe të inspektimit dyshohet se janë përgjegjës penalisht për shpërdorimin e detyrës pasi nuk kanë përmbushur detyrën e ngarkuar me ligj, aktet nënligjore dhe rregulloret e AKM.

Për sa më sipër, bazuar në provat bashkëlidhur kërkesës, më datë 29.01.2026, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën me objektin se sipërcituar.

II. Vlerësimi i Gjykatës.

Ligjvënësi ka parashikuar se masat e sigurimit personal që kufizojnë të drejtat dhe liritë e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal, mund të caktohen vetëm kur ekzistojnë dhe provohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj. Këto kushte dhe kriteret, të shpallura në nenin 5 të KEDNJ, janë materializuar edhe në nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kështu, në nenin 27 të Kushtetutës, një ndër rastet se kur liria e personit mund të kufizohet, parashikohet edhe rasti kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprave penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj, të materializuara edhe në ligjin procedural penal, konkretisht në nenin 228 dhe 229 të K.Pr.Penale për masat e sigurimit në përgjithësi dhe në veçanti në nenin 230/1 për masën e sigurimit personal “*Arrest në burg*”. Kështu në pikën 1 dhe 2 të nenit 228 të K.Pr.Penale, sanksionohen **kushtet e përgjithshme** që duhet të mbajë parasysh gjykata në caktimin e masës së sigurimit dhe të cilën janë:

Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, ose elementi provues. Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është kushti më i rëndësishëm që vlerësohet, pasi askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. Kuptimi juridik procedural i kushtit të dyshimit të arsyeshëm ka gjetur trajtim gjerësisht në Jurisprudencën e GJEDNJ. Kështu, për herë të parë, në çështjen Fox, Cambell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar dt. 30.08.1990, GJEDNJ shprehet për dyshimin e arsyeshëm duke përcaktuar se elementë të domosdoshëm të tij janë ndershmëria dhe “*bona fides*”. *Pasja e një dyshimi të arsyeshëm presupozon, ekzistencën e fakteve ose informacionit, që bind një vëzhgues objektiv, që personi në fjalë mund të ketë kryer një vepër.* Në çështjen Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt. 28.10.1994, kjo Gjykatë theksoi se ajo që nënkuptohej me *dyshim i arsyeshëm* varej nga rrethanat e një çështje të veçantë dhe nuk mund të gjykohej sipas standardeve të njëjta.

Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova sipas pikës 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, nënkupton që bëhet fjalë për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që jo vetëm se vepra penale është kryer por dhe në drejtim të mundësisë se kjo vepër penale është kryer nga personi ndaj të cilit do të vendoset masa e sigurimit, që do të thotë se kërkohet detyrimisht përgjegjësia e personit që akuzohet. Pra, Gjykata thekson se dyshimi konsiderohet i arsyeshëm nëse bazohet në fakte dhe në informacione të cilën krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprave penale për të cilën ai akuzohet⁴.



⁴ Shiko Vendimin Nr. 72, date 18.05.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dyshimi i arsyeshëm në aplikimin e një mase sigurimi duhet të mbështetet në ato prova, që duhet të jenë të tilla, që në atë gjendje në të cilën ato ndodhen, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprave penale në ngarkim të tij, **por se kjo shkallë dyshimi nuk duhet të jetë ezauruese** (*Vendimi Unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). Në fazën e caktimit të masës së sigurimit natyrisht që nuk mund të pretendohet se ka prova të plota që të mund të vërtetojnë akuzën, por duhet të ketë aq prova sa të krijojnë bazën e nevojshmërisë për caktimin e masës së sigurimit.

Ekzistenca e veprave penale. Përveç dyshimit të arsyeshëm gjykata duhet të konstatojë nëse ekzistojnë dhe dy kushtet e tjera të përgjithshme. Kushti i dytë është ekzistenca e veprave penale ku kërkohet që fakti të jetë parashikuar nga ligji si vepër penale, apo vepra penale të mos jetë shuar për shkak parashkrimi të ndjekjes penale, ose për shkak të shfuqizimit të dispozitave penale, apo të mos jetë amnistuar, ose dënimi mos të jetë shuar.

Ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas së drejtës penale. Kushti i tretë i përgjithshëm është ekzistenca e shkaqeve të dënueshmërisë së personit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit. Nuk mund të caktohet masë sigurimi ndaj një personi që nuk mund të merret si i pandehur, ose nuk mund të dënohet si p.sh. personi që nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, apo personi që është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore, kur jemi para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale apo kur veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

1. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Erdal Demir.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Erdal Demir mund të ketë kryer veprat penale **"Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara"** në katër raste, të parashikuar nga neni 171-25, i Kodit Penal, **"Transporti i mbetjeve"** parashikuar nga neni 201/b-25 i Kodit Penal, **"Menaxhimi i mbetjeve"** parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal, **"Falsifikimi i dokumenteve"** në dy raste parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, **"Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale"** parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Yusuf Seza Kurum si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky

dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaturues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se veprat penale për të cilën dyshohet shtetasi Erdal Demir nuk rezultojnë të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që këto vepra të jenë shfuqizuar apo të jenë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- a) *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- b) *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- c) *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Erdal Demir, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara” në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); “Transporti i mbetjeve”, parashikuar nga neni 201/b-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga një deri në pesë



vjet) "Menaxhimi i mbetjeve" parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet), "Falsifikimi i dokumenteve" në dy raste, parashikuar nga neni 186 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në tre vjet); "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Erdal Demir.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: "1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal".

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut⁵. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: "Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit".

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale⁶.

⁵ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁶ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr. 2, datë 10.02.2010, vendim nr. 3, datë 17.02.2010.


Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Erald Demir, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *"Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara"* në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); *"Transporti i mbetjeve"*, parashikuar nga neni 201/b-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet) *"Menaxhimi i mbetjeve"* parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet), *"Falsifikimi i dokumenteve"* në dy raste, parashikuar nga neni 186 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në tre vjet); *"Pastrimi i produkteve të veprimitarisë kriminale"* parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Erdal Demir** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *"Arrestit në burg"*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

2. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Yusuf Sezai Kurum.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Yusuf Sezai Kurum mund të ketë kryer veprat penale *"Menaxhimi i mbetjeve"*, *"Pastrimi i produkteve të veprimitarisë kriminale"* të parashikuara nga nenet 201/a-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Yusuf Sezai Kurum si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaurues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Yusuf Sezai Kurum nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.



Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- d) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyelimin e vendimit;*
- e) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- f) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Yusuf Sezai Kurum, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, “*Menaxhimi i mbetjeve*”, parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet), “*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*” parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme siguri për vendosjen e një mase siguri, ndaj shtetasit Yusuf Sezai Kurum.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “1. Në caktimin e masave të

sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriteret imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut⁷. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit”.*

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale⁸.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Yusuf Sezai Kurum, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *“Menaxhimi i mbetjeve”*, parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal *(e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet)*, *“Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale”* parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal *(e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim)*. Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Yusuf Sezai Kurum** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *“Arrestit në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

3. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasen Gjovana Sokolaj.

⁷ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁸ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr.164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.



Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Gjovana Sokolaj mund të ketë kryer veprat penale "Kondrabanda me mallra të ndaluar ose të kufizuara" në katër raste, "Falsifikimi i dokumenteve", "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nenet 171-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Gjovana Sokolaj si dhe përgjegjësia e saj penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaurues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasja Gjovana Sokolaj nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat kjo shtetase nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ajo ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së saj mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- g) *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- h) *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- i) *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetases Gjovana Sokolaj, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara” në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); “Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal (e cila dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet burgim), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme siguri për vendosjen e një mase siguri, ndaj shtetases Gjovana Sokolaj.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriteret imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut⁹. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të

⁹ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit”*.

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale¹⁰.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasen Gjovana Sokolaj, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *“Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara”* në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); *“Falsifikimi i dokumenteve”*, parashikuar nga neni 186-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); *“Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale”* parashikuar nga neni 287 i K.Penal (e cila dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet burgim). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasja Gjovana Sokolaj paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *“Arrestit në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

4. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Doni Sokolaj.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë siguri ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Doni Sokolaj mund të ketë kryer veprat penale *“Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara”*, *“Falsifikimi i dokumenteve”* dhe *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, parashikuar nga neni 171-25, 186-2 dhe 287/2 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme

¹⁰ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr.164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Yusuf Sezai Kurum si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaurues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Doni Sokolaj nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.


Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- j) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- k) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- l) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Doni Sokolaj, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma "b" e



nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara” në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); “Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Doni Sokolaj.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut¹¹. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjkata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: “Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit”.

Gjkata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale¹².

¹¹ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹² Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Doni Sokolaj, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *"Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara"* në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); *"Falsifikimi i dokumenteve"*, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); *"Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale"* parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Doni Sokolaj** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *"Arrestit ne burg"*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

5. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasen Olizana Pemati.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasja Olizana Pemati mund të ketë kryer veprat penale *"Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara"* dhe *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"* parashikuar nga neni 171-25 dhe 287/2 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprave penale për të cilat dyshohet Olizana Pemati si dhe përgjegjësia e saj penale me këto vepra penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprave penale në ngarkim të saj, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaturues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se veprat penale për të cilat dyshohet shtetasi Olizana Pemati nuk rezultojnë të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezultojnë që këto vepra të jenë shfuqizuar apo të jenë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat kjo shtetase nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ajo ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin



konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së saj mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- m) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- n) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- o) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetases Olizana Pemati, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma "b" e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, "Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara" në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Olizana Pemati.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: "1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit

dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut¹³. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit”.*

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale¹⁴.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasen Olizana Pemat, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *“Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara”* në katër raste, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); *“Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale”* parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Olizana Pemat** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *“Arrestit në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

6. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Mujo Ilazaj.

¹³ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁴ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr.164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Mujo Ilazaj mund të ketë kryer veprën penale "Transporti i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/b-25 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Mujo Ilazaj si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaturues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Mujo Ilazaj nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- p) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- q) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;

r) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kritereve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Mujo Ilazaj, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprën penale që po hetohet, *“Transporti i mbetjeve”*, parashikuar nga neni 201/b-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme siguri për vendosjen e një mase siguri, ndaj shtetasit Mujo Ilazaj.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”*.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut¹⁵. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit”*.

¹⁵ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.



Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale¹⁶.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Mujo Ilazaj, bie dyshimi se ka kryer veprën penale *Transporti i mbetjeve*, parashikuar nga neni 201/b-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Mujo Ilazaj** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *Arrestit në burg*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

7. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Rami Bunga.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Rami Bunga mund të ketë kryer veprat penale *Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara* dhe *Menaxhimi i mbetjeve*, parashikuar nga neni 171-25 dhe 201/a-25 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprave penale për të cilat dyshohet Rami Bunga si dhe përgjegjësia e tij penale me këto vepra penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaturues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

¹⁶ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Rami Bunga nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që këto vepra të jenë shfuqizuar apo të jenë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.


Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- s) *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- t) *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- u) *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Rami Bunga, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara”, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); “Menaxhimi i mbetjeve” parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme siguri për vendosjen e një mase siguri, ndaj shtetasit Rami Bunga.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.



Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *"1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal"*.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut¹⁷. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjkata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

Gjkata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale¹⁸.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjkata vlerëson se mbi shtetasin Rami Bunga, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *"Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara"*, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); *"Menaxhimi i mbetjeve"* parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Rami Bunga** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie

¹⁷ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁸ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 64, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal "Arrestit në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

8. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Harun Sarica.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Harun Sarica mund të ketë kryer veprën penale *Menaxhimi i mbetjeve*", parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Harun Sarica si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaures. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Harun Sarica nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e



tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- v) *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- w) *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- x) *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kritereve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Harun Sarica, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprën penale që po hetohet, “*Menaxhimi i mbetjeve*” parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (*e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet*), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme siguri për vendosjen e një mase siguri, ndaj shtetasit Harun Sarica.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “*1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal*”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e

rezikut dhe shkallën e rezikut¹⁹. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit”*.

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale²⁰.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Harun Sarica, bie dyshimi se ka kryer veprën penale *“Menaxhimi i mbetjeve”* parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (*e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet*). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Harun Sarica** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *“Arresti në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

9. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Arif Shkalla.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë siguri ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Arif Shkalla mund të ketë kryer veprat penale *“Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara”*, *“Menaxhimi i mbetjeve”*, *Falsifikimi i dokumentave* dhe *“Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale”* të parashikuar nga nenet 171-25, 201/a-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë

¹⁹ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²⁰ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr. 2, datë 10.02.2010, vendim nr. 3, datë 17.02.2010.

edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Yusuf Sezai Kurum si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë veprë penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaturues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Arif Shkalla nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që këto vepra të jenë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton. përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- y) *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- z) *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- aa) *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Arif Shkalla, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma "b" e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, "*Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara*", parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); "*Menaxhimi i mbetjeve*" parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet), "*Falsifikimi i dokumenteve*", parashikuar nga neni 186 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); "*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287 i K.Penal (e cila dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet burgim), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Arif Shkalla.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: "*1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal*".

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut²¹. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: "*Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit*".

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova

²¹ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale²².

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Arif Shkalla, bie dyshimi se ka kryer veprat penale "*Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara*", parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); "*Menaxhimi i mbetjeve*" parashikuar nga neni 201/a-25 i K.Penal (e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet), "*Falsifikimi i dokumenteve*", parashikuar nga neni 186 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); "*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287 i K.Penal (e cila dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet burgim). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Arif Shkalla** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal "*Arrestit në burg*", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

10. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Shaban Hyseni.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Shaban Hyseni mund të ketë kryer veprat penale "*Kontrabanda me mallra të ndaluara apo të kufizuara*", "*Falsifikimi i dokumenteve*" të parashikuara nga nenet 171-25 dhe 186/2 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Shaban Hyseni si dhe përgjegjësia e tij penale me këto vepra penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprave penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaures. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

²² Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr.164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se veprat penale për të cilat dyshohet shtetasi Shaban Hyseni nuk rezultojnë të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezultojnë që këto vepra të jenë shfuqizuar apo të jenë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

bb) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;

cc) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;

dd) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Shaban Hyseni, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, “Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara”, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Shaban Hyseni.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *"1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal"*.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të njaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut²³. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjkata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arrestit në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

Gjkata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale²⁴.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjkata vlerëson se mbi shtetasin Shaban Hyseni, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *"Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara"*, parashikuar nga neni 171-25 i K.Penal (e cila dënohet me burgim deri në 10 vjet); *"Falsifikimi i dokumenteve"*, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Shaban Hyseni** paraqet rrezikshmëri të tillë

²³ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²⁴ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal “*Arrestit ne burg*”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

11. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasen Mirjeta Zotaj.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasja Mirjeta Zotaj mund të ketë kryer veprat penale “*Falsifikimi i dokumentave*” dhe “*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*” të parashikuar nga nenet 186-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Mirjeta Zotaj si dhe përgjegjësia e tij penale me këto vepra penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaures. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasja Mirjeta Zotaj nuk rezulton të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezultojnë që këto vepra të jenë shfuqizuar apo të jenë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat kjo shtetase nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:
ee) *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
ff) *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
gg) *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetases Mirjeta Zotaj, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma "b" e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, "*Falsifikimi i dokumenteve*", parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); "*Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetases Mirjeta Zotaj.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: "*1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal*".

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriteret imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e

rrezikut dhe shkallën e rrezikut²⁵. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit”*.

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale²⁶.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasen Mirjeta Zotaj, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *“Falsifikimi i dokumenteve”*, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal (e cila dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet); *“Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale”* parashikuar nga neni 287/2 i K.Penal (e cila dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasja **Mirjeta Zotaj** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *“Arrestit në shtëpi”*, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

12. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Mikail Hila.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Mikail Hila mund të ketë kryer veprën penale *“Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”*, parashikuar nga neni 175 i K.Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Mikail Hila si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi

²⁵ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²⁶ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaurues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Mikail Hila nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- hh) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- ii) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- jj) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Mikail Hila, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma "b" e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprat penale që po hetohet, "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", parashikuar nga neni 175 i K.Penal, (e cila dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet), pra ka një

rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Mikail Hila.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *"1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal"*.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut²⁷. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjkata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arrestin në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

Gjkata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale²⁸.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjkata vlerëson se mbi shtetasin Mikail Hila, bie dyshimi se ka kryer veprën penale *"Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë*

²⁷ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²⁸ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

*doganore", parashikuar nga neni 175 i K.Penal, (e cila dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Mikail Hila** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal "Arrestit ne burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.*

13. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Mbarime Koroci.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Evis Mellonashi si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaurues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Evis Mellonashi nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para

mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:
jjjj) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
kkkk) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;
llll) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Evis Mellonashi, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprën penale që po hetohet, “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “. (me burgim deri në 7 vjet), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme siguri për vendosjen e një mase siguri, ndaj shtetasit Evis Mellonashi.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të

llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut⁶³. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arrestit në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale⁶⁴.


Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Evis Mellonashi, bie dyshimi se ka kryer veprën penale *"Shpërdorimi i detyrës"*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, (me burgim deri në 7 vjet). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Evis Mellonashi** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *"Arrestit në burg"*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

31. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Kejdi Ahmetaj.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë siguri ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Kejdi Ahmetaj mund të ketë kryer veprat penale *"Shpërdorimi i detyrës"*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

⁶³ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁶⁴ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.



Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Kejdi Ahmetaj si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaurues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Kejdi Ahmetaj nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:
mmmm) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
nnnn) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;
oooo) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.



Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Kejdi Ahmetaj, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma "b" e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprën penale që po hetohet, *"Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal*, (me burgim deri në 7 vjet), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Kejdi Ahmetaj.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *"1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal"*.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriterë imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut⁶⁵. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjukata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

Gjukata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale⁶⁶.

⁶⁵ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁶⁶ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr. 164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr. 2, datë 10.02.2010, vendim nr. 3, datë 17.02.2010.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Kejdi Ahmetaj, bie dyshimi se ka kryer veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ", (me burgim deri në 7 vjet)). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Kejdi Ahmetaj** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal "Arrestit ne burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

32. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasen Iva Musa.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasja Iva Musa mund të ketë kryer vepër penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ".

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet shtetasja Iva Musa si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi e zaturues. Në këtë aspekt. baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasja Iva Musa nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat kjo shtetase nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së saj mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:
pppp) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
qqqq) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;
rrrr) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetases Iva Musa, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma “b” e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprën penale që po hetohet, “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, (me burgim deri në 7 vjet), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetases Iva Musa.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e

gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut⁶⁷. Me qëllim përcaktimin e masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale⁶⁸.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasen Iva Musa, bie dyshimi se ka kryer veprat penale *"Shpërdorimi i detyrës"*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, (me burgim deri në 7 vjet). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasja **Iva Musa** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal *"Arrestit në shtëpi"*, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

33. Lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Xhulio Golgota.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Xhulio Golgota mund të ketë kryer veprat penale *"Shpërdorimi i detyrës"*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme

⁶⁷ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁶⁸ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr.164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.



ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet Xhulio Golgota si dhe përgjegjësia e tij penale me këtë vepër penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaures. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Xhulio Golgota nuk rezulton të jetë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezulton që kjo vepër të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç. Gjithashtu nuk rezultoi që personi nën hetim të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:
ssss) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
tttt) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;
uuuu) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit Xhulio Golgota, është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3, gërma "b"

e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të masës së dënimit që parashikohet për veprën penale që po hetohet, *"Shpërdorimi i detyrës"*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal", (me burgim deri në 7 vjet), pra ka një rrezik që personi nën hetim, të largohet duke iu fshehur hetimit dhe gjykimit. Në këtë mënyrë çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi, ndaj shtetasit Xhulio Golgota.

- Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *"1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal"*.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kriteret imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut⁶⁹. Me qëllim përcaktimit të masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

Gjykata, gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjor-faktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale⁷⁰.

⁶⁹ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁷⁰ Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr.164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë 10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.

Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin Xhulio Golgota, bie dyshimi se ka kryer veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal", (me burgim deri në 7 vjet)). Nisur nga rrezikshmëria që paraqet vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer, gjykata vlerëson se shtetasi **Xhulio Golgota** paraqet rrezikshmëri të tillë shoqërore, sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e sigurimit personal "Arrestit ne burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata në bazë të nenit 238, 244, 245 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Erdal Demir**, i dyshuar për veprën penale "Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara" në katër raste, "Transporti i mbetjeve", "Menaxhimi i mbetjeve", "Falsifikimi i dokumenteve" në dy raste, "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nenet 171-25, 201/b-25, 201/a-25, 186 dhe 287/2 të Kodit Penal.
2. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Yusuf Sezai Kurum**, i dyshuar për veprat penale "Menaxhimi i mbetjeve", "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nenet 201/a-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.
3. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Gjovana Sokolaj**, e dyshuar për veprat penale "Kondrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara" në katër raste, "Falsifikimi i dokumenteve", "Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nenet 171-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal.
4. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Doni Sokolaj**, i dyshuar për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara", "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 171-25, 186-2 dhe 287/2 i Kodit Penal.
5. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Olizana Pemati** e dyshuar për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 171-25 dhe 287/2 i Kodit Penal.
6. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Mujo Ilazaj**, i dyshuar për veprën penale "Transporti i mbetjeve", parashikuar nga neni 201/b-25 i Kodit Penal.
7. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal "Arrest me burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Rami Bunga**, i dyshuar për veprën penale

- "Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara"* dhe *"Menaxhimi i mbetjeve"*, parashikuar nga neni 171-25 dhe 201/a-25 i Kodit Penal.
8. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Harun Sarica**, i dyshuar për veprën penale *"Menaxhimi i mbetjeve"*, parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.
 9. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Arif Shkalla**, i dyshuar për veprat penale *"Kontrabanda me mallra të ndaluar ose të kufizuara"*, *"Menaxhimi i mbetjeve"*, *falsifikimi i dokumentave* dhe *"Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale"* të parashikuar nga nenet 171-25, 201/b-25, 186-25 dhe 287 të Kodit Penal.
 10. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Shaban Hyseni**, i dyshuar për veprën penale *"Kontrabanda me mallra të ndaluar apo të kufizuara"*, *"Falsifikimi i dokumenteve"* parashikuar nga neni 171-25 dhe 186/2 i Kodit Penal.
 11. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest në shtëpi"*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Mirjeta Zotaj**, e dyshuar për veprat penale *"Falsifikimi i dokumentave"* dhe *"Pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale"* të parashikuar nga nenet 186-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.
 12. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Mikail Hila** i dyshuar për veprën penale *"Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore"*, parashikuar nga neni 175 i K.Penal.
 13. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Mbarime Koroci**, e dyshuar për veprat penale *"Menaxhimi i mbetjeve"* dhe *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"* parashikuar nga nenet 201/a-2 dhe 287 të Kodit Penal.
 14. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Nazif Bajrami**, i dyshuar për veprën penale *"Menaxhimi i mbetjeve"*, parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal.
 15. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Andon Prifti**, i dyshuar për veprën penale *"Menaxhimi i mbetjeve"*, parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal.
 16. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Petrit Qosja**, i dyshuar për veprën penale *"Menaxhimi i mbetjeve"*, parashikuar nga 201/a-25 i Kodit Penal.
 17. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Julian Kapedani**, i dyshuar për veprën penale *"Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore"*, parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.
 18. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest me burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Indrit Likaj**, i dyshuar për veprën penale

“Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”, parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.

19. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest me burg”*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Edmond Voda**, i dyshuar për veprën penale *“Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”*, parashikuar nga neni 175, i Kodit Penal.
20. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest me burg”*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Helidon Lila**, i dyshuar për veprën penale *“Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”*, parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.
21. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest me burg”*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Shkelqim Jakupi**, i dyshuar për veprën penale *“Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”*, parashikuar nga neni 175-25, i Kodit Penal.
22. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest me burg”*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Florian Çimo**, i dyshuar për veprën penale *“Menaxhimi i mbetjeve”*, parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.
23. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest me burg”*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Gazmend Sina**, i dyshuar për veprën penale *“Menaxhimi i mbetjeve”*, parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.
24. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest me burg”*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Ingo Hesse**, i dyshuar për veprën penale *“Menaxhimi i mbetjeve”*, parashikuar nga neni 201/a-25 i Kodit Penal.
25. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Arta Dollani**, e dyshuar për veprën penale *“Shpërdorimi i detyrës”* në tre raste, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
26. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Marjeta Përlala**, e dyshuar për veprën penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, në tre raste, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
27. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest me burg”*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Dritan Seferaj**, e dyshuar për veprën penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, në tre raste parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
28. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Kledina Skëndo**, e dyshuar për veprën penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
29. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Bujana Tonçiça**, e dyshuar për veprën penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
30. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Evis Mellonashi**, e dyshuar për veprën penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

31. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest në burg"*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Kejdi Ahmetaj**, i dyshuar për veprën penale *"Shpërdorimi i detyrës"*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
32. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest në shtëpi"*, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Iva Musa**, e dyshuar për veprën penale *"Shpërdorimi i detyrës"*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
33. Caktimin në mungesë të masës së sigurimit personal *"Arrest në burg"*, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Xhulio Golgota**, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
34. Urdhërohet Prokuroria dhe Policia Gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.
35. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

U shpall sot në Durrës, më datë 03.02.2026.

GJYQATAR
ORGENT NAZAJ

